



"RILINDASI" ▶ Faqe 13-20

**Profili i një rebeli
Ja faktet e
panjohura për
Dom Ndre Mjedën**



Big Brother 6
Gjysmë finalja, ikën
Rikja dhe Eldora

▶ Faqe 12



Champions
Pas 12 vjetësh Bayern
fiton yllin e pestë

▶ Faqe 22

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi "RILINDASI"

VITI III - NR. 122 E diel, 26-05-2013



INTERVISTA

FLET NGA MALLAKASTRA KRYETARI I LSI-së

ILIR META: JA SFIDA IME E VERTETE



- **Edi Rama, a do të jetë ai kryeministri i ri i Shqipërisë?**

Mendimet e Ilir Metës për kryetarin e PS-së. Ishte ai personi i duhur për të marrë drejtimin e saj në 2005?

- **Familja politike e ish-kryeministrit, vetëm djali i dhënë pas teknologjisë**

Kush vendosi në familjen e Ilir Metës që Monika Kryemadhi të jetë kandidatë për deputete në qarkun e Lezhës?

- **Marrëveshja me Partinë Socialiste dhe qeveria e ardhshme?**

Kush do të vendosë për anëtarët e rinj të kabinetit pas fitores së të majtës në 23 qershor?

▶ Faqe 2-3

Koment



NGA ERION KRISTO

Sikur Presidenti i Republikës të fliste

Do ishte shumë më ndryshe sikur Presidenti i Republikës të fliste ndonjëherë edhe për qytetarët e vet. Po kjo s'ka gjasa të ndodhë. Presidenti ynë ka një mangësi. Ai nuk flet. Ai nuk ka agjendë. Dhe po flasim për një agjendë civile, sepse sa herë që politika ka ndonjë nevojë, ai aktivizohet si me sustë. Do të ishte ndryshe, sepse qytetarët civilë të këtij vendi do të gjenin një partner te Kreu i Shtetit, për të diskutuar hallet e shoqërisë, e jo për të dëgjuar hartime bajate.

Për të gjithë ata që kanë probleme me kujtesën, më 20 mars një grupim i fuqishëm i shoqërisë civile protestoi përpara dyerve të Presidencës, duke kërkuar nga Kryetari i Komisionit të Sigurisë të merre masa për parandalimin e krimin të pedofilisë dhe të abuzimit me të miturit. Rreth 300 njerëz, dhe njerëz me penë, firmosën peticionin drejtuar z. Nishani, po ky peticion që ju dorëzua institucionit në mënyrë zyrtare, humbi pa nam e nishan. Dhe që nga ajo ditë e deri më tani, rastet e pedofilisë kanë qenë të panumërta.

Po kujtojmë disa prej tyre sa për të freskuar ndjesitë e përgjumura: dy raste në Tiranë, një person 67 vjeç dhe një tjetër 58 vjeç u arrestuan për tentativë të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të mitur; një 59 vjeçar në Ndroq kreu veprime të shëmtuara me një të mitur; një student rëmbeu një fëmijë 8 vjeç me qëllim trafikimi; një 53 vjeçar nga Korça i shkruan një letër dashurie një vajze 13 vjeç; një person 32 vjeç sulmon seksualisht një 12 vjeçare në mes të ditës në mes të Durrësit; një person 49 vjeçar ngacmon seksualisht një vajzë 12 vjeç; një pedofil shqiptar i dënuar me 20 vjet burg ekstradohet nga Italia; një pedofil 20 vjeçar arrestohet... ▶ vijon në faqe 21

INTERVISTA

▶ Faqe 4

'KOÇO KOKËDHIMA, SI E NJOH UNË'

"I preferuari" i Ramës në sytë e ish-gazetarit të tij

NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Lëndë të para për restorante,
piceri, kreperi dhe fast food.

TUBORG
rifreskon pamjen
e berrës më të
mirë të prodhuar
nga 100% malt
LEXONI NË
FAQEN 12



Intervista

DILEMA Ilir Meta u përgjigjet pyetjeve: A është Berisha një burrë shteti? A është Rama kryeministri që i duhet Shqipërisë pas 23 qershorit?

Ilir Meta: Ja sfida ime e vërtetë

Kryetari i LSI mes të shkuarës dhe të ardhmes

■ ■ ■ TIRANE

EDMOND ARIZAJ

Ilir Meta, kryetar i LSI, ka zgjedhur Mallakastrën për të dhënë një intervistë për Shqiptarja.com. Zgjedhjet, marrëdhëniet me Ramën, me Berishën, aleancat e prishura dhe ato të bëra, fëmijët e tij që po marrin nga politika, janë disa nga temat e bisedës. Gjatë rrugës, Meta ka zhvilluar në fakt me dhjetëra takime, që nga fasonët në Fier, e deri me vendalinjte e Mallakastrës. Batuta më e bukur e tij, ishte për të ardhurit rishitaz nga PD në LSI. "Edhe në 1992, kur unë kandidoja për PS, dajallarët e mi, bënin fushatë me PD"...

Zoti Meta, pashë në takimin tuaj edhe kandidatën e Partisë Socialiste në Tiranë, Spartak Braho...

Baba Taku ka lindur i lirë, dhe do të vazhdojë gjithmonë të jetë i lirë dhe autonom në vendimet e tij.

Slogani juaj është "të ecim më shpejtë". Si keni ecur deri në një prill të këtij viti?

Vetë afirmimi i këtij slogani, flet për mospajtimin e LSI-së me ritmin që ka ecur vendi në vitet e fundit dhe me besimin në potencialet shumë të mëdha që ka Shqipëria, por dhe që mund të zgjojë edhe vetë LSI-ja, për të ecur më shpejt jo vetëm në rrugën e integritit, por edhe të përballimit të stanjacionit ekonomik dhe të problemeve sociale në rritje për çdo familje shqiptare.

Ju ka mbetur ndonjë peng nga qeverisja me Sali Berishën?

Absolutisht asnjë merak. Që në momentin që ne vendosëm të bëjmë marrëveshjen e koalicionit kemi qenë të bindur se duke qenë edhe një risi duke kapërcyer edhe një tabu, duke patur në mendje edhe kompleksin e situatës politike në vend, kemi qenë të ndërgjegjshëm që nuk do të ishte një koalicion i lehtë dhe as një qeverisje po kaq e lehtë. Por mund t'ju them me bindje se ka funksionuar shumë më mirë se çështje menduar apo parashikuar në momentet kur kjo marrëveshje ndodhi.

Në këto katër vite qeverisje, a keni qeshur ndonjëherë me vete se si vijnë rrethanat; dikur kur ishit kryeministër, z.Berisha është ndaluar për disa orë nga policia, ndërsa pas 2009 ishin zv-kryeministër i Berishës?
(Mendohet)

Ta përsis edhe njëherë?

Mendoj se politika në rradhë të parë është mundësia për t'i shërbyer të ardhmes dhe për



ta kuptuar të ardhmen. Në këtë këndvështrim unë mendoj se në politikë nuk ka dhe nuk do të ketë raporte armiqësore dhe përjashtuese dhe të gjithë duhet të shikojnë përpara, pasi cilido duhet të ketë të qartë se vendi edhe përsa i takon të ardhmes, por edhe të kaluarës, do të vlerësohet në sajë të kontributeve të jep për të përmirësuar diçka më shumë.

A menduat qoftë edhe për pak momente, po e lidh këtë pyetje me atë pak më lartë, se Berisha mund të hakmerrej?

Nuk kam pasur asnjëherë shqetësim dhe paragjykim të tilla, sepse unë gjithmonë kam patur dhe kam besim tek vetja ime dhe në marrëdhëniet e drejta që në tërësi ndërtoj me të gjithë dhe e kam ditur fundin e kësaj odiseje, sepse kam ditur edhe fillimin.

Meqë jemi tek videoja, sa u besoni tani miqve tuaj?

Unë nuk ndërtoj marrëdhënie bazuar në paragjykimet dhe nuk gjykoj fenomene të shëmtuara, të cilat janë të hershme që në fillimet e njerëzimit. Unë gjithmonë përpiqem të besoj tek vlerat e mira, të njerëzve, të miqve, të shokëve, të bashkëpunëtorëve dhe nuk kam rreshtur dhe nuk rresht së dhënuri mundësi të gjithëve të ndërtojnë personalitetin e tyre dhe këtë do ta vazhdoj për aq kohë sa të jem në politikë.

Nëse pas 23 qershorit e majta do të jetë fituese, si do të ndikoni ju në qeverisjen e re, që "kokëpalarët" të jenë të larë e të pastër?

Unë besoj se pas 23 qershorit, të gjithë qytetarët shqiptarë do të ndihen më pranë njëri -tjetrit dhe politika të mos ketë këtë ngarkesë të pamerituar që ka në jetën e çdo qytetari dhe në çdo familje, gjë që reflektohet edhe me vendin e jashtëzakonshëm që ajo zë në media ku praktikisht është media ndonjëherë që e bën politikën më agresive se ajo çështje në të vërtetë.

Fëmijët tuaj po rriten vetëm me politikë z. Meta?

Kjo varet nga natyra e tyre, nuk është e përgjithshme. Djali është shumë i distancuar nga politika...

Por vajza e madhe juaj...

Është (vazhdon flet për djalin) i apasionuar pas shkencave teknike dhe teknologjisë. Ditët e fundit ka marrë pjesë në një konkurs ndërkombëtar për teknologjinë në Indonezi...

Urime...

Shpresojmë të ketë dalë mirë, sepse akoma nuk kemi patur mundësi të komunikojmë.



Ndërsa për vajzat ndoshta ngaqë ato shqetëohen më shumë me Monikën, mund të kenë një ndikim më të madh për politikën. Por unë dëshiroj që të jenë të pavarur.

Meqë e përmendët, zonja Kryemadhi në Lezhë...Kush vendosi për këtë, ju apo vetë ajo, dhe të lutem mos më thuaj që vendosi kryesia?

Së pari nuk ka qenë aspak vendimi im. Së dyti ka qenë një kërkesë, një insistim, i strukturave të LSI të Lezhës, i kryetarit të bashkisë së Lezhës dhe mendoj që është një sfidë, nuk është një favor, sepse qarku i Lezhës është i vështirë ende për LSI, pavarësisht përmirësimeve të mëdha që kemi bërë.

Meqë jemi këtu, ju jeni një politikan agresiv, edhe egosist. Si ka mundësi që bashkëshortja juaj, mban ende mbiemrin e saj dhe jo tuajin?

Sepse unë në rradhë të parë jam shumë tolerant (qesh).

Z. Meta, prej vitit 2004, a keni thënë ndonjëherë me vete, në djall të gjitha, po e lë këtë parti se më mori rininë?

Asnjëherë. Ka qenë një vendimi im shumë i vështirë për të iniciuar një forcë të re politike, sepse ka qenë plot me të panjohura. Dhe praktikisht duke marrë një iniciativë të tillë është rrezikuar çdo gjë, por vetëm me një bindje dhe një besim tek përvoja që kisha fituar në politikë dhe shumë bashkëpunëtorë të tjerë, nuk duhet të shkonte dëm, por duhet t'i shërbente demokratizimit të jetës në vend dhe të sfidonte një përpjekje 15 vjeçare të dy partive kryesore për të bllokuar çdo mundësi tjetër politike.

Gjithë LSI, LRI e LGI, flasin në emrin tuaj, ecin në emrin tuaj. A shkon shprehja, e gjithë LSI merr frymë me mushkëritë e Ilir Metës?

Kjo nuk është e vërtetë. Madje unë kam nisur të marr frymë më lirish, sepse psh meqë e përmendët LRI, tashmë është një forum tepër i konsoliduar, që funksionon pothuajse në mënyrë të pavarur...

Si FRESH juaj dikur?

Pse jo dhe më mirë...

Ju është vënë ndonjëherë kundër LRI?

Sigurisht që ka pasur raste që edhe ata kanë pasur mendimet dhe bindjet e tyre. Por nuk është e domosdoshme të jesh kundër që të kesh tipare modernizuese, reformuese...

Kjo shpreh njëfarë pavarësie?



NË FOTO: Ilir Meta gjatë një takimi me të rinjtë (lart) Monika Kryemadhi

FAMILJA Dy vajzat e Ilir Metës më të dhëna pas politikës, ndërsa djali i dhënë pas teknologjisë. Kush vendosi që Monika Kryemadhi të kandidojë në Lezhë.

kaluarës. Nuk kemi të bëjmë me një raport mes dy individëve, por me një raport mes dy forcave politike, ku dy drejtues të tyre kanë marrë përgjegjësitë e tyre.

Nëse bëjmë një krahasim, kush u ka qëndruar më shumë marrëveshjeve me ju, Nano, Rama, apo Berisha?

Nga përvoja e deritanishme, marrëveshja që ka funksionuar më mënyrë më të qëndrueshme dhe më të pranueshme, ka qenë ajo me z.Berisha.

Do ta miratoni vendimin e parë të Ramës për heqjen e fotografisë së Bujar Nishanit dhe vendosjen e asaj të Ismail Qemalit?

Nuk është kjo çështja më e rëndësishme që preokupon qytetarët tanë. Çështja më e rëndësishme për mua është ajo që ka të bëjë me likuidimin e gjithë borxheve publike që qeveria dhe shteti u kanë kompanive private, e cila ka krijuar një kolaps të vërtetë ekonomik dhe financiar...

Ndoshta nuk e dëgjuat mirë, po ju përsëris pjesën e parë të pyetjes...Do ta miratoni vendimin e parë të Ramës?

Kjo është një ide e tij lidhur me çështjet...

Nuk e kam shtuar fjalën kryeministër, por po them, vendimin e parë të Ramës...?

...që kanë të bëjnë me ligjet, me kushtetutën...

Ok, vazhdojmë. Ju i keni disa precedentë për prishje alencash me Ramën. Nga 1 deri në 10, sa është mundësia që kjo aleancë e re, të prishet?

Asnjë marrëveshje deri më sot nuk është prishur për shkak të LSI, ose Ilir Metës dhe nuk kemi pse të paragjykojmë të tjerët kur bëjnë një marrëveshje me ne.

Ju besoni që ju votojnë ju si Ilir Meta, apo për programin e LSI?

Unë besoj se ata votojnë mesazhin e LSI-së, që është gjithmonë një hap para të tjerëve.

Pse një qytetar që nuk voton të djathtën, duhet t'ju zgjedhë ju si LSI dhe jo Partinë Socialiste?

Besoj se LSI ka elektoratin e saj të qëndrueshëm dhe ka të gjitha ato tipare që e bëjnë tashmë një zgjedhje të konsoliduar dhe gjithnjë atraktive për të gjithë ata që kërkojnë të ecin më shpejt.

Z.Meta, a keni frikë për 23 qershorin se mund të ndodhë ndonjë "vëdhje" votash?

Nuk egziston për mua një shqetësim i tillë sepse unë besoj që situata është e qartë për të gjithë. Ushqimi i psikozës së pavarësisht se nga e vërteta që duket dhe preket nga të gjithë mund të vihet dorë mbi zgjedhjet, vjen nga paniku i humbjes dhe nga nervozizmi, duke kërkuar të trysnojnë shqiptarët.

Të hënën do jeni në Kuvend?

Presim informacione më të qarta lidhur me kohën se kur do të mbledhet Kuvendi, në rast se do të mbledhet dhe me rendin e ditës, në mënyrë që të kemi vërtetë një moment serioziteti dhe përgjegjshmërie nga Kuvendi në raport me çështjen kryesore, tre ligjet.

Ju besoni se do të riformatohet KQZ?

Më duket e pamundur që të rivendoset integriteti i KQZ dhe në këto kushte po shkohet me gjysëm KQZ në zgjedhje, por e theksoj impenjimin tonë dhe gadishmërinë tonë për të marrë pjesë në të gjitha nivelet e tjera zgjedhore dhe për të mbrojtur votën e çdo qytetari. Megjithatë nëse pozita është e gatshme për riformatim...

Nëse pavarësia është thjesht të jesh kundër, është ana sipërfaqësore. Por LRI është gjithmonë me iniciativë të reja me ide të reja dhe njëkohësisht ka arritur të krijojë edhe një lidhshmëri të ri dhe po përgatit edhe figura të tjera, sepse ne i kushtojmë shumë rëndësi konsolidimit të një tradite tek lëvizja rinore, duke e parë këtë forum si një universitet për të gjithë politikanët e rinj dhe të ardhshëm të LSI.

Z. Meta, a keni pasur ju ndonjëherë të dhëna se pjestarë të qeverisë në pushtet kanë abuzuar me të, pra me pushtetin?

Sigurisht që kemi patur dhe sigurisht që kemi mbajtur edhe qëndrime të caktuara...

I keni shmangur politikisht?

Ne nuk shmangim politikisht...

I keni denoncuar?

Kemi ndërmarrë ato lëvizje që janë të rëndësishme në këto raste dhe kemi qenë gjithmonë të distancuar ndaj cilitdo që mund të ketë patur probleme me ligjin dhe asnjëherë nuk kemi marrë në mbrojtje dikë politikisht. Por në këto çështje, mendoj se ka patur një përpjekje të sforcuar edhe nga segmenti të PS për të përqëndruar gjithë goditjen negative ndaj qeverisë ku ne bënim pjesë, tek përfaqësuesit e LSI, por ka pasur edhe një interes do të thosha edhe të elementëve të caktuar në Partinë Demokratike që gjoja problemet negative të qeverisjes t'i transferonin tek LSI. Por ky nuk ka qenë dhe nuk është një shqetësim ynë, ne kemi marrë të gjitha përgjegjësitë, të gjitha kostot dhe ajo për të cilën ne vlerësohemi mendoj se është pikërisht ajo se ne dimë të mbajmë përgjegjësitë.

Ju jeni një politikan i vjetër dhe i rrahur me vaj e uthull, siç thonë. Kush sipas jush ka qenë kryeministri më i mirë i Shqipërisë, nga koha e Mehmet Shehut deri më sot...përrjashtur ju vetë?

(qesh). Nuk mendoj se kjo është një pyetje që më takon mua të përgjigjem dhe shpresoj që vendi në të ardhmen të ketë një demokraci më funksionale dhe të ketë një qeverisje me një llogaridhënie më të lartë se sa deri tani dhe kjo për arsye se do të mund të minimizonim vendime të karakterit emocional, apo arbitrar që vijnë për shkak të dëshirës për një protagonizëm individual.

Po ju bëj disa pyetje dhe ju lutem një përgjigje, po, ose jo.

A është Berisha një burrë shteti?

Jo.

A ishte Rama, kryetari që i duhej PS

në 2005?

Nuk kishte tjetër.

A është Rama, kryeministri që i duhet Shqipërisë, pas 23 qershorit?

Koha do ta provojë.

A kishte mundësi Ilir Meta të vazhonte të qeveriste me Berishën?

Po, por kjo nuk ishte në interes të vendit, për të ardhmen.

A është Ilir Meta një kryeministër potencial pas 23 qershorit?



Sali Berisha dhe Edi Rama

Kjo nuk është sfida ime më e madhe.

A është lista e LSI më e mira e mundshme?

Po.

A është konsultuar me ju një pjesë e listës së PS?

Jo.

As emri i Spartak Brahos?

Është aq autonom dhe i lirë, si në përgjigjen e parë që të dhashë.

A egziston një marrëveshje e shkruar mes jush dhe Ramës?

Është marrëveshja e Shkodrës.

A e keni përcaktuar ju dhe Rama qeverinë e ardhshme?

Jo, atë do ta përcaktojnë qytetarët në 23 qershor.

Do merrni mendimin e tyre për ministrat?

Natyrisht edhe rezultati edhe vota në çdo qark do të jenë të rëndësishme për të kuptuar peshën dhe kredibilitetin e të gjithë figurave dhe përfaqësuesve.

A i duhet PD një tjetër kryetar?

Po.

A ju merr malli për kohën kur ishit kryeministër?

Jo, më shumë më merr malli për kohën e FRESH.

A keni ju një marrëveshje me Luzlim Bashën?

Marrëveshja nuk egziston më për shkak të veprimit të dhunshëm të PD me anëtarin e KQZ, propozuar nga LSI.

A ka ndikuar Edi Rama në shkëputjen tuaj nga PS?

Ai nuk ka qenë kryetar i PS.

Indirekt?

Kjo nuk është e rëndësishme.

A keni besuar ndonjëherë se Rama ka konsumuar lëndë narkotike?

Kjo nuk është një pyetje për mua.

A e meriton politika shqiptare atë shprehjen e vjetër, politika është...?

Gjëja më e thjeshtë është t'i gjejmë të gjitha të këqijat tek politika, por mendoj se duhet të rritet dikimi i shoqërisë mbi politikën dhe jo i politikës mbi shoqërinë dhe kjo do të thotë që çdo qytetar duhet të marrë më shumë përgjegjësi dhe të punojë për të rritur rolin e tij për shoqërinë dhe vendin.

Z.Meta, pse i besoni Ramës sot. Çfarë ka ndryshuar tek ai?

Kjo pyetje dhe pyetje të tilla si këto duan ta fusin politikën shqiptare në qerthullin e raporteve personale dhe historive të së



Intervista

Lajmi

Në intervistën e tij, gazetari Poli Hoxha bën një "portret" të kandidatit për deputet të Partisë Socialiste, Koco Kokëdhima. Përplasjet e tij me Berishën, gazeta "Shekulli", risitë dhe c'mund t'i sjellë Kokëdhima politikës shqiptare

TIRANE

Zoti Hoxha, ju bëni pjesë, në atë plejadë gazetarësh që keni më shumë se 15 vjet aktivitet, në median profesioniste. Çfarë ndjesie patët kur mësuat, se një ndër botuesit më të njohur në vend, zoti Koço Kokëdhima u prezantua nga Partia Socialiste, si kandidat për deputet në Qarkun e Vlorës?

Është e vërtetë që kam një karrierë të vullshme në gazetari, prej më shumë se 15 vitesh. Koincidençë është, se fillimet e mia si gazetar profesionist lidhen me gazetën "Shekulli", që në periudhën kur ajo u ideua dhe themelua me pasion dhe dashuri, nga zoti Kokëdhima. Lajmi për kandidimin e tij më befasoi, nga këndvështrimi që kam njohur unë zotin Kokëdhima, si një person me integritet dhe autoparvësi, të cilën e kam ndeshur, rrallë të shumë njerëz publik në Shqipëri. Ai mund të ishte futur në politikë kur të donte, por në dënimin time, karakteri i tij individualist në kuptimin e mos rreshtimit, kritikizmi i përhershëm për nivelin dhe integritetin e klasës politike shqiptare e ka bërë, që të mos përzihet drejtëpërdrejt në politikë. Në këtë kuptim, lajmi për kandidimin e tij, nën siglën e partisë më të madhe opozitare, më erdhi i papritur. Por nga ana tjetër këtë angazhim të drejtëpërdrejt të tij në politikë, e shoh të vonuar. E them këtë, sepse pikërisht vetshëmangia nga politika, e një plejade të madhe intelektualësh, protagonistë të zhvillimit të shoqërisë shqiptare postkomuniste në të gjitha fushat, ka bërë që niveli i klasës politike shqiptare dhe veçanërisht i ligjvënësve të jetë skandaloz, shpesh edhe poshtë nivelit mesatar të gjithë popullsisë të cilën pretendojnë se e përfaqësojnë. Prandaj jemi këtu ku jemi, pas 22 vitesh: në një demokraci hibride që lëngon nga një tranzicion, që duket si një tmerri pa fund. Do të doja që në parlamentin e ardhshëm të kishte, sa më shumë "Kokëdhima".

Kandidimi i zotit Kokëdhima ka hapur shumë debate, në rrethet politike dhe ato media-tike. Emri i tij, veçanërisht nga kryeministri aktual dhe kryetari i Partisë Demokratike përmendet çdo ditë, në këtë fushatë të ndezur elektorale. Duket sikur ai dhe mediet e tij vasale mezi e kanë pritur këtë kandidim, për të sulmuar opozitën dhe veçanërisht kreun e saj Edi Ramën. Cilat janë arsyet e kësaj fushate të papacedent sulmesh?

Nëse zoti Kokëdhima do të më pranonte një këshillë, për situatën e papacedent të përgojimit të emrit të tij nga Berisha dhe mediet, që gëlojnë brenda gardhit të kullës së tij, ajo



INTERVISTA Flet gazetari dhe kryeredaktori i gazetës "Integrimi" Poli Hoxha. "Do t'i sugjeroja diçka Koço Kokëdhimës, "të falënderojë" Berishën për hyrjen në politikë"

NË FOTO: Koço Kokëdhima

(poshtë) Kokëdhima gjatë prezantimit si deputet në qarkun e Vlorës

qenia aty e kolegut tona Alfred Peza, ish kryeredaktor i gazetës "Shekulli", në kohët më të suksesshme të saj. Jam i bindur se mungesa e një ligji të plotë për mediet që të pasqyrojë zhvillimin e vullshëm të saj, problemet me shpërndarjen në gjithë territorin e vendit, shitjen e gazetave që ende dergjen tezgave nëpër cepa rrugësh, me status si të bananeve me çmim të lirë, çështja e reklamave, punës në të zezë etj etj, do të jenë ndër çështjet e para për të cilat deputeti Kokëdhima do të luftojë në parlamentin e ri.

Çfarë kontributesh i njihni ju atij, duke u nisur nga eksperiencia tuaj personale në mediet e tij dhe në gazetari në përgjithësi?

Nuk shtrohet çështja se çfarë kontributesh i njoh unë personalisht. Çështja shtrohet më gjerë. Nëse në këto 22 vite demokracia foshnjare shqiptare ka arritur diçka të saktë, pavarësisht problemeve të rritjes, ajo është media e lirë dhe e pavarur. Dhe padyshim një nga protagonistët më kryesorë në këtë sipërmarrje titanike është zoti Kokëdhima, veçanërisht me gazetën "Shekulli". Sot kushdo mund të thotë çfarë të dojë, por ajo gazetë ka qenë së pari, tribuna e mendimit të lirë. Në faqet e saj kanë gjetur vend për tu shprehur, duke u anancuar njëkohësisht, gati e gjithë klasa politike dhe intelektuale shqiptare, duke përfshirë këtu edhe vetë Berishën dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë. Kjo gazetë në mënyrë gati heroike, ka qenë gjithmonë në krah të lexuesit, opozitare ndaj korrupsionit dhe abuzimeve me pushtetin, në të njëjtin rezonancë si kur ka qenë Partia Socialiste në pushtet, ashtu edhe ajo Demokratike. Unë kam drejtuar shumë gazeta dhe e di nga brenda se çfarë sakrificë është për botuesit, për të mbajtur një gazetë të pavarur, të lirë. Duam ajo jo, zoti Kokëdhima tashmë e ka shkruar emrin e tij, në krye të faqes së parë të historisë së medies postkomuniste shqiptare.

A mendoni se zoti Kokëdhima ka cilësitë e duhura, për të përfaqësuar Qarkun e Vlorës dhe veçanërisht zonën e Bregut dhe Sarandës, të njohura këto si vendet më të bukura në vend, me potenciale turistike, natyrore, historike dhe pasuri të pafundme të traditës?

Unë kam punuar me zotin Kokëdhima, e njoh edhe nga afër në marrëdhënie jo pune. Përveç të tjerave gjëja që më ka bërë më shumë përshtypje tek ai, është dashuria dhe lidhja e tij me vendlindjen, deri në fiksim do të thosha. Kush e njeh nga afër zotin Kokëdhima, patjetër ja ka vënë re obsesionin e tij për qënësimin shqiptar. Jam i bindur, se një nga arsyet kryesore, në mos më kryesore, e vendimit të tij për të bërë pjesë e ligjvënësve të ardhshëm, është dashuria dhe brenja që ai ka, për zonën më të bukur dhe të pasur nga zoti, siç është Bregu dhe Saranda. Jam i bindur që ai në parlamentin e ardhshëm, edhe përpara interesave të kësaj brende qeverisjes së ardhshme të forcës politike që përfaqëson, do të vërë nëpërmjet integritetit personal që e karakterizon, interesat e atyre banorëve të bekuar nga natyra dhe zoti, por të dënuar në këto 22 vjet me varfëri, nga klientët e klasës së korrupsuar politike. **Pl.Sh**

'Koço Kokëdhima, si e njoh unë'

"I preferuari" i Ramës në sytë e ish-gazetarit

do të ishte: Falenderojë publikisht Berishën! E them këtë sepse, në një kuptim të caktuar zotin Kokëdhima, në politikë e ka "futur" vetë Sali Berisha. Dhe nuk bëhet fjalë vetëm për këtë periudhë pas kandidimit të tij zyrtar, ku emri i tij nga kryeministri përmendet dhjetëra herë në ditë, kudo dhe me këdo, në parlament e në mblidhje qeverie, përpara fshatarëve me fytyra të drobitura të cilëve ju premon "mrekullinë" e radhës, e mes peshkatarëve...të mos flisim për mediet-biznese të tij. Por unë kam

15 vjet që dëgjoj nga goja e Berishës, sa herë i jepet rasti, emrin e Kokëdhimës. Madje i është "futur" edhe brenda në shtëpi dhe i ka numëruar objektet e koleksionit të tij privat. Nëse zoti Kokëdhima do të kishte durim e të mblidhte akuzat monstruoze të Berishës ndaj tij, të bëra në vite, mund të rezultonte një kryevepër satanike me mijëra faqe. Një obsesion gati patolojik ndaj tij, si në opozitë ashtu edhe në rolin e të parit të vendit. Nëse zotit Kokëdhima do ti mbushej mendja, që së bashku me familjen e tij të kërkonte ndonjë ditë të bukur azil politik, jo vetëm në Evropë, por edhe në vende të botës së tretë, do ta kishte fituar atë në sekondë. Aq shumë është sulmuar me shpifje e është kërcënuar publikisht nga kryeministri i një vendi që aspiron anëtarësimin në Bashkimin Evropian një ndër botuesit më të njohur të vendit dhe një biznesmen që paguan miliona euro taksa, sa që do të alarmonte autoritetet e çdo shteti normal. Berisha e akuzon mes të tjerash zotin Kokëdhima, për marrëdhënie klienteliste me kreun e opozitës Edi Ramën, veçanërisht për periudhën

kur ai ka drejtuar Bashkinë e Tiranës. Por a nuk ngriti Berisha një Komision Hetimor ndaj Ramës si kryetar Bashkie? Nuk ka opelë letër pa qëmtuar dhe si përfundim nuk kapi dot as edhe një shkelje, në procedimin e punëve publike në kryeqytet sa për ta çuar, goftë edhe formalisht në prokurori. I akuzon poshtë e përpjetë bizneset e zotit Kokëdhima, si të dëshimta. Për 8 vjet ka pasur në dorë shkopin dhe arrën, ushtarët e tij më besnik deri në qorrësi, kanë drejtuar e drejtojnë institucionet e taksave e tatimeve, Agjencinë e Pri-

koncesione...pa folur për milionat e reklamave. Por nga ana tjetër ai diçka e ka arritur në këtë luftë. Bizneset ja stopoi, por ama nuk ja mbylli dot sic kishte premtuar. Mediet ja goditi në thembrën e tyre të "Akilit", që janë financat, duke mos i dhënë as një qindarkë reklamë shtetërore gazetës më të madhe në vend, duke shkelur hapur ligjin. Por ama, gojënj nuk ua mbylli dot. Kushdo mund të futet në motorin më të madh të monitorimit të medieve në botë eëë.alex.com dhe mund të shohë, se gazeta shekulli online ka qindra mijëra lexues në ditë, nga çdo cep i botës.

Në këto 22 vjet pluralizëm, pavarësisht lulëzimit të papcedent të medieve në Shqipëri, qeveritë dhe ligjvënësit kanë bërë pak ose aspak, për të ndihmuar mediet dhe vendosjen e rregullave të lojës, në këtë shtyllë të domosdoshme të demokracisë. Mendoni se Kokëdhima si një njeri me përvojë dhe eksperiencë të suksesshme, do të jetë në parlamentin e ardhshëm, një kontribues dhe zë i fortë?

Klasa politike dhe qeveritarët në këto 22 vjet, vetëm kanë marrë nga mediet. E çfarë do të ishin ata pa medien? Asgjë, anonimë të parëndësishëm. Por kur vjen puna për lëvizimin dhe krizat që kalon ajo, nuk lëvizin as gishtin, madje kur ju ngleqet qefji nga raportime korrekte dhe denoncuese, nisin sulme me të gjitha mënyrat për të dhënë mesazhin e kok-uljes dhe nënshtrimit. Është një lajm i mirë për të gjithë komunitetin mediatik, qenia në parlamentin shqiptar, e një botuesi tashmë të kolauduar në këtë fushë si zoti Kokëdhima, por edhe





Idrizi prezanton

Muhedinin për deputet,

flet për programin e PDIU

Partia Drejtësi, Integrim, Unitet ka vijuar takimet elektorale në qarkun e Tiranës. Kryetari i PDIU-së Shpëtim Idrizi, gjatë një takimi me banorët e Njësisë Bashkiake Nr.1 në zonën e "Ali Demit" ka prezantuar kandidatin për deputet të Qarkut të Tiranës, Tahir Muhedin. Gjatë fjalës së tij, kryetari i PDIU-së Shpëtim Idrizi nuk nguroi as të shpaloste dhe pjesë nga programi politik i

PDIU. "Të nderuar qytetar të "Ali Demit", më ka takuar gjatë gjithë kësaj kohe që të flas në vende dhe podiume nga më të ndryshimet, por është e jashtëzakonshme që të flasësh aty ku ke lindur, aty ku je rritur, aty ku je frymëzuar, aty ku ti ke marr emër dhe unë jam i lumtur që gjatë kohës kam qenë, jam dhe do të mbetem, një djal i "Ali Demit". Sot unë jam në shtëpinë time, në lagjen time,

kam parë dhe shohë midis jush shumë nga ato djem dhe vajza me të cilët unë kam bërë rrugëtimin e jetës. E jo rastësisht miqtë e mijë, ne kemi ardhur këtu për t'ju prezantuar për kandidat për deputet, prapë një djal nga "Ali Demit", mikun tim Tahir Muhedinin", tha Idrizi. Ai kërkoi mbështetjen e qytetarëve të Tiranës duke garantuar rolin kryesor që do të luajë PDIU në Parlament.

Konventa e PD, Berisha akuzua duke shpalosur programin

'Rama i dështuar, mjeran për pushtet'

Bregu: Daullet do bien për humbjen tënde

Lajmi

PD çeli dje Konventën "Për Shqipërinë e zhvilluar", ku lideri i mazhorancës lëshoi akuza ndaj Ramës duke e cilësuar atë si një kryebashkiak të dështuar. Edhe nga anëtarët e tjerë të PD nuk kanë munguar akuzat ndaj programit të Rilindjes së PS-së.

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Partia Demokratike mboldhi konventën "Për Shqipërinë e zhvilluar", ku anëtarët e kësaj partie përveç shpalosjes së programit politike lëshuan akuza edhe ndaj liderit të opozitës. Konventa e PD-së, u çel nga numri dy i PD-së, Astrit Patozi, i cili duke sjellë në vëmendje arrijtjet e mazhorancës ndër vite, theksoi se PD nuk do të ndalet deri sa Shqipëria të bëhet anëtare me të drejta të barabarta ne BE. Ndërsa kreu i PD, Sali Berisha mes batutave dhe akuzave mbi kreun e PS tha se ai është një kryebashkiak i dështuar. "Ti shok në autobus, duhet të të them dy fjalë, në Shkodër u theksova se janë ndërtaur gjithsej 600 km, por kur Shkodra qeshi dhe u tall me ty dhe tu përgjigj se nga ura e Dritit në Fierzë dhe gjer në Velipojë nga Vermoshi gjer në Pukë, janë ndërtaur mbi 900 km rrugë. Nga autobusi yt, shpikë shifrën tjetër, 1 500 km rrugë, mjeran, mjeran, i shkretë, i padijshëm, asgjë nga punët shtetërore. Ke qenë kryetar bashkie, o piktor i dështuar. Mësoje, mësoje o piktor i dështuar se fondi shqiptar i rajoneve dhe grantet konkurruese gjatë viteve të qeverisë sonë kanë marrë për rrugë shkollla dhe ujësjellësa, 1 miliard e 50 milion dollarë. Ti je nga ata që ke marrë jo pak, por i bërë rroga dhe rrush e kumbulla me Koçon dhe le Tiranën pa rrugë. Mësohet se financat janë financa, se shifrat e financave janë të qarta dhe të sakta si rrezja e diellit, se ato nuk lëvizin me cantat e Koços apo valixhet e Fidelit, po lëvizin nga thesari në bankën e shtetit", iu drejtua Berisha Ramës.

TOPALLI
Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli deklaroi se kryeministri Sali Berisha dhe PD



Berisha në Konventën e PD-së

kanë një plan real për krijimin e 250 mijë vendeve të punës në katër vitet e ardhshme. "PD ka bërë gjithçka për integrimin e Shqipërisë në BE", tha Topalli duke shtuar se, PD ka përmbushur të gjitha kërkesat për marrjen e statusit.

OLLDASHI:
Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Sokol Olldashi

deklaroi se gjatë këtyre 8 viteve, janë ndërtaur 10 mijë km rrugë sepse rrugët janë shenjë e zhvillimit të vendit. "Ne ndërtojmë rrugë sepse e dimë se rrugët janë damarët ku kalon zhvillimi ekonomik i vendit. Rrugët dhe zhvillimi janë e njëjta gjë. Ka ca të tjerë që kanë humbur rrugën, janë në autobus. Janë duke dremitur në autobus. Sot në Kukës shkohet për 90 minuta

dhe për 2 orë 30 minuta shkon pi kafe në Prishtinë. Në këtë rrugë kalon dhe Edi e Kokëdhima, por nuk e sheh", tha Olldashi.


BREGU:
"Shqiptarët, socialistë apo demokratë, e duan Shqipërinë e zhvilluar, me vlera Europiane dhe nuk duan bllokimin", tha gjatë Kon-

Ftesa për Ramën

"Duke parë se je i sëmurë nga rrugët, unë jam mjek e kam të thjeshtë ta kuptoj se të ka zënë dromosfobia. Mendova të të ftoj 2-3 herë të inaugurojmë së bashku, por drauj se kjo kurë nuk të nxjerr nga sindromi ku ke rënë e ke gjet ilacjin. Ti rri në autobus ne do shtrijmë rrugët".

ventës, ministrja e Integritimit, Majlinda Bregu. Sipas saj "shesht mbushen me hirë nga qytetarët, e jo me pahir siç thotë kreu i PS, Edi Rama, që nuk di metodë tjetër veç asaj të robërisë për të mbledhur njerëz. Në Tetor kur Brukseli propozoi statusin për vendin tonë dhe na vuri kusht miratimit e tre ligjeve, të cilat u kthyen në refren për ne, si pasoi e një opozite bllokuese dhe antishqiptare. Edi Rama, kërkoi të shkatërojë gjithçka për hir të karrigës. Bjeri daulleve sa të duash se ato daulle binë për humbjen tënde", përfundoi Bregu.

Deklarata



Basha: Kërcënimi i drejtorëve, poshtërim


Kryebashkiaku Lulzim Basha ka ripërsëritur akuzat e kryeministrit Berisha për kreun e opozitës, Edi Rama, se është duke kërcënuar drejtorët e shkollave. "Nuk ka rrugë tjetër për t'i dhënë femijëve të kryeqytetit një bazë të shëndoshë për të konkurruar në BE, përveç mbështetjes që ju jepet shkollave dhe ç'është më e rëndësishme nga mësuësve dhe drejtuesve të këtyre shkollave. Rruga që jepet ajo e kërcënimit të drejtorëve nuk është gjë tjetër veçse poshtërim, unë do thoja që fajin për fushatën e Ramës nuk e kanë drejtorët e kanë çiklistët. Ju do të thoni pse çiklistët? Unë do them pse drejtorët?", tha Basha.

Zgjedhjet

Auditi: Probleme me listat në Lezhë, nuk janë në KZAZ

E dhe pse Ministria e Brendshme ka deklaruar se listat e zgjedhëseve kanë përfundur së rishikuar për dublimet, duke se ende nuk janë zgjidhur problemet me këto lista. Pasi janë shmangur të gjitha dublimet dhe identifikimi i personave mbi moshën 100 vjeçare, zyra e gjendjes civile në prefekturën e Lezhës e cilëson të përfunduar procesin nga ana e saj, por ngre një tjetër problem. Shqetësimi përbën fakti se njësitë e qeverisë vendore nuk i kanë deponuar ende këto lista pranë Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, gjë për të cilën përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile Zef Gjinaja ka bërë të ditur se tashmë duhet ndërhyrja e institucionit të Prefektit për të zgjidhur këtë problematike, që siç duket është një shfaqje neglizhuese e drejtuesve vendorë. Por vonesat e

dorëzimit të këtyre listave pranë KZAZ dhe më pas në KQZ sjellin edhe ndëshkime me gjobë për drejtuesit e pushtit vendor në njësi të caktuara. Listat e zgjedhëseve kanë lënë të qetë politikanët në qarkun e Lezhës, duke e konsideruar si një proces tërësisht korrekt. Këto lista do të kalojnë më pas në procesin e verifikimit të tyre nga Ministria e Brendshme dhe më pas nga dy audiuesit e përzgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ndërkohë që këta dy audiues Dashamir Çali i propozuar nga ish-nënkryetari Denar Biba si dhe Genti Malko i propozuar nga kryetarja Left-



erie Lleshi pritet që të paraqesin në dhënat e tyre nga listat zgjedhore për verifikimin që kanë bërë në periudhën prill-maj mledhjen e ditës së hënë.

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjeçare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brënda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkalës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë

Tel: +355 4 2262 304 / Mob: 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



Debati, Edi Rama: Ligji drejtoreshë, jo më politizime

Kreu i PS Edi Rama i ka kthen përgjigje drejtoreshës së gjimnazit "Ismail Qemali", duke thënë se dje i kishte vënë gjoksin fushatës së PD në media. "I bënte jehonë kryeministrit që tha në miting se kryetari i opozitës paskej kërcënuar një drejtoreshë shkollë. Në fakt mjafton të lexosh dy mesazhet që i kam çuar drejtoreshës e që ajo i kishte bërë publike, për të kuptuar se jo vetëm nuk e kam kërcënuar

po jam përpjekur ta ndihmoj dy herë zonjën e pasjellshme duke i kujtuar detyrën e saj përpara kushtetutës e ligjit, mësuesve e nxënësve", shkruan Rama në blogun e tij. Ai tha se shtya për t'i telefonuar drejtoreshës u bë rrëfimi i një prindi, që i'u drejtua shumë e shqetësuar për faktin se e bija ishte joshur në shkollë me 200 mijë lekë të vjetra për t'u bërë pjesë e PD dhe votuar për PD. Rama bëri

thirrje të mos ushtrohet presion ndaj nxënësve e mësuesve. "Unë s'kërcënoj askënd kur them se pas 23 qershorit do vendosim përpara përgjegjësisë publike e ligjore çdo drejtor shkollë (e jo vetëm shkollë), që në shkelje të hapur të lirive e të drejtave kushtetuese si dhe të ligjit për arsimin, vendos veten në rolin e kapterrit të partisë në pushtet. S'është kërcënim, është zotim i yni", tha Rama.

Lajmi

Seanca plenare e ditës së hënë pritet që të jetë e rëndësishme për fatin e 3 ligjeve të integritetit si dhe për konsensusin që pritet të arrihet mes palëve.

Të hënën, verdikti për ligjet e integritetit dhe KQZ PD-PS marrëveshje për 3 ligjet e integritetit

Negociata mes palëve për konsensus

RREGULLORJA

NENI 42

SESIONET E PUNIMEVE TË KUVENDIT

1. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni i parë i punimeve të Kuvendit fillon të hënën e tretë të janarit, ndërsa sesioni i dytë të hënën e parë të shtatorit. Data e mbarimit të sesionit dhe ora e fillimit të sesionit të ri të punimeve të Kuvendit njoftohen nga Kryetari i Kuvendit.

2. Kuvendi thirret në sesion të jashtëzakonshëm me kërkesë të motivuar me shkrim të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të paktën një të pestës së të gjithë deputetëve. Kryetari thërret mbledhjen e Kuvendit jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e kërkesës, mbi bazën e një rendi dite të mbledhjeve të komisioneve dhe të seancës plenare të përcaktuar prej tij.

fuqi me Parlamentin e ri, në jemi shprehur dakord".

META

"Dua të falënderoj kryetarin e PS, Edi Rama për gatishmërinë e qartë dhe pa ekuivoke që ai demonstroi duke treguar vullnetin e plotë të forcës politike që përfaqëson për të miratuar tre ligjet, sipas kompromisit që ato të hyjnë në fuqi në shtator me Parlamentin e ri. Besoj se tani është koha e Kryeministrit aktual, z.Berisha për të treguar të njëjtin gatishmëri dhe qartësi pa ekuivoke, që ne në ditë që vijmë t'i votojmë këto tre ligje, t'i japim këtë mesazh të përgjegjshëm gjithë qytetarëve shqiptarë".

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Kur mbeten dhe pak orë nga mbajtja e seancës plenare të ditës së hënë, ku pritet të hidhen për votim 3 ligjet që mazhoranca i ka etiketuar si të integritetit, palët janë duke bashkëpunuar për arrijet e një konsensusi në pikat të veçanta. Thirrja e kryeministrit Berisha për të mbledhur dhe për të miratuar të hënën 3 ligjet si duke shtuar edhe amnistinë fiskale mori përgjigje pozitive të kryesocialistit Edi Rama. Burime bëjnë të ditur se nga dy partitë e mëdha kanë filluar negociatat nga përfaqësues të këtyre partive, ku janë duke shqyrtuar pikat në të cilat nuk kanë patur konsensus lidhur me ligjin për nëpunësit civil, Gjykatën e Lartë dhe rregulloren e Parlamentit. Por ende nuk dihet asgjë nëse palët do të bien dakort për plotësimin e vendeve vakante në KQZ apo do të kërkojnë rikonfigurimin e institucionit administrues të zgjedhjeve. Lidhur me këtë



Konsensusi

Burime bëjnë të ditur se nga dy partitë e mëdha kanë filluar negociatat nga përfaqësues të këtyre partive ku janë duke shqyrtuar pikat në të cilat nuk kanë patur konsensus lidhur me ligjin për nëpunësit civil, Gjykatën e Lartë dhe rregulloren e Parlamentit.

jektligjigj për ta kaluar në Kuvend. Gjithësesi rregullorja e Parlamentit ka të përcaktuar qartë se kur thërret seanca të jashtëzakonshme, pasi kjo konsiderohet e tillë duke marrë parasysh se në bazë të kalendarit të Konferencës së Kryetarëve, Parlamenti i mbylli punimet për këtë sesion që në datën 23 maj.

BERISHA

"U them se të hënën do mblidhet parlamenti për të votuar 3 ligjet. Ne shkojmë ballëhapur, se ne bëmë gjithçka për të merituar statusin e vendit kandidat. Ne çdo ditë kërkuam votimin e ligjeve, ndërsa ti vjen si mjeran në Parlament".

RAMA

"Qysh ditën e parë kur kryetari i LSI-së ka dalë me një paketë kompromisi për të miratuar të tre ligjet dhe vendosur që ato të hyjnë në

pikë PS ka propozuar që ka ende kohë që ky institucion të zgjidhet edhe një herë me të vetmin ndryshim që kryetari i tij të votohet nga Parlamenti me shumicë të cilësuar votash.

Apeli për futjen e KQZ, aktualisht me 4 anëtarë, në rendin e mbledhjes së hënës erdhi nga kryediplomati amerikan, Aleksandër Arvizu. Ndërkohë që për propozimin e

kryeministrit Berisha për votimin e amnistisë fiskale, kjo gjë është e pamundur pasi Ministria e Financave ende nuk ka përgatitur një draf ligjor në formën e pro-

Kreu i PS në Kamzë-Paskuqan

Rama: Legalizimet, do të kryesoj vetë procesin si kryeministër

TIRANE

Kreu i PS Edi Rama ka garantuar që gjithë ata që kanë shtypitë e palegalizuar do marrin certifikatën e pronësisë në dorë, ndërsa procesin e legalizimit do ta kryesoj vetë ai si kryeministër i ardhshëm i Shqipërisë. Një premtim të tillë lideri i opozitës e ka bërë në një takim të zhvilluar dje me banorët e Paskuqanit e Kamzës që jetojnë në zonën më të izoluar të kryeqytetit, të harruar nga shteti. Duke u ndalur tek problemi serioz për këta banorë, siç është ai i legalizimit të banesave të tyre, ai kërkoi të mos votojmë në qeverinë që si mbajtja premtimet vetëm për hir të originës, për tifoizllëk, por të votojmë për veten e tyre. Për të, Berisha s'ua legalizon



Edi Rama në Kamzë

banesat të ardhur nga veriu, sepse mendon se i ka në xhep. "Menjëherë sa të marrim votat do fillojmë procesin e legalizimeve për së mbari. Do ju zotohem të gjithë atyre që kanë shtypit

për të legalizuar se do jem unë në krye të këtij procesi. Dhe nëse këtu do jemi pas 4 vitesh e gjendja do jetë po kjo, ju që jeni socialistë s'duhet të jepni votën e të thoni t'ja japim këtij se është i joni, vota është investim. Më 23 qershor mos votoni si tifoiz por si qytetarë", shtoi Rama. Pas takimit me banorët e Paskuqanit, kreu i PS Rama e ka zhvendosur këndin e tij të fjalës në bashkinë e Kamzës. Para tyre u shpreh i bindur se Aleanca për Shqipërinë Europianë do fitojë në këtë bashki. Rama premtoi se do drejtojë vetë procesin e legalizimit të banesave, ndërsa i ftoi banorët të mos bëhen më pre e gënjeshtërve të Berishës. "Do ta heqim nga puna këtë Saliu e Kamzës", tha për kryebashkiakun Xhelal Mziu, për të cilin banorët patën edhe ankesa.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Nr. 109/2 Prot Tiranë, më 23/05/2013

Shpallja e Rezultatit të Konkurrimit

Në zbatim të ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statuti i Nëpunësit Civil" neni 13/c dhe V.K.M nr. 231, datë 11.05.2000 "Për Pranimin në Shërbimin Civil dhe Periudhën e Provës", pika 20, nga konkurrimi i zhvilluar në datë 20.05.2013 fitues për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Financës në Institutin e Avokatit të Popullit shpallet konkurenti:

Z. Ilirjan LOLE

Adresa: Buharë "Zhan D'Ank", Nr. 2
1001, Tirana - ALBANIA

Tel: +355 4 2380 300
+355 4 2380 333
Faks: +355 4 2379 826

E-mail: ap@avokatiipopullit.gov.al
Web-site: www.avokatiipopullit.gov.al



Fier, bashkia heq simbolet e partive në qendër të qytetit

Bashkia e Fierit ka ndërmarrë dje një flakion duke hequr banderolat dhe flamujt e partive politike të vendosura pa leje në sheshin qëndror "Nënë Tereza". Sipas Bashkisë së Fierit, vendosja e simboleve politike në sheshet kryesore publike, bëhet vetëm gjatë mitingjeve dhe më pas ato hiqen përsëri. Gjatë ditës së djeshme policia bashkiake, hoqi dekoret e Partisë Demokratike

dhe të Partisë Socialiste. Ndërkaq, përfaqësues të shtabit elektorale të PD-së në Fier, pretenduan se ka pasur një marrëveshje me bashkinë për vendosjen e tyre gjë që u hodh poshtë nga kreu i Bashkisë Fier, Bafjtar Zeqo. Gjatë heqjes, se simboleve të dy partive kryesore nuk pati incidente, pavarësisht qejfmbetjeve të rastit, këto të parashikuara në një situatë të tillë kur fushata elektorale tashmë ka filluar

zurtarisht. Ndërkohë që në dalje të sheshit mbetet vetëm banderola e Dritan Priftit, pasi për bashkinë nuk përbën shkelje pasi nuk është në vend publik. Për herë të parë partitë politike nuk kanë kontestuar një vendim të pushtetit vendor në lidhje me banderolat, ndërsa kohë më parë në kryeqytet një iniciativë të tillë të ish-kryebashkiakut Rama, partitë iu kundërvunë ashpër.

Të përjashtuarit nga listat e PD, pakënaqësi. Gati reagimi

Xhaferraj: Po merrem me mediat, në Durrës

“Jo koment për kandidatët, kriteret e zgjedhjes”

Lajmi

Deputetët demokratë të cilët nuk janë përfshirë në listat e kandidatëve për garën e 23 qershorit janë në pritje të një përgjigje nga ana e Berishës për përjashtimin e tyre, por dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e zëvendësuesve të tyre.



Mbledhje e grupit të PD-së

Reagimi

“Nuk kam asnjë koment për listën, as për kriteret, as për profilet e vlerësuar, por aktualisht po kontribuoj në zyrat e mediave në Durrës”, deklaroi dje Xhaferraj.



Ferdinand Xhaferraj dhe Sali Berisha

TË LARGUARIT E PD NGA KANDIDIMI

- Adriana Gjonaj
- Arencë Trashani
- Astrit Bushati
- Vath Tabaku
- Enkelejd Alibeaj
- Fatos Beja
- Fatos Hoxha
- Gjok Ulledaj
- Ramiz Çobaj
- Ndrim Babasi
- Ilir Bano
- Ilir Rusmali
- Jemin Gjana
- Kreshnik Çipi
- Lajla Përnaska
- Ledina Aliolli
- Leonard Demi
- Luan Skuqi
- Mark Marku
- Paulina Hoti
- Rajmonda Bulku
- Rrahim Çota
- Selami Xhepa
- Sybi Hida
- Vasillaq Ngresi
- Viktor Gumi
- Ylli Lama
- Koço Barka
- Mehmet Xheka
- Ismail Hoxha
- Rajmond Hoxha

TIRANE

JAKIN MARENA

Deputetët demokratë të cilët nuk janë përfshirë në listat e kandidatëve të PD ndihen jo vetëm të mënjnuar por dhe të fyer. Pasi s'kanë marrë asnjë shpjegim nga lideri i PD Berisha në lidhje me arsyen e lënies jashtë listave, por dhe kriteret që janë përdorur për të përzgjedhur kandidatët zëvendësues. Për më tepër që ndjehen të fyer pasi në listat e PD kanë zënë vend dhe 3 deputetë të PS, që sipas tyre, përpos kontributit që dhanë në votimin e ministrave e të shkarkimit të anëtarit të KQZ përfaqësues të LSI në fund të prillit s'kanë asnjë kontribut tjetër. Burimet brenda këtij grupi mësohet se më keq e kanë pritur lënien jashtë kandidimit

dorur për të përzgjedhur kandidatët zëvendësues. Për më tepër që ndjehen të fyer pasi në listat e PD kanë zënë vend dhe 3 deputetë të PS, që sipas tyre, përpos kontributit që dhanë në votimin e ministrave e të shkarkimit të anëtarit të KQZ përfaqësues të LSI në fund të prillit s'kanë asnjë kontribut tjetër. Burimet brenda këtij grupi mësohet se më keq e kanë pritur lënien jashtë kandidimit

3 krerët e komisioneve më të rëndësishme parlamentare Ilir Rusmali kryetar i komisionit të Ligjeve, Fatos Beja kryetar i komisionit të Jashtëm e Leonard Demi kryetar i komisionit të Sigurisë. Por jashtë listës së kandidatëve janë lënë dhe deputetë jo vetëm me kontribut

por dhe me mbështetje të gjërë, si Astrit Bushati, Fatos Hoxha, Kreshnik Çipi, Jemin Gjana, Luan Skuqi, Mark Marku, Selami Xhepa, Enkelejd Alibeaj etj. Ku dhe ata janë në pritje të një shpjegimi nga ana e Berishës. Nga ana tjetër jashtë liste ka mbetur dhe ish-ministri i Kulturës, këshilltar i kryeministrit Ferdinand Xhaferraj, që gjithsesi thotë se është në funksion të fushatës duke mbajtur zyrën e mediave në qarkun e Durrësit, ndërsa deputetë e funksionarë të tjerë, me disa përjashtime janë me pushime dhe s'janë përfshirë në fushatë, në mbështetje të kandidatëve të rinj të përzgjedhur nga Berisha. I kontaktuar nga gazeta “Shqiptarja.com”, Xhaferraj tha se është në fushatë në

Durrës, dhe po merret me mediat. “Nuk kam asnjë koment për listën, as për kriteret, as për profilet e vlerësuar, por aktualisht po kontribuoj në zyrat e mediave në Durrës”,

deklaroi dje Xhaferraj. Duke mos preferuar të flasë më gjatë. Mësohet se deputetët jokandidatë do presin dhe pak një shpjegim nga Berisha, për të reaguar më pas.

Arben Isaraj:

“Kredia” ime politike, jam “kolateral” i PS

Reagon deputeti i PS Arben Isaraj, që s'është në garën elektorale të 23 qershorit kandidat. “Degjova Shpëtimin e Vlorës, si e kam dëgjuar dhe ditë më parë në takimet e bisedat e mija në Vlorë, në këtë situatë zgjedhore. I mirëkuptoj të gjithë, Shpëtimin, Edmondin, Lushin, Platonin, Memin, Mondin, Tekiun, Zaren, e qindra miq dhe shokë të Vlorës. Ndaj për ta mbyllur diskutimin politik-publik për mua dhe mbi mua dua t'ju them se: “Partinë time Socialiste, s'e kam parë kurrë si politikë biznesi e analize kosto-fitimi (po më dha e mbaj, po s'më dha e hedh). Partia ime Socialiste më “kreditoi” politikisht në përzgjedhjen, evidentimin dhe aktivitetin tim si në ekzekutiv ashtu edhe në legjislativ. Trendi im i “përfitim politik” në vite ndryshe nga shumetë tjerë “debitorë” preferencialë, s'më krijoi mundësinë e “shlyerjes” së shëndetshme politike të kësaj kredie”, tha Isaraj. Sipas tij, është e vërtetë që sot, ky trend i “përfitim politik” është i ndërprerë. “Me apo pa të drejtë kjo s'ka më rëndësi për mua. Ndaj Shpëtim dhe të gjithë, shokë e miq socialistë vlonjatë, unë me modesti



Arben Isaraj

kam thënë se: Dje, sot dhe nesër mbetet vetëm “kolateral” i PS, për atë që më ka dhënë e ende s'ja kam kthyer. Po, Po, Jam thjeshtë, “Kolateral” i PS pa “barrë” a “hipotekë” morale, politike, ekonomike e aq më pak i varur nga politika e “patronazhit të posteve” që paskëtaj thonë se vijnë. Po, po... sot kam një “kredi” politike të pakthyer dhe të jeni të bindur se kam për t'ia shlyer PS”, tha Isaraj.

SALUS SPITALI ITALIAN MULTISPECIALISTIK

ME “SALUS” CILEZIA ITALIANE NE TIRANE

Sherbimet:

- Kardiologji
- Gastrohepatologji
- Endokrinologji-Diabetologji
- Laborator Analizash
- Radiologji (CT, MRI, EXO)
- Oculistike
- Otorinolaringologji (Falas)
- Ortopedi (Falas)
- Kirurgji e përgjithshme
- Kirurgji Estetike
- Neurokirurgji
- Mjeksi Internë
- Stomatologji
- Urologji
- Pediatri
- Gjinjekologji
- Check-Up

POLIAMBULATORI I RI SALUS NË QENDËR TË TIRANËS

- VIZITA FALAS !**
- Në qendër të Tiranës kemi hapur poliambulatorin e ri në rrugën Donika Kastrioti, afër dy Kullave Binjake. Këtu janë specialitetet dhe mjekët që do të gjeni dhe do ju presin:
- Gastroenterologji, Ekografi, Endoskopi digjестive - Dok. Emira Zyjak
 - Kirurgji e përgjithshme dhe Onkologjike (Tumore) - Dok. Luca Calligaris
 - Mjekësi e Organeve të brendshme dhe Diabet - Dok. Stefano Turchetto
 - Ortopedi - Dok. Mauro Cardinale - Dok. Leonardo Basso - Dok. Mauro Di Leo
- Përfitoni tani...!**

Për të lënë një takim, telefononi në:
Salus Tirana Sh.a. + 355(0) 4 2390500
+ 355(0) 66 2053 180

Traverbanku i kromit në Klos, nis puna për rindërtimin

Një projekt minerar, i nisur 26 vite më parë për ndërtimin e një tuneli nëntokësor, që lidh me hekurudhë impiantin e përpunimit të kromit në Klos të Matit me minierën e Bulqizës dhe i lënë përgjysëm, është vënë në zbatim këto ditë. Ky traverbank do të realizojë transportin e mineralit të kromit nga miniera kryesore e kromit në vend, ajo e Bulqizës në impiantin

e përpunimit të tij në qytetin Klos të Matit, nëpërmjet një rrjeti nëntokësor hekurudhor, duke ulur ndjeshëm kohën dhe shpenzimet e transportit, pra koston e produktit final. Ndërkohë, hapja e traverbankut shmanget edhe mundësinë e përmbytjeve nga uji të galerive të minierës nga niveli i pestë e sipër. Në ceremoninë e nisjes së punimeve për këtë traverbank

ishin të pranishëm drejtues të kompanisë "Albchrome", të ministritë së Ekonomisë dhe drejtues të pushtetit vendor. Administratori i "Albchrome" Luan Saliq, ndërsa vlerësoi impaktin që ky investim do të ketë në zhvillimin e kësaj zone, theksoi se shumë shpejt parashikohet fillimi i punimeve për një projekt që do t'i sigurojë jetëgjatësinë minierës së Bulqizës.

Fatura e ardhshme, dalin detyrime nga arkivat

CEZ kërkon kamata që nga janari 2007

Debitë ishin fshirë nga kompania çeke

Lajmi

Kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike do të kërkojë nga klientët kamata të vjetra, që deri tani ishin fshirë nga bilanci e këtij subjekti, që nga momenti që e mori në pronësi grupi çek, të cilit iu hoq licenca nga ERE

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Fatura e ardhshme e energjisë elektrike do të përmbajë një surprizë të hidhur për shumë familje, individë, institucione apo biznese. CEZ Shpërndarje, nën administrimin e të njëjtit administrator shtetëror që ishte para se të privatizohej, Sahit Dollapi, ka gjetur një metodë të re për të vjelë më tej para "të harruara" nga klientët, duke gërmuar nëpër arkiva. Burime nga kompania CEZ deklaruan për Shqiptarja.com se klientët nuk duhet të habiten kur t'u vijë fatura, në të cilën do të deklarohen debitoret për shumën, që më parë nuk figuronin në zërin "debi". Fjala është për "kamata në sistem", të cilat nuk pasqyrohen në rastin kur pagesat janë bërë pranë arkive të vetë kompanisë, pasi aty nuk të vulozet librezja pa paguar edhe kamatëvonesën. Por, ka shumë raste, madje të faturave voluminoze të kompanive të caktuara, kur këto pagesa janë kryer nëpërmjet rrugës bankare. Tani, duke nisur nga janari i vitit 2007, kompania ka hyrë në arkivat e saj për të gjetur kamata pikërisht për vonesa në pagesën e faturave dhe, duke qenë se fjala është për gjashtë vite, mund të përbëjnë edhe një detyrim marramendës.

Në shumë raste, bankat e nivelit të dytë më parë pranonin fatura që u kishte kaluar afati i rregullit i pagesës, por



NË FOTO: Administratori shtetëror i CEZ Shpërndarje Sahit Dollapi

pa faturuar kamatat. Janë pikërisht këto raste, krahas masave të tjera, pas të cilave Dollapi dhe grupi i tij i menaxherëve të rinj të CEZ-it janë kapur për të rritur të ardhurat dhe jo me shifra të vogla. Kjo mund të krijë një situatë me përmasa serioze pakënaqësie,



Deficiti

Gjobat e vjetra janë një nga masat, me të cilat Dollapi dhe grupi i tij i menaxherëve të CEZ-it mendojnë të rritin të ardhurat e një kompanie, e cila, vetëm për vitin e kaluar ka dalë me një humbje prej më shumë se 260 milionë eurosh

260 milionë eurosh.

Kjo masë tingëllon absurde, pasi për shumë vite klientët e CEZ-it mund të kenë marrë një faturë "të pastër", pra pa debi dhe papritur shpallen debitoret dhe jo me shifra të vogla. Kjo mund të krijë një situatë me përmasa serioze pakënaqësie,

e cila mund të menaxhohet nga qeveria në formën e një amnistie, e cila të lehtësojë qytetarët në prag të zgjedhjeve parlamentare, ose do të përdoret për të goditur në mënyrë selektive klientët të caktuar.

CEZ-Shpërndarje, ndërkohë, ka kërkuar nga Enti

Rregullator i Energjisë që të rikthejë faturimin aforë. Ky mendohet si një mjet ndaj abonentëve pa matës deri në momentin e instalimit. Vlerat duket se do të konsistojnë në një shifër mes konsumit më të lartë dhe atij më të ulët, sipas qarqeve. Të gjitha anomaliat me matësit, sipas CEZ-it, do të trajtohen në katër grupe kontratash. E para, kontrata pa matje; e dyta, kontrata me matës me probleme; e treta, kontrata me cenim të sistemit matës dhe e katërta, pa seri matësi në sistemin e faturimit.

Sigurimet

Rriten fitimet, por paguhen më pak dëme

■ ■ ■ TIRANE

Kompanitë e sigurimeve e rritën kështu rreth 3.9% xhiron për muajin prill, por paguajnë 21 për qind më pak dëme. Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë një ecuri më të mirë në tregun e sigurimit të jetës, që është rritur me 12.55%, ndërsa primet në kategoritë e sigurimit të jo-jetës janë rritur me 2.4%. Në tregun e jetës, pjesën kryesore vazhdon ta zëri produkti i sigurimit të jetës së



deborit, që njohu një rritje prej afro 38% për katër muajt e parë të këtij viti.

Në sigurimet e detyrueshme motorrike, sigurimi i brendshëm u rrit me rreth 3%, ndërsa kartoni jeshil me afërsisht 13%. Ndër sigurimet vullnetare, sigurimi i shëndetit është ndër produktet me ecurinë më pozitive edhe për vitin 2013. Për katër muajin, të ardhurat nga ky produkt u rritën me 36%.

Ndërkaq për këtë vit shoqëritë e sigurimeve po paguajnë ndjeshëm

më pak dëme krahasuar me vitin e kaluar, pagesa që, sipas të dhënave të AMP, kanë rënë me 21% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, numri i dëmeve të raportuara është rritur. Raporti mes dëmeve dhe primeve ka rënë sërisht këtë vit në rreth 30%, nga 40% që ishte për të njëjtën periudhë të vitit 2012. Gjatë periudhës janar-prill të vitit 2013, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 844 milionë lekë.


► **KURSI I KËMBIMIT VALUTOR** Burimi: Banka e Shqipërisë Data 25.5.2013

\$	Dollari LEKË	108.92	NDRYSHIMI DITOR	-0.58
€	Euro LEKË	141.06	NDRYSHIMI DITOR	-0.02
£	Paund LEKË	164.40	NDRYSHIMI DITOR	-0.64
SFr	Franga LEKË	112.78	NDRYSHIMI DITOR	-0.63

► **Çmimet të ushqimeve në kryeqytet** Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe USAID

PERIME	Domate	110	Barbunja	190	FRUTA	Mollë	84
	Kastravec	70	Patëllxhan	140		Portokall	108
	Spec	160	Kungull	75		Pjepër	170
	Lakër	68	Fasule	257		Limon	177
	Lulelakër	210	Qepë	90		Ullinj	172
	Karrota	158	Patate	88			

Çmimet në lekë/kg Data 25.5.2013



Pas 26 vjetësh,
AlbChrome nis hapjen e
traverbankut Klos-Bulqizë



Kompania AlbChrome e blerë nga Grupi Balfin, ka nisur punimet për hapjen e traverbankut Klos-Bulqizë pas 26 vjetësh. Ky investim do të realizojë transportin e mineralit të kromit nga miniera në impiantin e përpunimit, nëpërmjet një rrjeti nëntokësor hekurudhor, duke ulur ndjeshëm kohën dhe

shpenzimet e transportit. Gjithashtu hapja e traverbankut shmag mundësinë e përmbytyjeve nga uji të galerive të minierës nga niveli i pestë e sipër. Të pranishëm në ceremoni, përveç drejtuesve të lartë të AlbChrome dhe të Grupit Balfin, ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë

dhe Energjitikës, përfaqësues të pushtetit vendor në Klos, Bulqizë dhe Burrel, drejtues të shoqatës së minierave, partnerë të AlbChrome në realizimin e këtij projekti, etj. Hapja e traverbankëve është një investim prej rreth 2.4 milion dollarësh dhe do të zhvillohet në dy faza.

Organizata e kafshëve ARA, thirrje pushtetit lokal

‘Zgjidhni problemin e kafshëve të rrugës’

Veterinerja: Janë bartës të disa sëmundjeve

Lajmi

Kafshët e rrugës janë një problem shqetësues për komunitetin, pasi ata mund të jenë burim sëmundjesh. Ndërsa masat nga pushteti lokal që është përgjegjëse për kujdesin e tyre janë shumë të pakta. Sipas përfaqësuesve të organizatave për mbrojtjen e kafshëve, bashkitë duhet të zbatojnë ligjin për kafshët e braktisura.

■■■ TIRANE

JONIDA LATE

Në rrugët e Tiranës, por jo vetëm të zë syri gjithandej kafshët të braktisura, të cilat janë një problem shqetësues për komunitetin. Kafshët e rrugës ose të braktisura mund të jenë një burim infeksioni për banorët. Silva Bajrami, veterinerë, shprehet se sëmundjet më të shpeshta që përhapen nga kafshët të njerëzit janë tërbimi. “Kafshët e braktisura ose të pastreha siç quhen ndryshe realisht janë mbartësit e disa lloje sëmundjesh. Por më problematike janë sëmundjet e lëkurës. Problem tjetër është dhe sëmundjet që transmetohen nga kafshët të njeriut me anë të mushkonjave, tipike është leshmanjoza. Ndërsa me anë të kafshimit, është sëmundja e tërbimit, këto janë më të përhapura. Për këtë ka vaksina që duhen menduar dhe për kafshët e rrugës” shprehet veterineria. Veterineria shprehet se edhe personat që kanë kafshë duhet të kujdesen për to duke i vaksinuar “Njihen disa sëmundje të transmetueshme nga kafsha tek njeriu. Në raport me njeriun janë shumë të rëndësishme dy vaksinat ajo e tërbimit dhe leshmanjozës dhe tableta për endoparazitët, janë disa lloje sëmundje parazitare që transmetohen nga kafsha tek njeriu kur merren me anë të nuhatjes, kur i lëpinj e i përkëdhelin ato etj” thote Silvana Bajrami. Ndërsa Julia Guga përfaqësuese e organizatës për mbrojtjen e kafshëve Animal Rights in Albania shprehet se pushteti lokal duhet të japin zgjidhje problemit të kafshëve të braktisura. “Nga institucionet shtetërore duhet të zgjidhet problemi i kafshëve të rrugës. Bashkitë,



Adoptimi

Sipas përfaqësueses së ARA-së, që nga momenti i krijimit të saj edhe deri tani janë adoptuar rreth 800 kafshë të braktisura. Si pas ARA-s, kjo është një gjë pozitive, pasi kjo organizatë nuk ka mbështetje financiare të një niveli institucional.

si institucioni përgjegjës për t’i dhënë zgjidhje kësaj problematike, duhet që në zbatim të ligjeve shqiptare e në respekt të konventave ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë, të heqë dorë nga metodat barbare të vrasjes në mesnatë të qenve të rrugës me çifte apo me helm” shprehet Guga. Ajo më tej thotë

se organizata për mbrojtjen e kafshëve ARA është e gatshëm të ofrojë bashkëpunim me ta. “ARA shpreh gjithë vullnetin për të venë në dispozicion të organeve shtetërore në nivel lokal, për të ofruar ekspertizën e saj të suksesshme, si dhe vullnetarët e saj, në funksion të zgjidhjes së problemit të

kafshëve të rrugës në Tiranë e më gjerë. Grumbullimi i këtyre kafshëve në streha pritëse, ku të kurohen të sëmurët, vaksinohen e sterilizohen të shëndetshmit, që më tej të jenë kafshët potenciale për tu adoptuar, është zgjidhja ligjore, civile, evropiane dhe definitive e problemit” thotë

Guga. Sipas përfaqësueses e ARA-s, që nga momenti i krijimit të saj edhe deri tani janë adoptuar rreth 800 kafshë të braktisura. “Që nga dita që ARA ka filluar veprimtarinë e saj si një organizatë në mbrojtje të drejtave të kafshëve me mision primar sigurimin e së drejtës së një jete dinjtoze për to, janë mbi 800 kafshë të braktisura, që kanë gjetur familje. Kjo është me shumë më një fitore e vogël, duke marrë në konsideratë faktin që ARA nuk ka mbështetje financiare në nivel institucional” përfundon Guga.

LAJME SHKURT

■ Shkolla 9-vjeçare, kujtojnë Naimin Frashërin

Dhjetëra nxënës të shkollave 9 vjeçare, publike e private, si dhe fëmijë e mësues të shkollave të Kosovës, kanë kryer homazhe dhe tek varret e vëllezërve Frashëri në Tiranë, në përkujtim të 167 vjetorit të lindjes së poetit kombëtar Naim Frashëri. Bashkë me nxënësit homazhe kanë zhvilluar dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme. Në fjalën e mba-jtur gjatë kësaj ceremonie, drejtori i një prej shkollave private në kryeqytet, Artur Shkurti, tha se shkollat shqiptare duhet të vijojnë t’i rikthehen traditës për përcimin e vlerave dhe krijën e ndërgjegjes kombëtare.

■ Basha: Do bëj gjithçka për Shkollën e Tiranës

Kryetari i Bashkisë së Tiranës Lulzim Basha, u shpreh dje se do të bëjë gjithçka që standartet në shkollat e mesme të kryeqytetit të vazhdojnë të rriten dhe infrastruktura e shkollave të përmirësohet. Këtë ka deklaruar kryetari i Bashkisë së Tiranës Lulzim Basha në aktivitetin e organizuar nga gjimnazi “Qemal Stafa”, i cili më 28 Prill u vlerësua me çmimin “Harku i Triumfit” kategoria Gold për vitin 2013, nga organizata më e madhe e vlerësimit të cilësisë BID EUROPE. Për rezultate të larta në Maturën Shtetërore të vitit 2012, gjimnazi “Qemal Stafa”-u rendit i pari dhe u vlerësua dhe me çmimin “Prizmi i Artë”.

NJOFTIM

GAZETA

[SHQIPTARJA.com]

KËRKON GAZETAR TË SEKTORIT TË AKTUALITETIT

Kërkesa të nevojshme për aplikuesin:

- Të ketë eksperiencë pune në pozicione në fushën e medias.
- Të ketë aftësi të mira të punës në grup.

Të interesuarit të kontaktojnë në numrin:

0696051600

Adresa: Rruga: “Dervish Hima” tre kullat, kulla e dytë-Tiranë.

Drejtori Muajin tjetër hapet Shkolla e Administratës Publike

■■■ TIRANE

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), e krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, do të nisë funksionimin muajin tjetër, me trajnimin e nëpunësve të nivelit të lartë të administratës publike. Aktualisht ASPA është në fazën përfundimtare të rikonstruksionit në mjediset e ish- Shkollës së Bashkuar dhe muajin tjetër do të nisë të përbushë detyrën e saj për trajnimin e të gjithë nëpunësve të administratës publike pa përjashtim, në nivel qendror dhe në nivel vendor, një funksion që më parë e kryente



Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP). Drejtori i ASPA-së, Roland Bejko, tha për ATSH-në se programet trajnuese do të zhvillohen me kurrikula bashkëkohore, ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj,

në kuadër të partneriteteve që shkolla ka vendosur me institucionet homologe. Sipas tij, në ndryshim nga ITAP, me funksionimin e ASPA, numri i nëpunësve të trajnuar do të rritet me rreth tre herë më shumë. “Numri i nëpunësve të trajnuar nga ITAP ka qenë rreth 4600 në vit, nga ku 4000 nëpunës të administratës kanë ndjekur temat e programit të vazhdueshëm dhe të tjerët kanë marrë pjesë në temat e trajnimit mbi integrimin evropian. Me ASPA brenda këtij viti është përcaktuar që rreth 200 nëpunës të nivelit të lartë do të ndjekin trajnime të detyruara” u shpreh Bejko.

intervista



NË FOTO: Selia e Partisë Demokratike

LIBRI Ish sekretari i PD-së Besnik Gjongecaj hedh në treg librin, ku tregon sesi pesë vitet e fundit qeveria ka shkëlqyer të gjitha parimet e BE-së. Rrëfenjat fiction për autorët e rrënimimit të institucioneve



BESNIK GJONGECAJ:


Fshehja e financave të piramidave ishte një stil i njohur në PD

Isha sekretar dhe nuk më jepnin informacione. Si u shkatërrua PD-ja që nga '97-a e deri sot. Jam dëshmitari i rrënimimit të universiteteve

TIRANE

DHURATA HAMZAI

Në prillin e vitit 1997-s, Besnik Gjongecaj ka dhënë dorëheqjen nga posti i sekretarit të përgjithshëm të PD-së dhe një nga arsytet ka qenë fshehja ndaj tij e informacioneve. Gjithçka që e ka munduar në këto vite, Besnik Gjongecaj e ka shprehur me librin e ri "Në morgun e politikës". Libri ka në fokus politikën shqiptare të 5 viteve të fundit, politikën qeverisëse të këtij vendi dhe problemet më thelbësore që lindin me standardet që duhet të plotësohen në procesin e afimit me BE-në. Autori del në disa konkluzione shumë të rëndësishme si: "ndërsa politika shqiptare, veçanërisht ajo qeverisëse, ka si mision të saj punësimin, ajo nuk merret fare me diskriminimin e rëndë politik që ndodh në procesin e kërkimit punë të një qytetari çfarëdo, ndërsa politika qeverisëse thotë se ka ndërtuar rrugë dhe ka bërë investime të jashtëzakonshme, ajo harron se ka pasur dhe ka popuj që nuk janë bërë kurrë të lumtur kur qeveritë e tyre kanë investuar në rrugë, pra për asfaltin, pa investuar për ndërtimin e demokracisë; ndërsa politika qeverisëse flet për liberalizim të pranimeve në universitete, pra për masivizim të tyre". A e ka aftruar politika qeverisëse vendin me BE-në, shtron pyetjen Besnik Gjongecaj, ndërsa shkruan në faqet e këtij libri se po "shkelen përditë parimet më esenciale mbi të cilat është ndërtuar BE-ja, si parimi i ndarjes së pushtetit mbi bazë të rëndësishme më të vogël, transparenca, kontrolli dhe balancimi i pushtetit, harmonizimi i politikëbërjes me ndërtimin e institucioneve etj". Në intervistën për "Shqiptarja.com" autori i librit "Në morgun e politikës" shtjellon dhe zbulon të gjithë faktoret e krizës aktuale të vendit. Edhe në shkrimet fiction, pjesë e këtij libri, edhe pse personazhet dhe ngjarjet e të cilat janë plotësisht produkt i fantazisë, autori shpreh se "në thelbin e fiction është vendosur ekzaktesisht ky absurd që zbulohet në politikën e këtij vendi, në qeverisjen e tij me mjetet që t'i jep vetë letërsia".



Kopertina e librit të Gjongecaj

versitetet e Tiranës, më ka dhënë mundësinë të jem edhe dëshmitar i drejtpërdrejtë i rrënimimit të tyre. Si çdo rrënim tjetër, edhe ky i universiteteve, mori me vete ç'gjëti; shkuli nga rrënjët gjithçka të mirë që kishte mbetur nga sistemi universitar: dinjitetin, profesionalizimin, moralin, etikën, dhe mbi të gjitha, integritetin e të dyve, profesorit dhe studentit të tij. Boshllëku i krijuar nga kjo

shkulje, ku s'mbeti gjë pa u përfshirë, u plotësua me procese degjeneruese, për të cilat edhe më parashikuesit nuk do t'i kishte shkuar mendja që do të instaloheshin një ditë aq brutalisht. Të jesh dëshmitar, nuk do të thotë se detyra është kryer. Për vite të tëra, me shumë kolegë të tjerë, bëmë ç'është e mundur të gjenim rrënjët e të keqes dhe të provonim t'i shkulinim ato. Ishte një betejë që nuk dha kurrë rezultat, sepse e zhvilluam në territorin e gabuar, në territorin e politikës. Universitetet e këtij vendi ndryshojnë, nëse ndryshohet politika. Ja pse në fokusin e këtij libri është vendosur politika, veçanërisht ajo qeverisëse, djalli që rri brenda saj.

A mund të na thoni sesi mënyra e të shkruarit fiction mund të shkojë paralel me publicistikën e këtij libri?

-Mund të veçoj një bisedë midis themeluesit të universitetit privat dhe analistit të pavarur, të dy personazhe të librit, sigurisht, të dy si produkt i fantazisë sime. Ja pra dialogu midis tyre: "Pse

nuk krijon një parti, e kishte pyetur analisti i pavarur disa ditë më parë, si padashur, themeluesin e universitetit privat. Ke krijuar një universitet të shkëlqyer, të suksesshëm jashtë çdo parashikimi. Krijo edhe një parti dhe do t'i kesh të tria në dorë: universitetin, median, politikën. A nuk është ide e mirë? Çdo të thash, ma shtjello pak më shumë, tha themeluesi i universitetit privat dhe dukshëm u duk i mikluar nga ideja e analistit të pavarur. Shumë thjeshtë, filloi analisti i pavarur të bënte atë që dinte më mirë, analizën. Sipas të gjithë llogarive të mija, rreth gjysma e njerëzve që kanë mandat votimi nuk votojnë. Është ajo pjesë e popullsisë që e karakterizojnë si votues gri, gjë që, më duhet ta them që tani, se nuk ka të bëjë fare me trurin, i cili, që kur është njohur si i tillë nga qeniet njerëz,

është karakterizuar si materia gri e botës. Në fakt, ta themi këtu dhe ta lemë midis nesh. Ngjyra e trurit nuk është gri por pink, ngjyrë të cilën nuk e pëlqejnë politikanët e maxhorancës së këtij vendi, madje, thonë që ajo që e urren më shumë këtë ngjyrë është kryetarja e parlamentit. Nëse do t'i thojë që ngjyra e trurit është pink, atëherë, sipas të gjitha gjasave, ajo mund të reagojë e nevrikosur duke thënë që nuk e dua trurin. E gjitha kjo, vetëm e vetëm sepse e urren

Për shkak të pushtimit nga politika, beteja për ndryshimin e universiteteve nuk mund të bëhet brenda tyre, por jashtë, në territorin e politikës

Libri, detaje nga '97-a

Si diskutonin nëpër mbledhje Shehu me Berishën

Në librin "Në morgun e politikës" profesor Besnik Gjongecaj sjell detaje pas kuintave të PD-së që nga '97-a deri në krizën aktuale. Gjongecaj rrëfen se ç'ndodhi pas rrëzimit të qeverisë Meksi në mbledhjen e Këshillit Kombëtar në prill të 1997-s, dhe pse ai vet dha dorëheqjen si sekretar i PD-së. "Ishte djegur Shqipëria, prandaj, dikush nga kryesia e PD-së, në mos e gjitha, duhet të jepte dorëheqjen", thotë Gjongecaj, dhe tregon se ai që duhet të jepet dorëheqjen duhet të ishte zoti Tritan Shehu. Kuriozitetet tjerë janë ndodhitë në mbled-

hjen në basement-in e Pallatit të Kongresve, ku një grup të rinjsh të armatosur me kallashnikovë qëndronin në një prej cepave të përpamë të sallës. Çfarë tha kryeministri Berisha për "raportet e ekzistojnë midis zjarrvënësist dhe zjarrfikësist". Sigënjente Shehu kur "gjysma e trupit jugor të PD ishte djegur, ngrirë, nuk funksiononte më"... "Pas përfundimit të diskutimit, Shehu filloi të bënte atë që bënte gjithmonë: të kruej dhe të rëndiste emrat e diskutantëve në mënyrë që në diskutim i kualifikuar paraprakisht "negativ" të



Tritan Shehu

neutralizohej nga një diskutim që mendohej të ishte "pozitiv", e kështu me radhë. Më në fund, ngaqë nuk kishte se ç'të bënte më, ma dha fjalën mua, që atë ditë kualifikohesha me një diskutim negativ". Duke përshkruar situatat përçarëse që krijoheshin në grupin e PD-së, Gjongecaj thekson se: "Tani është harruar ajo kohë, por problemet janë ekzaktesisht të njëjta për PD, probleme të cilat i kisha paraqitur 15 vjet më parë! PD dhe z. Berisha, fatkeqësisht, nuk kanë vitur asgjë nga tragjedia e cilat më 97..."

Zoti Gjongecaj, ju jeni profesor universiteti. Pse merreni me shkrimin e një libri politik, aq më tepër, me shkrimin e një libri ku analizat politike bashkëjetojnë me letërsinë?

-Kjo ka lidhje me botëkuptimit tim lidhur me mjetet që duhen përdorur për të ndryshuar Shqipërinë pas 20 viteve tranzicion. Të qenit profesor për një kohë të gjatë në një nga uni-



NË FOTO:
Trazirat e vitit 1997 pas rënies së firmave piramidale

MANIFESTIMI madhështor “Aulona Interfolk Festival” është mbajtur për të pestën herë në Vlorë nga datat 11-13 maj. Morën pjesë grupet folklorike nga Kosova, Bullgaria, Polonia, Kroacia, Maqedonia, Italia, Greqia etj.

EDICIONI V

Sfidat e festivalit ndërkombëtar të Vlorës

Ju tregoj manifestimin madhështor të “Aulona Interfolk”

■ ■ ■ **TIRANE**

AGRON FICO



Foto nga manifestimet e “Aulona Interfolk Festival” në Vlorë

ngjyrën pink. Njësoj si i ndjeri “ai i qenve”. Ngaqë urrente gruan sepse dyshonte se kishte shkuar me një qen, filloi të urrejë gjithë racën e qenve. Mos dil nga tema, i bëri vërejtje themeluesi i universitetit privat. Në rregull, po vazhdoj, tha analisti i pavarur..... Krijo një parti ku të gjithë janë njësoj të zhytur në mjerimin e tyre, në vetmi, në boshllëk. Një parti ku nuk ka kundërshtarë, vetëm njerëz me cirkoevolucione të sheshuara, ose që bëjnë ç’është e mundur t’i sheshojnë ato përditë. Apliko, pra, të njëjtën doktrinë që ke aplikuar në sistemin universitar; atë që sistemi universitar do të duhet të vijë te standardi i universitetit tënd dhe jo universiteti yt te standardi i universiteteve morracake publike. Mos krijo një parti si politika e këtij vendi, por ulë politikën e këtij vendi te niveli i partisë tënde. Jepi frymë-marrje edhe më të gjërë se universitetet ëndrës tënde, mllëfit tënd!”

A mund të na veçoni si një ngjarje interesante në pjesën publicistike të këtij libri?

—Ka shumë tilla dhe nuk di kë të zgjedh. Megjithatë, po veçoj vetëm njërin, të cilën e kam përjetuar në prillin e vitit 1997-s, kur dhashë dorëheqjen nga posti i sekretarit të përgjithshëm të PD-së. Në atë kohë, Shqipëria kishte probleme shumë të mëdha, por më e keqja ishte se ato fshiheshin me kujdes nga ata njerëz që kishin lidhje të drejtpërdrejta me to. Është fjala për financat e vendit që u përfshinë në skemat piramidale dhe për njerëzit që ose kishin njohuri për to, ose ishin direkt përgjegjës në pikëpamjen e qeverisjes së sistemit financiar të vendit. Mbjaj mend që mbahesha krejtësisht në errësirë dhe ishte e pamundur të merrja një informacion serioz se ç’po ndodhte me to, megjithëse isha sekretar i përgjithshëm. Quartësisht, problem i skemave financiare ishte një problem thellësisht konfidencial, prandaj edhe zgjidhja e tij do të duhej të ishte e tillë, të realizohej larg syve të të tjerëve. Ishte një stil i njohur në PD. Problemi që lindte klasifikohet, nuk ishte për të gjithë, por vetëm për disa. Autoritetet e partisë përjashtoheshin në mënyrë selektive dhe asnjëherë nuk jepej shansi që të gjithë së bashku të diskutonim dhe të zgjidhnim një problem të dhënë dhe njëherësh sëbashku. Lojtari më “virtuozi” i kësaj loje ishte kryetari gjasme i PD-së së asaj kohe, z. Shehu. Kur binte fjala për skemat piramidale, nuk e di pse, ai kruhej vazhdimisht. Nuk e mbaj mend se si e fillonte kuarjen, por di që kruhej kudo dhe papushim....

Kultura folklorike shqiptare, ky thesar i lashtë, i pasur dhe i larmishëm ka qenë dhe është një vlerë e qëndrueshme e etnosit iliro-arbëresh-shqiptar. Manifestimi madhështor “Aulona Interfolk Festival”, që u mbajt për të pestën herë në Vlorë nga 11-13 maj ishte një arritje e shënuar dhe dëshmi e magjisë së artit popullor. Kjo arritje nuk është thjesht metaforë shkrimi, por një realitet i prekshëm faktik. Përvoja e grumbulluar dhe vlerësimit e mendimet e pjesëmarrësve shqiptarë dhe të huaj janë frymëzuese.

Tri janë shtyllat e programit të këtij aktiviteti: E para, vizioni shkencor-profesional; e dyta, balancimi i dy gjymtyrëve të këtij aktiviteti (d.m.th. i trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor; e treta, organizimi dinamik. Dihet se në gjenezën e vet, folklori ka lindur si mesazh artistik kulturor në gjirin e familjes dhe gradualisht ka dalë edhe në një rreth me të gjerë në bashkësi si p.sh. në dasma, morte, ngjarje të bashkësisë. Kalimi nga një mjedis i vogël dhe intim në tribunat e festivaleve vendore, kombëtare ose ndërkombëtare, ka pasur dhe ka ndikimin e vet. Shqetësimi i specialistëve dhe studiuesve është ruajtja sa më shumë e origjinalitetit të kësaj krijimtari. Kjo merr një rëndësi të veçantë se në një farë shkalle ndikon edhe në pjesëmarrjen e spektatorëve (shikuesve, por edhe teleshikuesve). Thënë thjesht, kërkohet të ruhet

bukuria dhe vlerat autentike të formave folklorike. Prandaj edhe grupi i specialistëve, stafi i këtij festivali, kryesuar nga studiuesi i njohur i vlerave të trashëgimisë kulturore shpirtërore, akademik Vasil, i kushtojnë vëmendje serioze përzgjedhjes me frymë selektive të pjesëve që do të përfshihen në program por në radhë të parë përzgjedhjes së grupeve pjesëmarrëse nga shtete të ndryshme. Pra, synohet të shmanget qnatyralizimi i këngëve, valleve, kostumeve si dhe amalgamizimi/përzierja e tyre. Kjo u duk qartë edhe në këtë manifestim, në të cilin u shfaqën pjesët më të mira, si vallet çame dhe ato të jugut nga ansambli “Çamëria” dhe “Bilbili” të Vlorës si dhe vallet e luajtur nga grupi i Librazhdit. Kjo për pjesën e paraqitjes së folkut vendas. Kjo kërkesë themelore

përfshiu gjithashtu edhe grupet nga vendet ballkanike dhe europiane që morën pjesë si: Grupet nga shqiptarët e Kosovës, nga Bullgaria, Polonia, Kroacia, Maqedonia, Italia, Greqia etj. Vlora me natyrë piktoreske ku gërshetohen kaltërsia e detit Adriatik me gjelbërimin e kodrave dhe luginave me ngjyrën e verdhë të portokalleve dhe limonave, me relievin plot larmi (det, male, kodra, lugina, etj.) është tepër tërheqës për vizitorët e huaj. Kjo është vetëm një anë e turizmit kulturor, ana tjetër është ushqimi i larmishëm vlonjat me pasurinë e ushqimeve të detit, ato me mishëra dhe zarzavate dhe fruta bio e në përgjithësi një kulinari e pasur në të gjithë bregdetin dhe vende tepër atraktive si logaraja. Mbi të gjitha Vlora është vatra e shpalljes së Pavarësisë, akti më

solemn kombëtar; si dhe ka mjaft vende të veçanta historike si Kalaja e Kaniinës, Ishulli i Zvernecit, muzeum etj. E treta, është organizimi shembullor që punohet sipas kriterit 24/7/360 ose shkurt “që në gusht nga një grusht”... Sejmën Gjokoli i cili është organizatori i këtij aktiviteti mbetet shumë i përkushtuar ndërkohë që ka grumbulluar njerëz të aftë sipas parimit amerikan që të jesh i suksesshëm “should collect good people”, (duhet të mbledhësh rreth vetes njerëz të mirë e të zotë). “Aulona Inter Folk Festival” vetëm brenda 5 viteve ka krijuar një standard të ri, cilësor, bashkëkohor të gërshetimit të trashëgimisë kulturore me turizmin kulturor. Vetëm për shkak të pjesëmarrjes në këtë festival qytetin e Vlorës dhe rrethinat kanë pasur rastin ta vizitojnë mbi 1 500 pjesëmarrës nga rreth 50 grupe nga vende të ndryshme të Europës duke filluar që nga Sllovakia e largët. Sfidat e zhvillimit të mëtejshëm i këtij aktiviteti si një dukuri komplekse e trashëgimisë kulturore dhe atij të turizmit kulturor kërkon edhe përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës, në mënyrë të veçantë në komunikimin rrugor, ajror dhe detar. Ajo që e bën tërheqës këtë aktivitet me përmasa europiane është në radhë të parë vetë larmia dhe bukuria e pjesëve folklorike që transmetohen si dhe kostumet autentike shumë ngjyrëshe e plot kolorite. “Aulona Folk...” është një dukuri e re origjinale e kulturës folklorike, në sistemin e shoqërisë demokratike, por edhe përcjell njëherazi mesazhe të sinqerta mëqësore e paqësore midis grupeve të popujve të ndryshëm pjesëmarrës në të, ai është një dëshmi artistike kulturore e unitetit përmes ndryshueshmërisë, prandaj ka edhe një të ardhme të përhershme.

“Aulona Inter Folk Festival” — na thotë zoti Gjokoli - e ka gjetur shtratin e vet dhe dimensionin kulturor por; po aq edhe turistik duke e bërë atë krejt të veçantë mes homologëve të tjerë

KËRKOJ APARATE FOTOGRAFIK METALIK TË VJETËR
Tiranë, kërkohet të blej Aparate Fotografik Metalik të vjetër. Koleksionoj aparate fotografike të vjetër të të gjitha markave. **TEL+35569668080**

Blije atë që të duhet!

Shite atë që nuk të duhet!

Tregu më i madh në Shqipëri për shit-blerje

Për më shumë informacion na vizitoni në faqen tonë të website:

www.MerrJep.al

IPHONE 5 FACTORY UNLOCK
Iphone 5 factory unlock i ardhur nga Italia shumë pak i përdorur as një muaj 16 gb i bardhë.
TEL. 0692401666

PEUGEOT 206 BENZINË 1.1CC.
Shes Peugeot 206 motorr 1.1cc benzinë me dokumenta të rregullta targa Italiane. Makina ka 120.000 km, origjinale me 4 dyer, tapiceri super e pastër me goma të reja të sapo vëna me faturë HANKOOK, disqe alumini, kasetofon mp3.
TEL. 0686803203



Reality show

NJË MOMENT tjetër i spektaklit ishte shfaqja e sekreteve që banorët i kishin gjetur njëri-tjetrit. Anaidi, i cili ka zbuluar sekretin e Elonës, e cila ishte vajza që ushtronte sportin Tuakendos

Ja finalistët e BB6 ikën Eldora dhe Rikja

Në finale, Anaidi, Iliri, Elona dhe Shpendi

TIRANE

Spektakli të shtunën nisi si përherë me prezantimin e Arbana Osmanit, e cila lançoi për publikum se gjatë mbrëmjes do të kishte eliminim të dyfishtë dhe në finale e madhe të 1 qershorit do të shkonin vetëm katër prej gjashtë banorëve të cilët mbërritën deri në gjysmëfinale. Arbana gjithashtu bëri të ditur për banorët se gjatë mbrëmjes do të zbuloheshin se kush i kishte gjetur sekretet, por edhe sa lekë kanë fituar ata nga kjo lojë. Ndërsa prova e javës për banorët ka qenë "në vend të tjetrit" ku atyre u është dashur të shtiren si njëri-

tjetri brenda shtëpisë. Kështu Iliri dhe Anaidi, duhet të ishin në vend të Rikes dhe Elonës, Shpendi si Eldora, Elona si Iliri dhe Rikja si Anaidi. Kjo provë ka qenë plot batuta dhe situata gazmore mes banorëve. Një moment tjetër i spektaklit ishte shfaqja e sekreteve që banorët i kishin gjetur njëri-tjetrit. Anaidi, i cili ka zbuluar sekretin e Elonës, e cila ishte vajza që ushtronte sportin Tuakendos. Sekretin i dytë që djali nga Tirana ka zbuluar ka qenë misioni i Arsimit për të çuar në nominim të përherëshëm Anaidin. Ai po ashtu ka gjetur edhe sekretin e Elenës, e cila ka pirë cigare që në moshë të vogël për arsye shëndetësore. Më pas


u shfaqën për banorët sekretet që ka zbuluar Iliri gjatë lojës. Ka qenë pikërisht Iliri që ka gjetur sekretin e Shpendit, i cili prej 13 muajsh nuk fliste me babanë. Më pas ai ka zbuluar edhe sekretin e Oltës e cila ishte vegetariane. Po kështu Elena, ka qenë ajo që ka zbuluar sekretin e Eldorës, vajza e cila është me talasemi. Shumë nga banorët të cilët kanë gjetur sekretet dhe kanë fituar lekët, i kanë humbur ato gjatë gabimeve që kanë bërë gjatë dyshimeve për sekretet e tjera.

SURPRIZA E RIKES

Rikja që nga koha e hyrjes në shtëpinë e Big Brother ka pasur dyshime për të dashurin që ka lënë jashtë, pasi ai nuk

do të vija bukuroshe të hynte në këtë show. Për Riken ishte programuar një surprizë. Në dhomën e surprizave ajo pati një mundësi nga Vëllai i Madh për të folur në telefon me të dashurin në Itali, por ai nuk iu përgjigj telefonatave. Më pas ishte Iliri ai që mori një letër dhe ia çoi Rikes. Përpara se ajo të lexonte letrën në ekran u shfaq një letër nga i dashuri, i cili i tregonte se e donte dhe e mbështeste në lojën e saj dhe se priste jashtë..

Pas sqarimit të letrës që Elona shkroi për Riken, duke i komunikuar diçka shumë personale, u komunikua edhe emri i të eliminuarit të parë. Ishte pikërisht Rikja ajo që



la shtëpinë e Big Brother me anë të votimit të publikut. Në studio Rikja foli edhe për raportin me Elonën për të cilin tha se është një miqësi e vërtetë, sepse historia e jetës së tyre është e ngjashme. Ndjenja që ne kemi për njëra-tjetrën është thjesht një miqësi e madhe, tha ajo. Ndërsa gjatë televotimit publiku zgjodhi katër emrat që dëshironin në finale. Fi-

nalisti i parë që kaloi sfidën e televotimit ishte Shpendi, djali nga Kosova, finalisti i dytë që kaloi në javën e fundit të Big Brother ishte Elona, finalisti i tretë që kaloi ishte Anaidi dhe i fundit që shkoi në finale ishte Iliri. Banori që u largua ishte Eldora, duke humbur kështu emocionet e natës së madhe finale dhe mundësinë për të fituar çmimin e madh.

TUBORG RIFRESKON PAMJEN E BIRRËS MË TË MIRË TË PRODHUAR NGA 100 % MALT

Sot, më 25 Maj, Tuborg njoftoi në Shqipëri prezantimin e identitetit të ri vizual, duke u shfaqur me një pamje dhe etiketë tërësisht të re që i shkon përshtat misionit të Tuborg për të qenë zgjedhja e parë e të rinjve. Tuborg këshillon përdorimin e birrave që janë prodhuar nga 100% malt dhe asnjë shtesë tjetër si misër apo oriz.

Tuborg ka ndryshuar pamjen duke ju përmblajtur filozofisë së kompanisë për të qenë përherë në të njëjtin hap me njerëzit e rinj. Tuborg është birra që ofron më shumë dhe të gjithë e dinë që kur hapin një shishe Tuborg do të gjejnë më shumë se një birrë cilësore.

Identiteti i ridimensionuar, paraqet një rrotullim të etiketës karshi versionit të mëparshëm.

Prezantimi i ri pamor i shishes së Tuborg është bërë duke punuar mbi etiketën e mëparshme, duke i shtuar dozën e kreativitetit. Etiketa e re e shishes tashmë do të jetë e rrotulluar me 62.5°. Në momentin kur pika e parë e birrës do të zbrazet në gotë, etiketa do të duket horizontalisht duke i lejuar miqve dhe të tjerëve përreth të kuptojnë menjëherë se cila është pija e zgjedhur nga ju.

Si pjesë e rinovimeve është prekur edhe sloganin i Tuborg duke u transformuar në "Open for More", "Hape për më shumë". Tuborg e kupton rëndësinë e çdo momenti dhe për këtë arsye dëshiron që të amplifikojë argëtimin në çdo moment, pasi nuk kthehet më mbrapsht. Ky slogan tregon shumë qartë atë që kërkohet të realizojë Tuborg të frymëzojë audiencën për të qenë të hapur, për të kërkuar më shumë, të jete pjesë e eksperiencave të tyre dhe t'i arëtojë.

"Ne jemi shumë të emocionuar për prezantimin e imazhit të ri të Tuborg. Shumica e tregjeve globale janë tashmë të njohur me Tuborg dhe ne kemi filluar të prezantojmë rifiksimin e markës në Shqipëri në muajin Maj." thotë Drejtori i Përgjithshëm i Tuborg në Shqipëri Z. Isaac Sidi.

Ata që konsumojnë Tuborg e dinë që shija e veçantë e birrës vjen nga lëndët e para cilësore, të cilat përzgjedh kompania për prodhimin dhe garantimin e birrës më të mirë. Tuborg është një birrë që prodhohet 100% nga malti, edhe ky i cilësisë së lartë, pa asnjë shtesë tjetër si misër apo oriz. Duke iu përmblajtur me rigorozitet formulës origjinale të bërjes

së birrës, Tuborg prej vitit 1880, njëkohësisht garantohet edhe shëndeti i konsumatorve të birrës. Birra e prodhuar vetëm nga 100% malt ndihmon në një shëndet më të mirë si rezultat i përqëndrimit të më shumë vitaminave dhe mineraleve. Gjithashtu, përqëndrimi i lartë i antioksidanteve në një birrë 100% malt, ndihmon në uljen e rrezikut të sëmundjeve kardiovaskulare. Pra, përveç shijes së veçantë dhe aromës perfekte, prodhimi i birrës nga malti është edhe i shëndetshëm për konsumatorët. Për këtë arsye këshillohet përdorimi i birrave, që janë prodhuar vetëm nga 100% malt dhe asnjë shtesë tjetër. Këtë standard të cilësisë Tuborg e garanton edhe për Shqipërinë, si në të gjitha vendet e tjera. Tuborg nuk kujdeset vetëm për argëtimin, por është shumë kërkuese në prodhimin e birrës vetëm nga 100% malti.

TUBORG

100% MALT

OPEN FOR MORE

Reth Tuborg

Tuborg është pjesë e Carlsberg Group, një nga liderët botërorë në prodhimin e birrës, me portofol të madh të birrave si edhe të markave të tjera të pijeve.

Më shumë se 41.000 persona, punojnë në Carlsberg Group. Në vitin 2012, Carlsberg Group ka shitur më shumë se 115 milionë hektolitra me birrë, afërsisht 34 miliard shishe birre.

Në vitin 1880, Tuborg, u themelua si Birri Eksportuese, në një qytetëzë në veri të kryqëzimit Danez, Kopenhagen.

Tuborg është një birrë me të vërtetë kozmopolitane dhe e pranishme në më shumë se 70 vende të ndryshme.

Tuborg mbështet eventet muzikore më të mira në Europë si Roskilde, Glastonbury, Exit, Wireless, Reading dhe shumë të tjerë. Tuborg është prezente në shumë video muzikore nga artistë të nivelit ndërkombëtar si Black Eyed Peas, B.o.B, Eminem, Kings of Leon, Simple Plan, Louis XIV, The Academy Is dhe One Republic, Taio Cruz.

Për më shumë informacion: www.tuborg.com



RILINDASI

Viti III - Nr:21

E diel, 26 maj 2013

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni
edhe
online

WWW.SHQIPTARJA.COM


REBELI DOM NDRE MJEDA

Përballjet me De Martinon, At Junggun e Gustav Mayerin

MENTOR QUKU

1. Sa herë u përplas me disiplinën e me rregullat e kohës, Ndre Mjeda gjeti mënyrën dhe u rebelua. Ishte fillimi i vitit 1897, kur shkrimtari Leonard De Martino botoi në Bari veprën e tij "La questione Albanese-orientale e la nuova crociata, con appendice". Në shtesën e veprës, autori përfshiu edhe poezinë e Ndre Mjedës "Vaji i bylbylit", përkthyer në italisht.

Ky është përkthimi i parë që i bëhet poezive të Mjedës në italisht. Për herë të parë këtë e kishte bërë Pal Moretti me poezinë e Mjedës "Varri i Skanderbegut" në vitin 1891. Mbas gjashtë vitesh vjen përkthimi në italisht i një poezie tjetër të Mjedës. Por ndërsa Moretti e kishte bërë këtë në konfidencë me Mjedën, De



NË FOTO:
Ndre Mjeda
dhe
faksimile të
leterkëmbimit
të tij me
Gustav Majen

Gjinestra: Rihapet faltorja e shejntë e Zojës së Stambollit

LORENZO ZOLFO

Pas disa vitesh restaurimi u rihap Faltorja e Zojës së Konstandinopojës, mbrojtësja e Gjinestrës, e cila ishte mbyl-

lur për probleme statike. Ky vend i adhurimit u ndërtua nga shqiptarë, para se të ndërtonin shtëpitë e tyre. Një gojëdhënë thotë se Virgjëresha Mari u shfaq në ëndërr tek një njeri, të cilit

i tregoi vendin se ku mund të gjente portretin e saj të pikturuar. Ai shkoi në atë vend dhe së bashku me disa të tjerë pas kërkimeve gjetën portretin mbi një lis. Aty u ndërtua...

Martino e kishte bërë dhe publikuar, madje të shoqëruar me një koment që e implikonte figurën e Ndre Mjedës, pa dijeninë e autorit. Kjo ndodhte në një çast kritik, në kohën kur poeti po përgatitej të kthehej në atdhe, atje ku ishte turku. De Martino kishte komentuar: "Kangë simbolike, ose ankim i poetit të dëshiruem për lirinë e atdheut". Kjo implikonte edhe klerin katolik, i cili ruante një statuoqe me administratës lokale të vilajetit të Shkodrës.

Mjeda detyrohet të protestojë, duke thënë se botimi është bërë pa lejen e tij dhe pse vinte në dukje ide dhe aspirata të përbashkëta me De Martinon. Gjithsesi ai implikohet ndaj të dy palëve. Letra e protestës u shkrua nga Mjeda nga Portoreja (Kraljevicja), më 25 prill 1897 dhe ju drejtua arqipeshkvit të Shkodrës, Emzot Pashk Guerinit. Poeti...

Vijon në faqen 14-15

Jakov Xoxa, shkrimtari që krijoi sagën e Myzeqesë

Rrëfim mbi takimin e 1974. Xoxa në Kombinatin e Tekstleve në Berat: "Eh, sikur edhe ne shkrimtarët të kishim një sinjal që të ndizej kur nuk e kemi mirë"...

AGIM VINCA

Jakov Xoxa është pa dyshim një nga shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX; krijues që la pas vetes një veprë e cila i ka të rralla shoqet në letërsinë shqipe. Një nga tregimet e hershme të tij, një rrëfim i bukur, gati në kufi të legjendës, për një bari myzeqar që vret beun për nder, titullohet Kapedani. Shëmbëllyeshëm personazhit të tij trim e krenar, Xoxa do të mund të quhej kapedani i Myzeqesë në fushën e letrave dhe veçanërisht të prozës shqipe. Rrëfimin për Myzeqenë dhe myzeqarët e filloi me

novelat e tij pak të njohura (Novela I, II) dhe e vazhdoi me romanet e mirënjohura: Lumi i vdekur, Juga e bardhë dhe Julja e kripës, ndërkohë që nuk arriti ta përfundonte projektin e madh prej pesë romanesh, ku bënin pjesë edhe veprat e mbetura në zanafillë: Ari i zi dhe Dielli lind nga malet, që do ta kompletonte pentalogjinë e tij romanore në formë të "X" (Iksit). Sëmundja e kobshme, që i solli vdekjen e parakohshme, e gjeti "në vlagën e punës", siç do t'i thoshte, në spitalin e Tiranës, miut dhe bashkëvendësit të tij, shokut të penës, Profesor Nasho Jorgaqit, por edhe me aq sa krijoi arriti ta sfidonte vdekjen dhe harrimin. I lindur...

faqe 16



Ç'do të qe Skënderbeu nëse përballë s'do të qe pushtuesi por emancipuesi?

Për shkollarët shqiptarë, të Kosovës apo të Shqipërisë, ç'kuptim mund të ketë Skënderbeu me krejt historinë dhe krejt literaturën që i shoqëron bëmat e tij, nëse përball nuk ka sulltanët pushtues, por ca përhapës të emancipimit?

AKADEMIK MEHMET KRAJA

faqe 18-19

Zbulohet gjaku i princave shqiptarë në Ballkan e Europë

Paolo Petta, mes paraardhësve të gjallë zbulon edhe Kostandinin e Aranitëve në Monferrato dhe në lojën politike franceze

DHURATA HAMZAI

Libri "Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë" hedh dritë mbi historinë e aristokracisë shqiptare në shekuj. Konkluzioni më interesant që del prej këtij libri është fakti se fiset aristokratike shqiptare të detyruara nga pushtimi osman kanë emigruar në vendet fqinje duke mbartur gjuhën, kulturën traditën dhe stilin specifik të jetesës. Kështu, për rreth 5 shekuj ata nuk e kanë lejuar asimilimin nga kulturat vendase. Kjo e ka ndihmuar autorin e këtij libri Paolo Petta, një ndër studiuesit më interesantë të historisë së Shqipërisë të këtyre dekadave të fundit, që të

gjej gjurmët e dhjetëra trashëgimive të këtyre principatave. Paolo Petta ka nisur kërkimet e në arkiva dhe në terren për të zbuluar pasardhësit që nga "trashëgimia e vështirë e Skënderbeut", ku ka gjetur edhe pasardhësit e tij në mërgim, duke rënduar pastaj në gjurmë të tjera të detyrës princërore shqiptare, ku ka gjetur trashëgimtarë të familjes së Muzakajve në Napoli, që për ta ka qenë një vend strehimi i sigurt në kohë të vështira. Petta ka zbuluar degë të familjes së Gjergj Arianitit, ku rrëfimet dokumentare në këtë libër janë shpesh të mahnitshme, siç është rasti kur ai tregon për pasardhësen Angelina, degë e...

faqe 17

PERSONAZH | ANALIZA

MENTOR QUKU

vijon nga faqja 13

...në të vërtetë rebel, aty bëri një propaktheu: Duke kundërshtuar vetveten, ai kundërshtoi rebelimin e tij, kishte kundërshtuar atë që kishte thënë De Martino, megjithëse pa lejen e autorit: Poeti bëri një deklaratë që asnjëri nuk mund ta besonte, që gjoja ai as e njihje De Martinon! Është një shprehje e tragicitetit që përjetonte shpirti i Mjedës. Për të vërtetuar se nuk kemi të bëjmë me një rast të shkëputur, por me atë që përjetoi në të vërtetë Mjeda gjatë viteve të studimeve jashtë atdheut, mund të sjellim në mend se katër vite më parë, më 15 janar 1893, Mjeda njoftoi Meyerin në konfidencë dhe jo pa një farë krenie, se poemën e tij "Vaji i bylbylit" e kishte përkthyer në italisht nga De Martino, madje ankohe se ky variant nuk është botuar ende. Kjo provon të vërtetën e madhe se Mjeda pati lidhje dhe letërkëmbim me De Martinon. Shuteriqi e quajti "Skandali De Martino", por ne mendojmë se ishte "Drama Ndre Mjeda". Ngjarja e vitit 1897, nuk tregonte ndonjë gjë të veçantë për De Martinon, ndërsa për Ndre Mjedën ishte ndryshe: Ishte plot ëndërra për t'u kthyer në atdheun e robëruar dhe për të marrë përsipër detyrën e misionarit të kombit. Është e vërtetë se emri i poetit u zu në gojë nga rrethe e personalitete të ndryshme, por ndërkohë ai nuk pati pasojë, madje vazhdoi të mbetej profesor i filozofisë në seminarin e jezuitëve në Kraljevicë.

Kjo ngjarje vetëm sa na rikujton Mjedën në dy caste të tjera analoge. Para dhjetë vitesh (më 1887), profesor i muzikës në Cremona, Mjeda pati protestuar tek epori i tij At Dedë Pasi SJ, për shkak të këshillës së Atë Junggut "Mos u mërzit". Kjo frazë u gjet në kartolinën që i kishte dërguar padreja nga Shkodra, për ditëlindje e që në një farë mënyre e implikonte Mjedën para eporëve. Lexuar në nëntekstin e vet, kuptohej se Ndre Mjeda kishte raportet të afërta me Junggun, të cilit i ishte ankuar për jetën që bënte në seminarin Da Vida të Cremonës. E vërteta ishte ajo që kishte shkruar Junggu, sepse është thënë disa herë nga bashkëkohësit se Mjeda ishte kundër disiplinës së repret të seminarit, si edhe kundër prirjes për ta mbajtur atë jashtë atdheut. Zotërojmë dokumente që e provojnë se Jungu, menjëherë pas vdekjes së babait, kishte qenë tutori i dy djemve të mbetur jetimë, të cilët i kishte afruar me jezuitët e Shkodrës. Ishte Junggu ai që i kishte regjistruar në Seminarin Papnor të dy jetimët e nënë Lukes. Junggu qe ai që botoi krijimet e para të Mjedës (Shahiri Elierz). Junggu ishte ai që i dërgoi Mjedës nga Shkodra librin e tij "Fjalori shqip", në gusht 1896, ndërsa ishte Ndre Mjeda ai që përpuoi dhe përgatiti për botim librin e Junggut "Visari i Kongregacionit" (1930). Këto fakte provojnë se Atë Junggu ishte miku, njeriu i afërt i familjes, tutori dhe njeriu konfidencial i vetë Mjedës. Edhe kartolina e urimit që i dërgon poetit për ditëlindjen provon se Atë Junggu ishte i vërtetë kur i shkruan Mjedës së ri që të mos mërzitet, ndërkohë që vetë poeti proteston më kot. Analoge është protesta që bëri Mjeda me rastin e letërsë apokrifë dërguar konsullatave të huaja në Shkodër, në emër të kryengritësve malësorë mirditorë. Në shkurt 1902. Me këtë rast Mjeda kritikohet se ka prishë gjendjen e statusquo në mes të klerit katolik dhe administratës turke në Shqipëri, mirëpo ai përsëri vazhdon me zakonet e vjetër: justifikohet dhe proteston.

Të gjitha protestat e rebelit Mjeda, nuk janë gjë tjetër veçse alibira për të shmangur konfliktet e hapura me eporët. Sa herë që rebeli

DOM NDRE MJEDA

Guximtari, rebeli dhe reformatori përballë De Martinos, At Junggut dhe Gustav Mayerit


Përplasjet me Gustav Mayerin për gjuhën shqipe e nga ana tjetër letrat miqësore veprat dedikuar atij dhe dhuratat, por edhe kontributi i pasqor për pjesën dërrmuese të veprave madhore të albanologut austriak....

Mjeda ka bërë hapa të tillë të guximshëm, kur e ka kuptuar për pasojat, ka gjetur mënyra dhe është tërhequr në mënyrë strategjike.

2.

Përfundimi i studimeve në kursin e Teologjisë në Gorizia, si edhe emërimi i tij si profesor i filozofisë në Kraljevicë, përkon me rifillimin e letërkëmbimit me Gustav Meyerin, si dhe me një angazhim të ri në fushat e studimeve albanologjike të At Andrea Mjedës. Kësaj faze i përkasin trembëdhjetë letra të njohura: gjashtë të hartuara në gjermanisht nga Meyerit prej Graci dhe shtatë të shkruara në italisht nga Mjeda (njëra nga Gorizia dhe gjashtë nga Kraljevicë), gjatë vitit shkollor 1895-1896. Mjeda synonte që përmes letrave të nxiste albanologun austriak Meyerin, që të angazhohej sa më gjatë e sa më intensivisht në studimet e botimet shqiptare. Letrat e tij dërguar Meyerit janë plot lutje, përgjërime, lavdërime, këshilla, sqarime shkencore, dhurime librash, por edhe dhurime të punëve e studimeve të tij. Mjeda i bëri lavde Meyerit jo rastësisht, përmes poezisë "Gjuha shqype", të cilit ia kushtoi poezinë, por i dhuroi atij edhe tekste geqe me fjalë e fraza dialektore, si edhe libra e revista që botoheshin në Shkodër. Por kjo është vetëm njëra anë e tij, sepse në krahu tjetër ai hyn në debate shkencore me të, me takt e kujdes të madh, por në mënyrë të detajuar mbi gjuhën shqipe. Njëkohësisht ai vlerëson kontributin e madh dhe autoritetin absolut të tij në rrethet shkencore europiane. Ndërsa Meyerit kishte interesa shkencore në disa gjuhë, Mjeda bëri përpjekje që ta orientonte atë kryesisht drejt studimeve albanologjike. Shqiptarët duhet t'ia dinë shumë për nder Mjedës, për atë që bëri për ta afruar një gjuhëtar të tillë të shquar pranë studimeve albanologjike. Ai parashikonte se një angazhim më i madh i Meyerit në studimet albanologjike do të luante një rol të dukshëm në mbrojtje të interesave kombëtare të shqiptarëve. Shumë shpejt, përpjekjet e Mjedës dhanë rezultatet e veta. Frutet më të shumta në këtë drejtim do t'i shohim gjatë viteve 1896-1897, kur Meyerit do të botojë "Studime shqiptare" V dhe VI, si edhe do të punojë për të dërguar në shtyp "Studime shqiptare" VII. Vështrë

NË FOTO: Dom Ndre Mjeda



të besojmë se Meyerit do të kishte qenë një që qe, një nga albanologët më të mëdhenj, nëse nuk do të kishte pasur nxitjen dhe bashkëpunimin e Ndre Mjedës. Dhe kjo nuk ndodhi rastësisht: Mjeda ishte një patriot i fllaktë dhe shkencëtar i ri, ndërsa Meyerit ishte një shkencëtar i pjekur dhe shumë i kualifikuar që interesohej për shqipen, në kuadrin e studimeve balkanologjike. Ai shihte tek prifti i ri shqiptar një studiues të talentuar me të ardhme, si edhe një bashkëpunëtor të shkëlqyer në studimet shqiptare. Së fundi, megjithëse në distancë, kishte njohur tek Mjeda një mik të sigurtë e të singurtë. Letërkëmbimi në mes të tyre, sidomos ai i fazës së dytë (1895-1896), flet për një bashkëpunim të frutshëm, i cili pati një grafik në rritje, që u finalizua me botimin e "Studimeve shqiptare" VI (Vjenë, 1897). Kjo shihet edhe në mënyrën se si evolui fjalori dhe toni gjithnjë më miqësor e gjithnjë më

vlerësues i Gustav Meyerit ndaj Ndre Mjedës, brenda dhjetë muajve të fundit (mars-dhjetor 1896): -Krejt i juaj (letra e Gustav Meyerit e 4 marsit 1896).

-I juaji me shumë stimë (letra e Gustav Meyerit e 15 majit 1896).

-I juaji plot stimë (letra e Gustav Meyerit e 30 qershorit 1896).

-I juaji, tejet i përlur (letra e Gustav Meyerit e 28 nëntorit 1896).

-Jam i Shkëlqesisë suaj, tejet i përlur (letra e Gustav Meyerit e 27 dhjetorit 1896).


Me gjithë punët e tij të shumta, Meyer i tregua i gatshëm për t'i dërguar Mjedës informacionin që i mungonte rreth botimeve shqipe, gjatë viteve 1893-1895. Në shkurt 1896 Mjeda pranoi që të bashkëpunojë me Meyerin në fushë të studimeve rreth gjuhës shqipe. Meyer i ankohe Mjedës sepse nuk ka gjë të sigurtë në dialekti shkodran dhe pothuaj asgjë nga dialektet e Malësisë së Veriut. Ai u entuziasmua kur mësoi se Mjeda po punonte në drejtimin ku studimet albanologjike kishin mangësi e pasaktësi. Ai inkurajoi studimet e albanologut të ri shqiptar, si edhe shpreh keqardhjen kur mëson se Mjeda për momentin nuk mund të merrej me shqipen për shkak të angazhimeve të shumta të tjera. Prifti shqiptar do të rifillojë të merrej intensivisht me shqipen vetëm nga fundi i vitit 1896. Hëpërhë, Meyer i nxit Mjedën të vazhdojë për të mbledhur gjithçka

në shkoderianisht në dialektin e malësorëve të veriut, si edhe në atë të Mirditës. Ai i lutet Mjedës që të sqarojë tingujt në toskërisht dhe përgjegjësit e tyre në gegërisht. Duke pasur besim tek Mjeda si njohës i saktë i të folmeve e dialekteve të ndryshme të shqipes, si edhe zotërues i shumë gjuhëve të huaja, Meyer i kërkoi të përcaktojë me ndihmën e tij, kufijtë dialektorë në mes të gegërishtes e toskërishtes. Mjeda ishte i vetmi nga shkoderianët që zotëronte dialektin toskë. Gatishmëria e Ndre Mjedës për ta ndihmuar me tekste e materiale të tjera, me këshilla e sqarime, e shtyn Meyerin që të ndihet i detyruar ndaj tij, aq më tepër se parashikon që do t'i duhen shumë kohë që të lirohet nga punët e lodhshme. Në mes të letrave të kësaj faze dallojmë dëshirën e madhe të Gustav Meyerit, për të njohur personalisht albanologun e ri At Andrea Mjedën. Më 27 dhjetor, duke i uruar Vitin e Ri, ai shpreh shpresën se

giatë vitit 1897 do të njihen personalisht. Kjo lidhet me mundësitë reale që ekzistonin në këtë kohë për të dy albanologët: të dy jetonin fare pranë njeri-tjetrit, njeri në Grac dhe tjetri në Kraljevica. Nga ky letërkëmbim del se po bëheshin përpjekje në Shkodër për krijimin e shoqërisë "Bashkimi", si edhe për planet për dërgimin e At Ndre Mjedës atje si kryetar i saj. Ishte koha kur Meyeri dhe Pedersenin ishin nënjanuar paksa nga fusha e studimeve albanologjike. Ndërsa shumë pak studiues merreshin me gjuhën shqipe, interesimi dhe punimet albanologjike të Mjedës merrnin një rëndësi të veçantë. Në mes të tjerave Mjeda i tregon mjeshtrit austriak planet e tij krijuese për të ardhmen. Miqësia e tyre është forcur: ato i rekomandojnë njeri-tjetrit botime shqipe, i huazojnë ose i këmbëjnë librat shqipe njeri-tjetrit. Të dhëna me interes dalin nga ky letërkëmbim lidhur me pikëpamjet dhe përpjekjet këmbëngulëse të gjuhëtarit tonë lidhur me drejtëshkrimin e shqipes. Ai u lidh me Meyerin dhe pati pikëpamje të njëjta lidhur me drejtëshkrimin e gjuhës shqipe. Që aty mësojmë për betejën që po bënte Mjeda lidhur me drejtëshkrimin e ri, duke u përplasur me praktikën e deriatëherëshme. Që në gusht 1895 Mjeda, i ankohet Meyerit për ortografinë e paravendosur "të zotërinjëve" në Shkodër, të cilët nuk duan të kuptojnë nevojën e përdorimit të drejtëshkrimit të ri, të propozuar nga Mjeda e të përkrahur nga Meyer. Me këtë rast, Mjeda e vlerëson shumë fjalorin e vogël shqip të Jungut, si përfaqësues i saktë i dialektit shkodran, i cili ia kalon fjalorit voluminoz të F. Rossit për nga pasuria e fjalëve e saktësia e paraqitjes së tyre. Por edhe fjalorin e Jungut e kritikon sepse është shtypur me drejtëshkrimin italianizant, që përdoret në Shkodër. Kjo ortografi, mendonte Mjeda, nuk tregonte me saktësi shqiptimin e shkodrnishtes. Nga letërkëmbimi Mjeda-Meyer mësojmë se gjuhëtarin ynë, në saj të natyrës së tij prej rebeli dhe debatuesi, i ka bërë vërejtje Meyerit për gabime që ai i ka bërë në shqiptimin e fjalëve shqipe, duke ia lënë fajin ortografisë shkodrane italianizante. Në prill 1896 Mjeda i ka dërguar Meyerit kësombëllën e tij të "Fjalorit etimologjik", me shënime e shtesa. Kur ky libër, së bashku me plotësimet i bjen në dorë, albanologu austriak entuziazmohet dhe i kthen përgjigje Mjedës me vlerësim me superlativë për punën që kishte bërë.

3.

Ndre Mjeda është gjurmuesi, mbledhësi, përpunuesi dhe përkthyesi i pjesës më të madhe të proverbase e shprehjeve proverbiale të botuara në gjermanisht në "Studime shqiptare", VI, 1896, Vjenë. Meyer, në letrat e tij, e pranon haptas se një pjesë e mirë e teksteve që përfshihen në "Studime shqiptare", VI, janë vepër e studiuesit dhe shkrihtarit të ri Ndre Mjeda. Nga një studim krahasues i këtyre teksteve me ato që përmenden në korrespondencën Mjeda-Meyer vërtetohet plotësisht autorësia e Ndre Mjedës në 206 proverbat dhe shprehjet proverbiale të përfshira në "Studime shqiptare", VI. Kjo ka ndodhur për shkak se Meyerit i kanë munguar tekste të folmes shkodrane dhe të dialekteve të Malësisë të Veriut. Por kjo e ka shkakun edhe në projektet e Mjedës që kur ishte student i filozofisë në Chieri të Italisë (1887), synonte të paisje me fraza dhe fjali shqipe, sepse i mungonin për të hartuar drama e vepra të tjera. Tani Mjeda mendonte që ta spostonte qendrën e botimit të veprave të tij, në Vjenë. Kjo dallohet qartë në letrat që Meyer i dërgoi Mjedës, ku mësojmë edhe se Mjeda i botoi veprat e tij nën emra të personaliteteve të shquara të kohës. Kështu ka ndodhur edhe me Nachtigalin, edhe me Emzot Lazër Mjedën. Edhe herë të tjera gjatë jetës së



NË FOTO:
Në periudhat 1892-93 dhe 1895-96, Ndre Mjeda pati letërkëmbim me albanologun austriak, Gustav Meyer. Kopje e letrës autografe që Ndre Mjeda i dërgoi Gustav Meyerit më 15.11.1896

NË FOTO:
Kopje e letrës autografe që Gustav Meyer i dërgoi Ndre Mjedës më 4.3.1896.

tij, ai përfshiu në veprat e tij fjalë të urta dhe shprehje proverbiale. Në tekste të tij shkollore ai botoi edhe fjalë të urta edhe gjë e gjëza. Në Abetaren e tij, Mjeda përfshiu blloqe të tëra me fjalë të urta. Ka një korrespondencë në mes të Mjedës dhe Meyerit që provon se albanologu austriak nuk i ka kuptuar gjithnjë drejtë proverbat e shprehjet proverbiale, për shkak të metaforave që përdor populli. Meyer shpesh nuk ka depërtuar në domethënien e tyre shqip, ai jo gjithnjë ka barë krahasime dhe sqarime të goditura. Ai nuk e njohte të folmen e figurshme të gjuhës shqipe. Ka në mes të proverbase dhe shprehjeve proverbiale fjalë të turpshme, të cilat gjuhëtarit dhe folkloristit Mjeda i ka vjelur dhe ia ka servirur Meyerit ashtu siç i ka gjetur dhe siç i ka përdorur populli. Është e ditur tashmë se në të folmen e popullit kjo trashëgimi gojore e popullit, kalonte e gjitha në kuptimin figurativ, duke humbur kuptimin e shpeshtë bisedor dhe karakterin vulgar e sharës. Në këtë drejtim Ndre Mjeda kapërcente kohën e vet por edhe shekullin që do të vinte më pas. Bashkëpunimi Mjeda-Meyer do të vazhdonte edhe me "Studime shqiptare", VII, por Meyer u sëmur rëndë dhe vdiq në vitin 1900. Sikur nuk mjaftoi kjo fatkeqësi, një vit më vonë, edhe Ndre Mjeda u nda nga shoqëria e Jezuitëve duke u kthyer në atdhe.

4.

Nga letërkëmbimi mësojmë se edhe këngët lirike, ato të trimërisë dhe legendat mirditore, të cilat janë të përfshira në "Studime shqiptare", VI, janë mbledhur dhe i janë shërbyer Meyerit nga Ndre Mjeda, i cili ka kërkuar që të mos përmenden emrat e luftëtarëve shqiptarë të lirisë. Një tjetër alibi e Mjedës, i cili i ka shërbyer Meyerit edhe këngë lirike e erotike, që pëshpërteshin në rrethet e të rinjëve të kohës. Leksiku është vulgar në rastin e këngëve erotike, por me

të drejtë Mjeda i ka mbledhur sepse ai leksik shpreh gjendje të caktuara shpirtërore psikologjike të popullit të tij. Ato ishin të frymëzuara nga jeta, në kushte të caktuara historike dhe përbënin trashëgimi të kulturës shpirtërore të popullit. Është i njohur interesimi i Mjedës për folklorin shqiptar. Ai e kërkoj gjenëzën e popullit të vet, gjurmoi dhe studioi folklorin, gjuhën dhe historinë e popullit me një zell të jashtëzakonshëm. Që në rininë e tij ai botoi në "Shahiri Eliezer", "Këngen e Mahmud Pashës". Tek vepra e tij poetike kemi personazhe legjendare e mitologjike, të cilat Mjeda i kishte zgjedhur për t'u komunikuar bashkëatdhetarëve lashtësinë e të parëve të tyre. Poezia e tij është plot frazeologizma. Tek Mjeda gjejmë të përthithur nga letërsia gojore e popullit, mallkime, urime, përsëhendetje. Mjeda është treguar një njohës shumë i mirë i miteve vendase. Sibertzi i cili udhëtoi së bashku me Mjedën, tregon se poeti i njohte mirë episodet mitologjike që takuan në rrugën Mnelë-Kqirë.

5.

Në këtë periudhë Mjeda hartoi edhe një vepër tjetër të rëndësishme Fjalorin etimologjik të shqipes. Hartimi i kësaj vepre ka një histori sa interesante aq edhe të dhimbshme. Ndre Mjeda e bleu Fjalorin Etimologjik të Gustav Meyerit, botuar në Strassburg, më 1891, sapo doli nga shtypi. Ai u entuziazmau posa pa në këtë vepër njeriun dashamirës të Shqipërisë dhe albanologun e shquar. Mendohet se kjo duhet të jetë bërë shkak që Mjeda të hyjë në letërkëmbim me autorin e fjalorit etimologjik, Gustav Meyerin. Naim Frashëri, Sami Frashëri, Kamarda, De Rada, e, në përgjithsi, tërë rilindasit, përkrahën teorinë e prejardhjes pellazgjike të popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe. Ndre Mjeda falë formimit

shkencor, duke u bështetur në konceptet filologjike moderne të kohës, përqafoi teorinë e prejardhjes ilire të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe. Mjeda punoi me vullnet mbi këtë temë, shumë të dashur për të. Ai kuptoi të metat e fjalorit Etimologjik të Meyerit. Nga vërejtjet, kërkesat, plotësimet, sqarimet, komentet e shënime të tjera, që bëri Mjeda, mësojmë se ai merrej seriozisht me etimologjinë e gjuhës shqipe, si edhe prejardhjen e kombit shqiptar. Ai gjithsesi ishte më i privilegjuar se Meyerit dhe se albanologët e tjerë, sepse njihje me rrënjë pothuaj tërë dialektet e nëndialektet e shqipes. Meyer i pranonte se kishte nevojë për dënjtë, vërejtjet dhe këshillat e Ndre Mjedës, njëkohësisht shprehej i çuditur dhe entuziaist për punën kolosale dhe me interes shkencor të Mjedës për etimologjinë e shqipes. Mjeda u interesua të gjejë etimologjitë e Bugges në Bezenberger Beiträge. Mjeda punoi gjatë për fjalorin e tij etimologjik të shqipes gjatë kohës që ishte i mbyllur në seminarin e Gorizies. Ky fjalor u krijua në një mënyrë origjinale, por ndofta edhe jo fare origjinale, sepse edhe autorë të tjerë i kanë shkruar vepra e tyre në hapësirat e librave të tjerë në formë kritike, shënimesh apo plotësimesh. Mjeda e hartoi fjalorin e tij, duke punuar gjatë për dy vite me radhë mbi kopjen e tij të Fjalorit etimologjik të Meyerit. Pas një ndërprerje dy vjeçare dhe rifillimit të letërkëmbimit me Meyerin (maj 1896), Mjeda i dërgoi atij kopjen e tij të Fjalorit etimologjik, ku ishte mishëruar dorëshkrimi i veprës së tij krahasimtare. Meyerit impresionohet sapo bjen në kontakt me punën kolosale dhe profesionale të mikut të tij shqiptar. Nga ky çast, ai e sheh Mjedën me një sy tjetër, e sheh si një personalitet të shquar, që qëndron përkrah albanologëve më të mëdhenj të kohës. Ai nuk i kursen lavdërimet për Mjedën, çka nuk ishte e zakonshme për shkencëtarët e kalibrat të Meyerit. Vetë kërkesa e tij për ta mbajtur gjatë, edhe një vit tjetër Fjalorin është tregues për punën e madhe që kishte bërë Mjeda me këtë vepër. Menjëherë pas kësaj vjen edhe propozimi i Meyerit, i cili merrte përsipër të botonte dorëshkrimin e Fjalorit Etimologjik të Mjedës. Për fat të keq shëndeti i Meyerit keqsohet, duke bërë që kështu të ndërpritet bashkëpunimi në mes dy miqëve, sidomos plani i Meyerit për botimin e veprës së Mjedës. Profesori austriak u shtrua në spital në vitin 1897, pa shpresë shpëtimi dhe vdiq në vjeshtën e dytë të vitit 1900. Mjeda humbi kështu shansin për botimin e veprës së tij, ndërsa Albologjia humbi një vepër themelore për gjuhësinë shqiptare. Mbas Mjedës edhe Jokli e ka shkruar Fjalorin Etimologjik të shqipes, mbi librin e Gustav Meyerit: Ishte një praktikë e kohës. Po kështu veproi Çabej për tezën e doktoraturës në vitin 1933. Por çdo gjë nuk është e zezë: Ka shumë mundësi të gjenden kopja vetjake e Mjedës e Fjalorit Etimologjik të Shqipes të Meyerit, që kishte brenda dorëshkrimit e Mjedës. Ka shumë mundësi që kjo kopje të ketë mbetur diku në arkivat e Akademisë së Shkencave të Vjenës, ose në Statsarchiv të Vjenës. Ekziston edhe mundësia që libri të ketë përfunduar në Bibliotekën e Joklit dhe të ketë pasur të njëjtin fat me atë të bibliotekës së tij e cila siç dihet, mbas arrestimit dhe vdekjes së Joklit, ka përfunduar në duar të tjera. Në e kërkuam këtë kopje në Vjenë, por koha ishte e shkurtë prandaj mendoi se ja vlen të bëhen kërkime më të gjatë në bibliotekat, arkivat ose muzeumet e Vjenës. Poedhe mund të ketë mbetur në fondet e Meyerit. Camaj ka dhënë njoftimin se biblioteka e Meyerit dhe ndoshta dorëshkrimet e tij përfunduan në nonjë antikuarjat në Frankfurt.

90-VJETORI | I LINDJES

JAKOV XOXA

Shkrimtari që krijoi sagën e Myzeqesë

AGIM VINCA

Jakov Xoxa është pa dyshim një nga shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX; krijues që la pas vetes një vepër e cila i ka të rralla shoqet në letërsinë shqipe.

Një nga tregimet e hershme të tij, një rrëfim i bukur, gati në kufi të legjendës, për një bari myzeqar që vret beun për nder, titullohet Kapedani. Shëmbëllyeshëm personazhit të tij trim e krenar, Xoxa do të mund të quhej kapedani i Myzeqesë në fushën e letërsisë dhe veçanërisht të prozës shqipe. Rrëfimin për Myzeqenë dhe myzeqarët e filloi me novelat e tij pak të njohura (Novela I, II) dhe e vazhdoi me romanet e mirënjohura: Lumi i vdekur, Juga e bardhë dhe Luja e kripës, ndërkohë që nuk arriti ta përfundonte projektin e madh prej pesë romanesh, ku bënim pjesë edhe veprat e mbetura në zanafillë: Ari i zi dhe Dielli lind nga malet, që do ta kompletionin pentagonalin e tij romanore në formë të "X" (Iksit).

Sëmundja e kobshme, që i solli vdekjen e parakohshme, e gjeti "në vlagën e punës", siç do t'i thoshte, në spitalin e Tiranës, mikut dhe bashkëvendësit të tij, shokut të penës, Profesor Nasho Jorgaqit, por edhe me aq sa krijoi arriti ta sfidonte vdekjen dhe harrimin. I lidhur dhe i rritur në qytetin e Fierit, në zemër të Myzeqesë, prej së cilës nuk u nda kurrë, as kur studioi në Sofje të Bullgarisë dhe as kur krijoi marrëdhënie pune e familje në Tiranë, Jakov Xoxa shkrimtar synonte të bënte sagën e vendlindjes, të Myzeqesë dhe të mbarë fshatarësisë shqiptare, përfshirë edhe atë matanë kufijve politikë të Shqipërisë, Kosovën në radhë të parë. I pajisur me dije e kulturë të gjerë dhe me talent të fuqishëm, Xoxa ishte i vetëdijshëm se shkrimtari duhet të jetë si Anteu, i lidhur me tokën mëmë, por edhe se jetën duhet ta trajtojë gjerësisht dhe me një sens universal, gjithënjëzëz, sepse vetëm në atë mënyrë vepra letrare mund të ketë jetë të gjatë dhe të komunikojë me një rreth më të gjerë njerëzish.

Mopasani, një nga gjenitë e artit letrar, që hynte në radhën e krijuesve të preferuar të Xoxës, thoshte se publiku kurrë nuk do të ndryshonte që i thërrasin shkrimtarit orë e cast: "Më ngushëlloni! Më argëtoni! Më pikëlloni! Më mallëngjeni! Më shtyni të ndërroj! Më bëni të qesh! Më bëni të qaj! Më shtyni të mendoj!" e kështu me radhë. Jakov Xoxa është nga të paktit shkrimtarë shqiptarë, që arrinjtë t'i përmbushin këto kërkesa, duke i bërë lexuesit edhe të qajnë, edhe të

Rrëfim mbi takimin e 1974. Xoxa në Kombinatin e Tekstileve në Berat: "Eh, sikur edhe ne shkrimtarët të kishim një sinjal që të ndizej kur nuk e kemi mirë"...


qeshin, edhe të pikëllohen, edhe të ngushëllohen, edhe të ndërrojnë, e edhe të mendojnë. Të mendojnë sidomos. Sepse Xoxa është krijues që e paraqet jetën në plotësinë e saj; me të mirat dhe të këqijat që ofron ajo. E mira dhe e keqja, dashuria dhe urrejtja, e bukura dhe e shëmtuara, jeta dhe vdekja sublimohen fuqishëm në tërë krijimtarinë e tij letrare dhe veçanërisht të Lumi i vdekur e Luja e kripës. Shkrimtar me vizion të gjerë shoqëror dhe me aftësi të mëdha vrojtuese, Xoxën e karakterizonte edhe përkushtimi i rrallë ndaj punës krijuese, që manifestohet në tre rrafsh kryesore: në raport me veprën në tërësi (duke nisur nga fabula e syzheu e gjer te kompozicioni), në raport me gjuhën dhe stilin e saj (pasurinë e madhe leksikore, frazeologjike, figurative, semantike etj.) dhe në raport me lexuesin si faktor i rëndësishëm i komunikimit estetik.

"Unë kurrë nuk i kam konsideruar lexuesit si fëmijë, të cilëve duhet t'u bësh lloj-lloj pëlhavnillëqesh që t'i detyrosh të hanë atë që do ti. Unë i konsideroj lexuesit e mi të rritur, të pjekur, njerëz me mend, të cilët duan ushqim të mirë, të pastër, të shijshëm; duan të mësojnë, të njohin, të emocionohen, të urrejnë, të dashurojnë. Për këtë përpiqem unë. Sa ia dal është punë tjetër", thoshte me modesti.

I takoj brezit që është rritur e mëkruar me veprën e Xoxës, të Spassës, të Kadarsës, të Agollit, të Sabri Godos, të Petro Markos, ashtu sikundër edhe me atë të Esad Mekullit, të Hivzi Sulejmanit, të Adem Demaçit, të Azem Shkrelit e të Rexhep Qosjes, pak më vonë, sepse falë rrethanave më të favorshme politike e shoqërore, që u krijuan në Kosovë në gjysmën e dytë të viteve '60, kur unë isha student, arriti të depërtoje edhe andej. "Rilindja" botoi në vitin 1971 veprën e Xoxës në tërë vëllime, sado që kon-

takti me të pat filluar qysh më parë. Në Prishtinë kjo vepër u lexua shumë dhe u vlerësua lart, posaçërisht Lumi i vdekur, kurse autori i saj u radhit në mesin e shkrimtarëve më të dashur e më të çmuar të lexuesve dhe të kritikës letrare jo vetëm për shkak të përmbajtjes së rëndësishme që trajtonte vepra e tij, por edhe për shkak të gjuhës së pasur dhe stilit të papërsëritshëm nëpërmjet të cilit sendërtohej ajo.

Kam pasur rastin ta njoh Jakov Xoxën edhe si njeri dhe të qëndroj me të gati një ditë të tërë. Një ditë pranvere të vitit 1974, kur unë dhe kolegët e mi të Universitetit të Prishtinës të ardhur në Tiranë për një qëndrim studios, do të bënim udhëtimin për në jug të vendit, me ne do të udhëtonte, me të njëjtën makinë, edhe shkrimtari Jakov Xoxa. Na erdhi si një shihari që hotel "Dajti" lajmi se do të udhëtonim bashkë me Jakov Xoxën nga Tirana në Fier e Apolloni, të "selia" e tij, kurse takimi me të mbeti i paharrueshëm për të gjithë ne që e patëm këtë shans, mbase krejt rastësisht. Aty pata dëgjuar për herë të parë për ciklin e tij prej pesë romanesh në formë Iksi, kurse gjatë vizitës në Kombinatin e Tekstit në Berat, kur ndodhte të këputej filli dhe në makinat e prodhimit kinez ndizej sinjali i kuq, Kovi, si e thërrisnin miqtë e tij, pat thënë: "Eh, sikur edhe ne shkrimtarët të kishim një sinjal të tillë që të ndizej kur nuk e kemi mirë". Në rrethanat në të cilat krijonin atëbotë shkrimtarët shqiptarë, në kushtet e sistemit totalitar, kjo ishte një fjalë me domethënie të



Shkrimtari Jakov Xoxa

rrëth manastirit kishte gufuar, kurse unë dhe një kolegu im, si më të rinjtë e grupit, patëm improvizuar një "përleshje" si të ishim Adili e Llazi, në sy të krijuesit të tyre, që na vështronte me mall e dashuri... Nuk do ta takoja më Jakov Xoxën, as në '76-n e as në '79-n, kur iku nga kjo botë, por pamja dhe portreti i tij, që rrezatonin çiltërsi, mirësi, zemërgjerësi e fisnikëri, do të më ngelin përgjithmonë në kujtesë. Trupi i drejtë, fytyra e rregullt, flokët e bardha borë, buzëqeshja e lehtë dhe qëndrimi korrekt i spikatnin akoma më shumë virtutet e tij. Jakov Xoxa vdiq i ri, 56 vjeç. Për një shkrimtar si ai, që synonte të bënte një vepër të madhe, kapitale, të ngjashme me atë që kishin bërë në letërsinë e mëdha evropiane shkrimtarë si Balzaku, Hygoi, Zola, Stendali, Dikensi, Tolstoji, Tomas Mani a Shollohovi, kjo ishte pak; tepër pak. Xoxa jetonte me veprën e vet, me heronjtë e tij, aq sa, siç dëshmon e shoqja, Dhurata dhe biografia

ndërgjegjen e njerëzve. Nuk harrohen lehtë as protagonistit i Lumi të vdekur, fshatari kompleks Pilo Shpiragu, mbi të cilin rëndon jeta plot halle nën regjimin shtypës e poshtëruar të bejlerëve e çifligarëve; as heroi negativ i periudhës së socializmit, Kiu Korroziu i Jugës së bardhë, e aq më pak Gruaja e Mallkimit e Lules së kripës, e mbiquajtur kështu për shkak të kompleksit të saj të mëmësisë, apo edhe Kavroshi shqiptar, Paci simpantik, që bie në luftë kundër fashizmit dhe sa e sa personazhe të tjera nga galeria e gjerë e personazheve të këtij shkrimtari, që krijoi një perandori të tërë letrare. (Kam kënaqësinë t'ju komunikoj se në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, janë mbrojtur deri tani dy tema doktorate për veprën e Xoxës dhe po përgatitet edhe një e tretë, që do të ketë objekt studimi personazhet e romaneve të tij). Xoxa përfaqëson një shkrimtar model në letërsinë shqipe - krijuesin e prozës së madhe realiste, të cilën nuk e kishte njohur kurrë më parë letërsia shqipe në ato përmasa, me atë gjerësi vrojtimi, me atë thellësi psikologjike, me atë sintezë mendimi dhe me atë bukurigjuhë e stili. Koha ka dëshmuar se ky lloj letërsie, më saktësisht ky lloj proze, edhe kur, nën trysinë e ndryshimeve në shoqëri, mund të duket i vjetruar, e sfidon kohën, ideologjitë, metodat letrare, sistemet politike, modën, snobizmin. Duke u nisur nga ky fakt, poeti Dritëro Agolli, në veprimtarinë e organizuar dhjetë vjet më parë, për nder të 80-vjetorit të lindjes së shkrimtarit, pat thënë: "Jakov Xoxës pasardhësit e tij do t'i kthehen si në 80-vjetorin dhe në 800-vjetorin e lindjes së tij". S'do mend se një fat të tillë e kanë vetëm krijuesit e mëdhenj, të cilët me veprën e tyre i mbijetojnë shekujt. Jakov Xoxa është pa dyshim një nga këta krijues, që kanë zënë vend tashmë në pantoonin e vlerave të letërsisë sonë kombëtare dhe s'mund t'i heqë kush që andej. (Fjalë e mbajtur në Fier, Apolloni, në shënimin e 90-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Jakov Xoxa, 1923-1979)

Jakov Xoxa shkrimtar synonte të bënte sagën e vendlindjes, të Myzeqesë dhe të mbarë fshatarësisë shqiptare, përfshirë edhe atë matanë kufijve politikë të Shqipërisë, Kosovën në radhë të parë

madhe dhe me nëntekst të veçantë. Me t'u vendosur në dhomën e hotelit në Fier, puna e parë që bëra ishte ta shkruaja bisedën me Jakov Xoxën. Kur zbrita në restorant për darkë, kërkoja pëlqimin e tij që bisedën ta botoja në Kosovë. Ashtu edhe u bë. Shkrimi Iksi romanesh i Jakov Xoxës doli në plot dy faqe në gazetën "Bota e re" të studentëve, që ishin lexuesit më të mëdhenj të veprës së tij.

Kanë kaluar plot 39 vjet nga ajo kohë, por ende e ruajt të freskët në kujtesë atë takim. Mbjaj mend se bari

i tij, Kristaq Shtëmbari, ndodhte t'i shihte edhe në ëndërr personazhet e tij, si të ishin njerëz të gjallë.

Xoxa krijoi çiftin ndoshta më të bukur të letërsisë shqipe: Vitën dhe Adilin. Ec e gjeje një tjetër më të bukur, më të skalitur, më kuptimplot! Dashuria me kosovarit dhe myzeqares, e mishëruar artistikisht me bukuri e plasticitet të rrallë, është pa dyshim një ide geniale e Xoxës, i cili si njeri dhe shkrimtar qëndronte përmbi paragjykimet fetare, krahinore e të tjera, të rrënjësura thellë në

INVESTIGIMI | LIBRI

DHURATA HAMZAI

Libri "Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë" hedh dritë mbi historinë e aristokracisë shqiptare në shekuj. Konkluzioni më interesant që del prej këtij libri është fakti se fiset aristokratike shqiptare të detyruara nga pushtimi osman kanë emigruar në vendet fqinje duke mbartur gjuhën, kulturën traditën dhe stilin specifik të jetesës. Kështu, për rreth 5 shekuj ata nuk e kanë lejuar asimilimin nga kulturat vendase. Kjo e ka ndihmuar autorin e këtij libri Paolo Petta, një ndër studiuesit më interesantë të historisë së Shqipërisë të këtyre dekadave të fundit, që të gjej gjurmët e dhjetëra trashëgimive të këtyre principatave. Paolo Petta ka nisur kërkimet e në arkiva dhe në terren për të zbuluar pasardhësit që nga "trashëgimia e vëshirë e Skënderbeut", ku ka gjetur edhe pasardhësit e tij në mërgim, duke rënduar pastaj në gjurmë të tjera të detyrës princërore shqiptare, ku ka gjetur trashëgimtarë të familjes së Muzakajve në Napoli, që për ta ka qenë një vend strehimi i sigurt në kohë të vështira. Petta ka zbuluar degë të familjes së Gjergj Arianitit, ku rrëfimet dokumentare në këtë libër janë shpesh të mahnitshme, siç është rasti kur ai tregon për pasardhësen Angelina, degë e emigracionit serb dhe martesën me një italian. Petta ka takuar edhe pasardhësin e Aranitëve Kostandinin dhe vëllezërit e tij, të cilëve u kushton një kapitull më vete, "Zoti Kostandin" në Monferrato dhe në lojën politike franceze. Në faqet e këtij libri zbulon gjakun e princërve të tjerë shqiptarë, Topiajt, Dukagjinët, etj. Paolo Petta (1942 - 1999) u lind në Feltre të Italisë në një familje me origjinë nga Piana degli Albanesi. Ekspert i së Drejtës Kushtetuese dhe studiues historie, ai ka punuar në Senatit e Republikës Italiane si Drejtor i Shërbimit për hartimin dhe rishikimin e teksteve legislative. Ai është autor i disa shkrimeve historike, mes të cilave dhe i dy librave, si dhe i një sërë shkrimesh me temën shqiptare. Ndër veprat e tij, mund të veçohet "Stratiotët, ushtarë shqiptarë në Itali (shek. XV - XIX) Argo, 1996. Bashkë me librin "Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë", po i japim lexuesit edhe një shkrim tjetër interesant të autorit, "Paradokse shqiptare, kaq afër e kaq larg", marrë nga revista "Politika ndërkombëtare" nr. 3, 1994 Romë. Duke shkëputur një fragment nga libri i tij vërejmë se çështja e trashëgimisë princërore të gjakut shqiptar është me shumë rëndësi për këtë autor:

IKJA NGA SHQIPËRIA

"Emigrimi i shqiptarëve në Itali, të paktën duke nisur nga dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIV, ka qenë një dukuri thuajse e qëndrueshme në historinë e dy vendeve. Në periudha historike të veçanta, siç është kjo që po kalojmë, ky fluks ka marrë përmasat dramatike të një vërshimi. Pas vdekjes së Gjergj Kastriot-Skënderbeut (1468), njeriut që për më se dy dhjetëvjeçarë drejtoi një luftë sa heroike aq edhe të pashpresë kundër perandorisë osmane, dhjetëra mijëra shqiptarë mërguan në Itali. Prapa tyre ata lirin një vend të rrënuar, ku po konsolidohet një regjim që për ta ishte i huaj dhe armiqësor, por që me kalimin e kohës do të hidhte rrënjë të thella në shoqërimë shqiptare. Ky libër rreket të ndjekë fatin e një grupi tepër të veçantë të ikurish, atë të pinjollëve të familjeve fisnike të Shqipërisë së krishterë, të cilët gjetën strehim në Itali, duke mos pranuar të ktheheshin në fenë islame, gjë që do i kishte lejuar ata të ruanin goftë edhe pjesërisht zotërimet e veta. Në krye të tyre qëndronin, të paktën idealisht, pasardhësit e Skënderbeut, por bashkë me ta mund të shquajmë gjurmët e një pjese të mirë të familjeve që kishin qenë në krye të listës para pushtimit osman. Nuk përfshihen në këtë studim ato familje shqiptare (si Buat), që erdhën në Itali nga Greqia, ku gjithashtu kishin



NË FOTO: Kopertina e librit "Despotë të Epirit dhe princër të Maqedonisë"

Libri
Pasardhës të familjeve princërore pesëshkullore të Skënderbeut, Aranitëve, Muzakajve, Dukagjinëve, etj vijjnë në librin e studiuesit Paolo Petta "Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë". Petta, një ndër studiuesit më interesantë të historisë së Shqipërisë

Zbulohet gjaku i princave shqiptarë në Ballkan e Europë

Paolo Petta, mes paraardhësve të gjallë zbulon edhe Kostandinin e Aranitëve në Monferrato dhe në lojën politike franceze

arritur të bënin emër. Siç pohonte Paolo Sarpi, ajo çka i jep shtyssa historianit është gjithmonë "shija e gjërave njerëzore": shija e përhershme që qëmtohet në çdo histori dhimbjesh e pasionesh, pushteti e intrige, pavarësisht nga fakti se në të përfshihen pak persona, grupe të gjëra shoqërore apo popuj të tërë. Në rastin tonë historia zhvillohet në botën gjithë shkëlqim të Rilindjes italiane, edhe pse protagonistët e saj nuk janë italianë: ata janë fisnikë të shpronësuar, që luhateshin mes dëshpërimit të një rrënim të pakthyeshmë dhe shpresës për një integrim të mundshëm në klasën sunduese; që vuanin fatalisht sa mercinë e një jete të karakterizuar nga solidariteti i familjes, i grupit ose i fisit, aq edhe joshjen për t'u përshtatur, për t'u bërë italianë, ndonjëherë madje më shumë se vetë italianët. Në mënyrë të pashmangshme ky trajtim lë në hije masën kryesore të mërgimtarëve, ata që nuk patën fatin të priteshin në pallatet e papëve, të mbretërve e të princërve, ata që, edhe nëse u lejuan të zbrisnin në tokë, gjë që nuk ndodh sot, gjithsesi nuk u lanë t'u afroshin qyteteve, që i shihnin ata me dyshim e frikë. "Të zë një trishtim i madh, Imzot, kur sheh të vijnë këta njerëz të ngratë e mjaft të varfër të shoqëruar nga fëmijë, të cilët nuk lejohen të hyjnë në qytetet e në zotërimet tuaja dhe janë

vendosur në fushë të hapur, të zhveshur ose të veshur si mos më keq": kështu i shkruante më 1467 një oficer aragonez mbretit të tij 1. Do të ishte e padrejtë të akuzoheshin Kastriotët, Arianitët, Muzakët që nuk e kishin vënë ujën në zjarr për fatin e këtyre njerëzve: por historitë e tyre ishin pa dyshim shumë të ndryshme.

ARISTOKRACIA SHQIPTARE

Për arsye që vetëkuptohet, të ikurit shqiptarë në Itali u përpoqën të paraqiteshin si trashëgimtarë të një bujarie pak a shumë të ngjashme me atë perëndimore. Shpesh herë një gjë të tillë e bëjnë duke i veshur vetes tituj të bujshëm e krejtësisht të sajuar, sipas modeleve që ofronte tradita bizantine, ajo e feudalizmit latin në Lindje ose tradita perëndimore ("despot i Epirit", "duke i Akës", "princ i Maqedonisë"). Kuptohet, nuk na lejohej të kemi dyshime mbi karakterin e vërtetë të kësaj "bujarie", por nga ana tjetër nuk ka përse të përqohim një praktikë, që ndiqej edhe nga pinjollë të familjeve që kishin qenë vërtet të fuqishme e me lavd. Në kuadrin e shpërbërjes së pushtetit qendror që kishte karakterizuar Shqipërinë pas shembjes së perandorisë serbe (1356), mjaft krerë feudalë arritën të krijonin minishtetet e tyre, ku silleshin si sovranë të vërtetë: jo si "baronë", siç do të

thuhej në terminologjinë e kohës, por si "princër". Kronikat e dokumentet italiane ose raguzane, siç duket qartë, të pavendosura se si mund t'i thërrisnin, i quanin "signorelli", "signorelli" ose edhe "regulli". Disa prej këtyre zotërinjve i përkisnin familjeve që ishin të pushtetshme, ngaqë qenë në krye të fiseve të mëdha dhe që në ndonjë rast, si në atë të Muzakëve e të Dukagjinëve, i kishin dhënë emrin e tyre krahinave të tëra. Megjithatë, me kalimin e kohës, pushteti i tyre mbështetej gjithnjë e më shumë mbi pasurinë e trashëgimimë, duke i humbur tiparet demokratike të organizimit të dikurshëm fisnor. Në shumë raste ngjitja e tyre ishte bërë nën hijen e perandorëve ose despotëve bizantinë e serbë, të cilëve u kishin shërbyer dhe prej të cilëve ishin shpërblyer me tituj të bujshëm, si sebastokrator e të tjerë. Në fund të fundit, kështu vepruan edhe turqit, të cilët përshtatën një sistem mjaft të ngjashëm me sistemin feudal, atë të timareve, të cilat shpesh u shpërndaheshin anëtarëve të familjeve të mëdha në po ato toka që kishin qenë gjithnjë pronë e tyre. Në Shqipërinë paraosmane nuk mund të flitej për një sistem feudal në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kjo edhe për arsyes se mungonte vetë institucionet që e karakterizon sistemin në fjalë: dhurimi solemn i feudit nga ana e kryezotit. Vetëm nëse u rreferohej formave të pushtetit ekonomik dhe kushteve të bujqve, mund të flitej për një feudalizëm shqiptar me po ato tipare të përafërta që kishte "feudalizmi bizantin" i studiuar nga Ostrogorski, ku bujkorëria praktikisht mungonte 1.

Sa për "fisnikërinë", që sipas konceptit perëndimor përfaqësohte një shtresë me një status juridik të veçantë, as që mund të bëhej fjalë. Në fund të fundit, edhe në Perëndim nocioni i "fisnikërisë" u poq gjatë një procesi të gjatë historik e ideologjik, si rezultat i puçjes së traditave juridike e kulturore të ndryshme. Është rasti të nënvizojmë se në Shqipëri, ndryshe nga ç'ndodhte, për shembull, në Kostandinopojë, thjeshtësia e madhe e strukturave shoqërore e bënte më të dukshme ndarjen e klasave, sado që një ndarje e tillë mund të zbutet nga solidariteti i fisit; nga ana tjetër, nuk ekzistonte, ose ekzistonte fare pak, ajo lëndë amortizuese, që në shoqëritë më të zhvilluara përfaqësohej nga shtresa shoqërore siç ishin fisnikëria e togës ose patriciati i qyteteve, për të mos folur pastaj për elementë të ndryshëm të borgjezisë qytetare në formim e sipër 2. Në rastin e Shqipërisë do të ishte më e saktë të flitej për një grumbull anarkik zotërinjsh të vegjël, të mbështetur nga krerë të tjerë të vegjël që ishin nën pushtetin e tyre (dhe që për lehtësi do të mund t'i quanim "vasalë"), të cilët shpesh herë lidheshin me të parët në linjë fisnore dhe, për rrjedhojë, pranoheshin në rrethin e tyre familjar. Pas çdo gase, e tillë ishte pozita e Vrana Kontit (për të cilin do të flitet më poshtë) ndaj Skënderbeut 3. Konturet e këtyre hierarkive shoqërore shquhen qartë edhe pas fasadës barazitare e meritokrate të perandorisë osmane. Sa për zotërimet veneciane, aty përmenden familje të hershme, që kishin mundur të ruanin pasurinë dhe autoritetin e dikurshëm, edhe pse nuk kishin më pushtet politik. Familjet në fjalë përmbënin atë që vetëm për krahasin mund ta quajmë "bujari" ose më mirë, "fisnikëri" shqiptare, kohezioni i së cilës ishte ngjizur me një rrjet të dendur marrëdhëniesh martesore, falë së cilës, si dhe numrit të madh të fëmijëve nga familjet e shquara dhe zakonit të rimartesës së burrave të veje e grave të veja, çdo shtëpi të rëndësishme i binte të kishte lidhje familjare të shumëfishta me familjet e tjera. Është e tepërt të thuhet se pikërisht një praktikë të tillë i duhet njohur edhe ai funksion legjitimimi shoqëror i ndërsjellët, i cili konfirmon homogenitetin e segmenteve të ndryshëm të kësaj shtrese sunduese (si në zotërimet e pavarura ashtu edhe në zotërimet veneciane ose turke) dhe largësinë e tyre nga shtresat më të ulëta.

DEBATI | HISTORIA

KORRIGJIMET NE

Ç'do të qe Skënderbeu nëse përballë

AKADEMIK MEHMET KRAJA

PSE DUHEJ TË NDODHTE?

Historia krijon vetëdije dhe botëkuptim, prandaj sulmet ndaj historisë së një populli që prej kohës konsiderohen si sulme ndaj identitetit dhe qenies kombëtare. Politika, regjimet dhe ideologjitë vazhdimisht kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të kujdesshme ndaj historisë, sepse në shkrimet për kohën e shkruar gjithmonë janë fshehur paralajmërimet për të ardhmen. Asnjë histori deri më sot nuk është shkruar pa përzjerjen e pikëpamjeve politike në diskursin historik, madje, në disa raste, shkrimi historik ka mundur të shërbejë si pararendës i zhvillimeve të mëvonshme politike. Prandaj, nuk ishte e rastit që më 2002-3, në situatën e një krize të përgjithshme të ideve për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, atëherë kur në bashkësinë ndërkombëtare u rifuzuua ideja e kthimit të Kosovës nën administrimin e Serbisë, u shfaq edhe kërkesa e Këshillit të Europës, në formë të rekomandimit, që në tekstet e historisë për shkolla të vetëqarë dhe të mesme të Kosovës të bëhen disa korrigjime, të vogla, të parëndësishme në dukje të parë, por esenciale në substancë. Në pamje të jashtme korrigjimet kishin këtë synim: që nga tekstet tona të historisë të mënjanohej diskursi i ashpër nacionalist, në mënyrë që të femijet shqiptarë të Kosovës të mos krijohet urrejtja ndaj popullit serb, sepse, sipas një parimi të përgjithshëm, për atë që kishte ndodhur në Kosovë nuk mund të ishte fajtor populli serb, por regjimi, pushteti, pra Millosheviqi. Prandaj, kudo që veprimet negative të Serbisë në Kosovë ishin identifikuar si "serbe", u zëvendësuan me "shtetërore", ndërsa në shumë vende "pushtuesi serb" ose u hoq në tërësi, ose u zëvendësua me "pushtetin". Këto korrigjime, në substancë, kishin implikime të mëdha për historinë mbi njëqindvjeçare të Kosovës në raport me Serbinë, por, mbi të gjitha, në luftën e vitit 1999. Tani dilte se Serbia nuk kishte qenë asnjëherë pushtuese në Kosovë dhe se luftërat e shqiptarëve të Kosovës kundër Serbisë, përfshirë edhe luftën e UÇK-së, nuk kishin qenë luftëra çlirimtare, por më shumë një konflikt i "shqiptarëve etnikë" me pushtetin, i cili ua shkelte liritë dhe të drejtat. Këshilli i Europës desh ta sillte situatën në këtë pikë dhe për këtë qëllim tregoi gatishmëri të financontë korrigjimet e teksteve dhe ribotimin e tyre. Shumë më e rëndë se historia e shkruar, ishte historia që përgatitej të jetohej: nëse shqiptarët e Kosovës kishin luftuar kundër pushtetit dhe jo kundër pushtuesit, atëherë ndryshimi i pushtetit në Serbi (me një garanci eventuale ndërkombëtare) vetvetiu nënkuptonte kthimin e Kosovës atje ku kishte qenë para vitit 1999. Do vërejtur se grupi i historianëve që i propozoi ndryshimet në tekstet shkollorë më 2003, njësoj si edhe

Për shkollat shqiptarë, të Kosovës apo të Shqipërisë, ç'kuptim mund të ketë Skënderbeu me krejt historinë dhe krejt literaturën që i shoqëron bëmat e tij, nëse përball nuk ka sulltanët pushtues, por ca përhapës të emancipimit?

strukturat e Ministrisë së Arsimit, vinin nga provenienca politike e LDK-së, së cilës, në kontekstin e zhvillimeve politike të atyre viteve, i shkonte përshtatë minimizimi ose një paraqitje sa më inverzive e luftës së UÇK-së, sepse trashëgimia e kësaj lufte e bënte kundërshtarin e saj politik tepër të fuqishëm.

DHJETË VJET MË VONË...

Dhjetë vjet më vonë situata në Kosovë paraqitet krejtësisht ndryshe: Kosova është shtet sovran me shumë njohje ndërkombëtare, loja me statusin e saj ka marrë fund dhe nuk ka rrezik që ajo të rikthehet nën Serbi në asnjë rrethanë, në pushtet tani nuk është LDK-ja, por PDK-ja etj. Përdorimi politik i historisë nuk vazhdoi aty ku mund të pritej dhe të supozohej, në valorizimin folklorik të UÇK-së, sepse ky valorizim tashmë mund të quhet i përfunduar, pa gjetur ndonjë kundërshtar aq të denjë dhe të fisëm. Por, papritmas u shfaq në horizont një kërkesë tjetër: Qeveria e Turqisë filloi një trysni të paparë mbi institucionet e Kosovës, për të spastruar tekstet e historisë të ciklit parau-niversitar nga përmbajtjet që denigrojnë Perandorinë Osmane, në këtë fushatë u angazhua kupola më e lartë e shtetit turk, duke filluar nga kryeministri, ministri i Jashtëm, ministri i Arsimit dhe, natyrisht, ambasadorja në Prishtinë, e cila tashmë ka marrë në dorë kryerjen e punëve operative. Ngjashëm me rastin e dhjetë viteve të shkuara me rekomandimet e Këshillit të Europës, Ministria e Arsimit e Kosovës përsëri bëri një komision, për të identifikuar pikat nevalgjike ku duhej ndërhyrë, tani

komisioni nuk përbëhet vetëm nga historianët, por përfshin edhe gjeografë, albanologë, osmanologë etj, pra, një spektër të gjerë të "dinjitarëve" kosovarë, të angazhuar pa hile që nga kjo lojë të dalë e fituar Turqia dhe shteti i Kosovës të nëpërkëmbët sa më fort. Themi kështu, për shkak se planet dhe programet mësimore janë çështje të shtetit dhe ndërhyrjet nga jashtë në përmbajtjet mësimore mund të konsiderohen si shkelje e sovranitetit. Më anë tjetër, përfshirja e pashembullt e kupolës më të lartë politike të shtetit turk në këtë çështje, bën të ditur se trashëgimtarja e sotme e dinastisë së dikurshme të selxhukëve, Turqia bashkëkohore, krahas fuqizimit ekonomik, në programin e vet kombëtar e ka ndryshimin e imazhit të pushtesit të dikurshëm të Ballkanit. Që në vitin 2009, në një konferencë për çështjet e Ballkanit mbajtur në Sarajevë, ministri i Jashtëm turk, Ahmet Davutogllu, pasi u shpreh me fjalë mallëngjëse "për sundimin e lavdishëm osman", i cili "i sollti dritë dhe emancipim Gadishullit Ballkanik", "u bëri thirrje popujve ballkanas, e në radhë të parë Bosnjës, Shqipërisë dhe Kosovës që t'i kthehen prapë asaj kohe të artë" (citimi sipas Kadarese, "Mosmarrëveshja", faqe 35). Për të realizuar këtë program kombëtar, Turqia e sotme ka gjetur terren të përshtatshëm në tre shtetet e përmendura të Ballkanit, njësoj si në dy ose tre shtete të Azisë së largët: paqëndrueshmërinë ekonomike, trashëgiminë historike dhe mentalitetin anadollak. Kriza ekonomike në Europë i shkon përshtatë kësaj rrethane, sepse në shtetet e Ballkanit mungojnë ndjeshëm investimet perëndimore, ndërsa Turqia paraqitet prijëse në eksportimin e kapitalit në këtë rajon, duke krijuar një atmosferë biznesi krejtësisht orientale në këto vende të përfshira nga transicioni i mundimshëm. Pra, thënë ndryshe, Turqia e sotme e ka vendosur të mos bëjë investime vetëm për leverdi ekonomike, por duke imponuar edhe synimin e saj për një rol të ri në këto hapësira, i cili shkon deri te projekcioni fantastik i rikthimit në skenë të Perandorisë Otomane, natyrisht me një pamje të re dhe me veshje të re botëkuptimore dhe doktrinare.

BASHKËPUNIMI NË GJENOCID

Tani mbetet çështje e diskutueshme se cilat janë interesat e shqiptarëve në këto aspirata të Turqisë dhe se me çfarë çmimi duhet ta paguajnë mbështetjen politike dhe ekonomike që ky shtet ua bën klasave politike shqiptare. Çmimi më i rëndë dhe më i papërbalueshëm do të ishte krijimi i një amalgame identitare joeuropiane, një mallkim ky që u ka qëndruar mbi kokë shqiptarëve, së paku njëqind vjet para se ta bënin shtetin dhe njëqind vjet pasi e bëne shtetin shqiptar. Përgjatë gjithë periudhës së Rilindjes Kombëtare, përfshirë edhe Lidhjen e Prizrenit, Lidhjen e Pejës, kryengritjet që i patën paraprirë formimit të shtetit shqiptar, pra përgjatë gjithë këtyre zhvillimeve me parashenjë të qartë kombëtare, në lëvizjen shqiptare ka vepruar e pandarë një rrymë proturke, e cila në disa çaste vendimtare arriti ta devijonte çështjen shqiptare, qoftë duke u bërë zë i fuqishëm vetëm për një autonomi shqiptare në kuadër



HISTORIOGRAFI

s'do të qe pushtuesi por emancipuesi?



të Turqisë, qoftë edhe më vonë, duke synuar ta bënte shtetin shqiptar "një Turqi të vogël në Ballkan". Ishte meritë e një klase politike dhe një klase intelektualesh propeëndimorë, të cilët, gjatë viteve njëzet dhe tridhjetë të shekullit të kaluar, përfundimisht e shkëputën Shqipërinë nga trashëgimia anadollake. Mirëpo, në Kosovë, për shkak të zëvendësimit të një pushtuesi me një pushtues tjetër edhe më të egër, nuk u zhvillua procesi i shkëputjes emancipuese nga orientizmi dhe turqizmi, madje, sikundër dihet, ruajtja e trashëgimisë otomane në të gjithë përbërësit e jetës shoqërore u stimulua nga programi nacional serb. Çuditërisht, jo Turqia e sulltanëve, por Turqia e Atatürkut u bë aleate e fuqishme e njëres dhe tjetres Jugosllavi për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova. Asgjë nuk ndihmoi që kjo të mos ndodhte, as lidhjet tradicionale shqiptaro-turke, as minoriteti i madh shqiptar në Turqi, as prania e madhe e shqiptarëve në nivelet më të larta të administratës civile dhe ushtarake të shtetit turk. Kosova u lëndua rëndë nga marrëveshjet e fshehta dhe traktatet e mbetura në tentativë ndërmjet Mbretërisë Jugosllave dhe Turqisë, apo të Titos me Kyrilium në vitin 1953 në Split. Që të mund të ndërronte imazhin e saj negativ, tashmë jo otoman, por modern, Turqia do të duhej të kishte kurajë t'i kërkonte falje popullit të Kosovës për këtë gjëmë të madhe që i shkaktoi, duke u bërë aleate e programit nacional serb në gjenocidin e hapur ndaj popullit të Kosovës. Po kaq lëndues për shqiptarët është edhe një fakt tjetër: në njërin anë, arroganca me të cilën ajo kërkon t'i avancojë të drejtat e minoritetit turk në Kosovë, ndërsa, më anë tjetër, minoritetit shqiptar në Turqi nuk ia njeh asnjë të drejtë. Nxjerrja si pengesë e zgjidhjeve kushtetuese që aplikon Turqia ndaj minoriteteve kombëtare është justifikim i paqëndrueshëm, sepse, kur Erdogan ka interes të fuqizojë pushtetin civil mbi atë ushtarak, ndryshimet kushtetuese i bën pa hezitim.

DISKURSI APO PËRMBAJTJA?

Ndryshimet, për të cilat këmbëngule administrata e lartë e shtetit turk, në dukje të parë nuk janë të papërballeshme, sepse ngajné disi kozmetike, sikur prekin dizajnimin e historisë, pra shkrimin dhe jo substancën, jo përmbajtjen, jo faktet historike. Pavaresisht nga mjegulla që mund të krijohet rreth kësaj çështjeje, qëllimi mbetet po ai: të bëhet "ç'mitizimi" (siç do ta quajë këtë proces njëri nga mbështetësit e këtyre ndryshimeve) i rolit negativ të Perandorisë Osmane në historinë shqiptare, jo sa për sy e faqe, por duke i krijuar favore Turqisë bashkëkohore. Pra, sipas mbështetësve të këtij procesi, historiografia shqiptare e ka mitizuar rolin negativ të Perandorisë Osmane dhe, duke e quajtur atë "pushtues të egër", përcor mesazhe negative edhe për Turqinë bashkëkohore. Prapavija është politike, nuk është aspak shkencore. Si në rastin e Këshillit të Europës, kur synohej që, duke zëvendësuar "pushtuesin serb" me "pushtetin serb" të krijohej një klimë e favorshme për kthimin e Kosovës nën

Ç'kuptim mund të kenë letërsia dhe dijet humane të Rilindjes Kombëtare, nëse përball tyre nuk qëndronte një pushtues që ua kishte mohuar lirinë shqiptarëve, por dikush që rrezatonte kulturë dhe civilizim?

KUSH JANË MBËSHTETËSIT?

Idetë për një rol tjetër të Perandorisë Osmane në zhvillimet historike në botën shqiptare, në historinë e Kosovës në veçanti, kishin një mbështetje edhe para se të shfaqeshin në formën e tanishme. Që në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar në Prishtinë, në periudhën e liberalizimit të dijesh historike, në mesin e historianëve tanë (me gjasë, nën ndikimin e historianëve të Turqisë) ishte shfaqur teza se islamizimin e shpejtë dhe masiv të shqiptarëve të Kosovës nën Perandorinë Osmane duhej parë në një këndvështrim pozitiv, sepse, sipas kësaj teze, ka qenë pikërisht ky islamizim që i ka ndihmuar ata të ruajnë identitetin dhe kombësinë, kundrejt sllavizimit, i cili i asimiloi në masë të madhe shqiptarët e krishterë në Kosovë dhe në viset përreth saj. Sesa është e paqëndrueshme kjo tezë, mjafton të sjellim në vëmendje faktin se ishte pikërisht muslimanizimi sllav ai që hoqi përgjithmonë nga posedimi shqiptar Tivarin, Plavën, Tutin dhe Pazarin e Ri. Më vonë, po këta zëra, ose të ngjashëm, hodhën idenë se Skënderbeu e ka dëmtuar substancën shqiptare me luftërat e tij kryeneqe kundër një perandorie të madhe, siç ishte Perandoria Osmane. Këto shqyrtime, ndonjëherë pseudoshkencore dhe ndonjëherë krejtësisht të përhanta, nga qarqet e disa historianëve u zhvendosen pak nga pak në rrethe fetare ose gjysmë fetare dhe gjysmë shkencore apo intelektuale. Duke ndjekur mënyrën e ndërtimit të doktrinave ideologjike, ligësia historike shartohet me dogmën, në këtë rast me dogmën fetare, duke deformuar kështu jo vetëm perceptimin e historisë, por edhe krejt kuptimin e luftërave për liri, të shqiptarët dhe të mbarë popujt e botës. Ky është insurmentalizimi më i keq i historisë për efekte joshkencore. Por historia nuk mund të quhet e vlershme, nëse në interpretimin e saj nuk projektohet e ardhmja. Për mbështetësit kosovarë të doktrinës së Davutogllusë, rikthimi në skenën ballkanike të një perandorie turke në kufijtë e Perandorisë Osmane, nëse jo me kufij politikë, atëherë gjithsesi me kufij ekonomikë, fetar dhe kulturor, së pari, do të fuqizonte faktorin shqiptar në Ballkan, madje duke arritur ta bashkojë atë, siç ishte i bashkuar në kohën e asaj perandorie (si alternativë e bashkimit të paarrtshëm europain); dhe, së dyti, bërja e Kosovës republikë islamike, sipas tyre, do të shkoste më lehtë përmes një islami të moderuar, të tillë çfarë e kultivon Turqia moderne. Shqyrtime të këtilla mendjelehta, të cilat fshehin brenda ca dredhi primitive, nuk besoj të krijojnë hapësirë më të madhe në botën shqiptare të ideve, sikundër që edhe kjo trysni politike e radhës mbi historiografinë, kulturën dhe mendimin shqiptar do të dëshmohej si një recidivizëm trashak, i frikshëm për nga egërsia, por me parashenjën e qartë të dështimit pa alternativë.

Serbi, po sipas këtij modeli, historiografia shqiptare që e quan Perandorinë Osmane "pushtuese të egër", bëhet pengesë që doktrina e Davutogllusë të gjejë hapësirë me të gjerë veprimi ndër shqiptarët. Më anë tjetër, pavarësisht kamuflazhit, korigjimet dhe ndryshimet nuk janë aspak periferike, jashtësore, por prekin esencën e trashëgimisë kulturore shqiptare, prekin vetë konceptin e historisë sonë, kuptimin e saj, vlerën e saj. Për shkollarët shqiptarë, të Kosovës apo të Shqipërisë, ç'kuptim mund të ketë Skënderbeu me krejt historinë dhe krejt literaturën që i shoqëron bëmat e tij, nëse përball nuk ka sulltanët pushtues, por ca përhapës të emancipimit? Ç'kuptim mund të kenë letërsia dhe dijet humane të Rilindjes Kombëtare, nëse përball tyre nuk qëndronte një pushtues që ua kishte mohuar lirinë shqiptarëve, por dikush që rrezatonte kulturë dhe civilizim? Idetë se shqiptarët kanë marrë pjesë aktive në ndërtimin e Perandorisë Osmane dhe se i kanë shfrytëzuar faret që ua ka krijuar ajo, janë kryekëput ide të historiografisë serbe. Fundja, historia e popujve të botës asnjëherë nuk është shkruar duke madhëruar vasalët dhe kolaboracionistët e pushtuesve, sado të shumtë që mund të kenë qenë ata, sikundër që as e drejta e popujve për liri nuk përcaktohet nga ky ves i shëmtuar njerëzor. Për më tepër, çdo shtet normal dhe çdo komb i emancipuar, prekjen nga dikush i jashtëm në gjëra kaq esenciale, siç është vetë kuptimi i mësimit të historisë, do ta konsideronte shkelje të dinjitetit, përcorim dhe fyerje.

TRADITA | VLERA

LORENZO ZOLFO

Pas disa vitesh restaurimi u rihap Faltorja e Zojës së Konstandinopojës, mbrojtësja e Gjinestrës, e cila ishte mbyllur për probleme statike. Ky vend i adhurimit u ndërtua nga shqiptarë, para se të ndërtonin shtëpitë e tyre. Një gojëdhënë thotë se Virgjëresha Mari u shfaq në ëndërr tek një njeri, të cilit i tregoi vendin se ku mund të gjente portretin e saj të pikturuar. Ai shkoi në atë vend dhe së bashku me disa të tjerë pas kërkimeve gjetën portretin mbi një lis. Aty u ndërtua kapela dhe pothuajse sapo kishite përfunduar ndërtimi i saj, në një mëngjes rrezatues të muajit

Inaugurimi i shenjtërores u mbajt më 19 maj në praninë e Ileshkivit të Dioqezës, At Gianfranco Todisco, ditën e Rrëshajëve, dhe festën për nder të Zojës së Konstandinopojës

maj, të martën pas Rrëshajëve, ai gjeti pikturën e bukur të vendosur tashmë në altar. Në kujtim të asaj ngjarjeje të mrekullueshme, çdo vit festohet festa e Zojës së Kostandinopolit të martën pas Rrëshajëve. Rimëkëmbja e këtij vendi kaq i dashur për popullin e Gjinestrës, u mbështet fuqimisht edhe nga prifti i atëhershëm famullisë, Don Gilberto Cignarale i cili për të mbledhur fonde organizoi vite më parë një koncert me pjesmarrjen e këngëtarit të famshëm napolitan Massimo Ranieri ku morën pjesë

GJINESTRA:

Rihapet faltorja e shenjtë e Zojës së Stambollit, ndërtuar nga shqiptarët



rrëth 4 milion njerëz. Inaugurimi i shenjtërores u mbajt më 19 maj në praninë e Ileshkivit të Dioqezës, At Gianfranco Todisco, ditën e Rrëshajëve, dhe festën për nder të Zojës së Konstandinopojës. Çatia e kishës u rindërtua plotësisht me të

dru të petëzuar si dhe dyshemeja me material polikromatik. Edhe afresku i Zojës së Kostandinopojës, një ikonë e mrekullueshme e stilit të pastër bizantin, me kullat e qytetit në flake e rrethuar nga një lis është restauruar nga John

Bruno di Venosa. Në të kaluarën me rastin e Vitit Marian, Peshkopi Vincenzo Cozzi ka dashur të nderoi 600 vjetorin e ndërtimit të kësaj Faltoreje duke e zgjedhur nga radhët e shenjtoreve për jubileun Marian.

ZHURË:

Hapet një atërë herë kljisha shërmërisë e stisur ka aljbëreshët

Uhap, pas disa vitra restauri, Santuari i Shërmërisë e Kostantinopolit, shëjta e Zhurës, që kish mot që ish e mblimë pse ish e shuljartur. Ky vend kultu klje stisur ka aljbëreshët e më parë se të stisin shpitë e tyre. Thuhet se Shërmëria i duall në ëndërr një kishteri e i tha vendin ku do të gjënej një kuadër me cerën e saj. Ai vate atje me më disa e gjet quadri mbi një ljis. Atje u stis kapelja, e një herë e rritur, në një manat e thjellëtë, të marrën e Korpdhikristit, u gjet kuadri i bukur e Shërmërisë, vet i vënur mbi autarit. Për kuljtim i këtij mirakulli, nga vjet bëhet festa e Shërmërisë, të marrën e Korpdhikristit. Rekuperi i këtij vendi e dish fort popullajuna e Zhurës bashkë me priftin, don Gilberto Cignarale, që për të mbidh soldet skomodharti edhe kantandin Massimo Ranieri, që këndonehjt te festa përpara katër mij vet.

Inaugurajuna e Santuarit u bë në 19 majit me Veskuvin, Gianfranco Todisco. Kljisha u mbuljua me dërrasa e trava druri e matunata me shumë kulture. Edhe quadri i Shërmërisë, një ikonë bixantine e bukur, ku duket katundi që digjet afër një ljis, klje retauratur ka Giovanni Bruno di Venosa. Tje pak mot, me "l'Anno Mariano", veskuvi Mons. Vincenzo Cozzi dish të e onorarnej centenarin e katert tue zgjedhur këtë Santuar në mest të tjervert të Shërmërisë.

Pietro Abitante


Shën Konstandini Arbëresh: Këtë verë gati për fluturim

MARIAPAOLA VERGALLITO

Gjithçka është gati. Vera e vitit 2013 e Shën Kostandinit do të dedikohet shqiponjës. Shqiponja do të fluturojë mbi qiellin e qytetit të vogël me origjinë shqiptare në zemër të Pollino-s. Ne e kemi njoftuar pikërisht nga këto faqe disa muaj më parë. Tani projekti i "Skyflier" është një realitet dhe pret vetëm për t'u inauguruar zyrtarisht dhe të hapet për të gjithë. Disa prej të cilëve që kanë qenë të pranishëm gjatë provave kanë treguar se kanë përjetuar një eksperiencë unike dhe afashinante. Mund të fluturohet mbi një distancë prej 906 metra nga një lartësi prej 853 metra mbi nivelin e detit në siguri të plotë

në balonë fluturoese për katër persona lidhur me një litar. Zbritja do të zhvillohet me një shpejtësi prej 23 metrash për sekondë dhe fluturimi do të jetë pak më shumë se një minutë. E gjithë kjo mund

të bëhet në grup. Balona fluturoese që do të presë vizitorët, në fakt, ka katër vende. Mbi të gjitha spikat simboli shqiptar i përsosmërisë: shqiponja me dy koka, e projektuar në "krahët" e balonës.



Këtë verë, Sh'kostandin, fluturohet

Është gjithë prordu. Vera 2013 e Sh'kostandinit do të jetë "all'insegna dell'aquila": akuila që do të fluturojë te qiellëza e katundit aljbëresh në zemërin e Piljinit. Ka disa muaj që u kish anunçartur tek këto paxhëna. Nani pruxheti "Skyflier" u bë e qindron sulu të inauguraret e të hapet gjithëve. Disa, më të ljtuntur e kanë xha pruvartur pas kolaudit e thanë se vivirtin një esperjenjë e paparë, që rrëben, dhja si një

sport që të ngjethen misht. Mënd të fluturosh gjlat një perkors 906 metra e 853 metra mbi det, pa trëmbi mbi një deltaplan për katër vet i ljidhur me një kav. Kjo emocionë mënd të viviret me të tjerët: deltaplani që ospitar vizitoret ka katër postacjuna. Përmbi gjithë shkëlqjen akuila dyfaqe e Albanisë, disenjartur mbi "kraht" të impiandit.

Pietro Abitante

Koment

Sikur Presidenti i Republikës të fliste




NGA ERION KRISTO

vijon nga faqja 1

...në Kavajë për kryerje marrëdhënesh seksuale me dhunë me një të mitur; një person i dënuar për akte pedofilie arrestohet sepse nuk ishte kthyer në burg pas lejes së dhënë (kush i jep leje këtyre pedofilëve të dënuar?), dënohet një gjysh që u fikte cigaret mbesave

në trup; një 33 vjeçar arrestohet se mbajti një natë një vajzë të mitur në Korçë; një person 69 vjeç merr peng një gjashtë vjeçarë për pak kohë. Dhe këto janë një pjesëz e rasteve që kanë ndodhur vetëm në periudhën e kohës nga peticioni deri më tani. Për këto raste dikush duhet të mbajë përgjegjësi që nuk ushtroi pushtetin e parandalimit. Kryeministri anglez mbodhi urgjentsisht Këshillin e Sigurisë për shkak se një ushtar britanik u ther. Pra, nuk priti anglezi sa të thereshin me dhjetëra qytetarë që të kryente detyrën e vet funksionale. Por nëse shembulli reagues i anglezëve duket si diçka paranojake, le të kujtojmë rastin e protestës së aktivistëve kosovarë, shumë më të paktë në numër, kur një personazh i shoqërisë civile,

znj. Nazlie Bala, u godit për shkak të detyrës. Edhe Presidentja, edhe Kryeministri i Kosovës dolën në konferencë për shtyp, menjëherë, duke dënuar aktin dhe duke marrë masa që ky akt të mos përsëritet më. Por me sa duket, ne kemi një udhë shumë të gjatë për të bërë drejt qytetërimit, dhe në këtë rrugëtim, nuk kemi në ndihmë atë që duhet të ishte strumbullari i përpjekjeve të përbashkëta për evropianizim. Ja pra, ndodh që procesi i vetëzhvlerësimit nuk ndodh vetëm me monedhat. Gjithsesi, autoritetet duhet të reflektojnë edhe kur nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë. Dhe koha do ta tregojë.



Faksimile e peticionit të drejtuar Bujar Nishanit

[SHQIPTARJA.com]

NE VERSIONIN DIXHITAL



DUKE BLERË ABONIMIN, JU MUND TË LEXONI GAZETËN QË NGA ORA 2:00 E MËNGJESIT, DHE PAGUANI MË PAK

Lexojeni gazetën në
në kompjuter

Në adresën: www.shqiptarja.com



iphone



ipad



SHKARKON FALAS
APP TE SHQIPTARJA.COM
NGA APPLE STORE



Finalja

BAYERNI i Mynihut është kurorëzuar për herë të pestë kampion i Evropës. Pas dy finaleve të humbura në tre edicionet e fundit, 'bavarezët' janë ngritur në majën më të lartë të kontinentit

Bayerni kurorëzohet kampion i Evropës

Hejnkës: E meritum plotësisht titullin

Lajmi

Arjen Roben shpall Bayernin e Mynihut kampion të Evropës duke mposhtur ekipin e Dortmundit me rezultatin minimal 1-2. Golat për ekipin e Bayernit u shënuan nga Manuzkic dhe Roben, ndërsa për Dortmundin shënoi golin e vetëm Gurdogan me penallti.

ANGLI
DYLBER BALLA

Bayerni i Mynihut është shpallur kampion i UEFA Champions League 2013 duke mposhtur në finalen e 'Uemblit' ekipin e Dortmundit me rezultatin 1-2. Ndeshja dhuroi shumë spektakël dhe emocione për tifozët që ndodheshin në shkallët e stadiumit. Bavarezët e meriton plotësisht këtë trofe duke treguar se janë më të mirët, pas dy finaleve të humbura. Akti i parë i sifidës finale të Ligës së Kampionëve ka qenë mjaft emocionues me shumë raste për shënim nga të dy ekipet, por Dortmundi bëri diferencën duke mbajtur më shumë topin dhe rrezikuar më tepër portën e kundërshtarit. Minutat e para ishin pozitive për verdhezinjtë që rrezikojë disa herë portën me Levandovskin, Roisin, Blazikovskit, por pa arritur që të dërgojnë sferën në rrjetë. Fati ishte me bavarezët, ashtu sikur edhe me Dortmundin në pjesën e parë, pasi Roben krijoi tre raste për shënim, por pa arritur që të finalizojë me sukses përballë portierit kundërshtarë. Fillimisht holandezi përfiton nga një top nga mesfusha dhe vendoset përballë portierit, tenton ta kalojë mbi të, por gardiani e dërgon në goditje këndi. Në tre minutat e fundit përfiton nga një gabim i mbrojtjes në largimin e topit dhe gjuan duke ia përplasur topin portierit në fytyrë. Pjesa e parë u mbyll me një karton të verdhë për ekipin e Bayernit, të cilin e mori Dante pas një ndërhyrje të gabuar ndaj Blazikovskit. Pjesa e dytë ka filluar më mirë për ekipin e Bayernit të Mynihut që në minutën e 58 kalon në avantazh për herë të parë me Manuzkic. Goli ishte meritë e Robenit që pas një topi të Riberi pason bukur në zonë për sulmuesin, i cili me lehtësi dërgon topin në



rrjetë. Por Dortmundi nuk dorëzohet, pas 8' Rois fiton një penallti pas një ndërhyrje të gabuar të Dantes. Gyndogan merr përsiër gjuajtjen duke e shëndërruar në gol. Minutat në vazhdim flasin për ekipin e Dortmundit që ka disa raste të tjera për të kaluar në avantazh, por pa rezultat. Bayerni kja një rast të mirë për të kaluar në avantazh me Shvajnshtager,

Roben pas një topi të gjatë nga mesfusha e merr bukur në zonë duke kaluar për herë të parë mbrojtjen dhe mposhtuar portierin e Dortmundit

por portieri grushton duke e kaluar topin në goditje këndi. Në minutën e fundit kur dy ekipet po i drejtoheshin shtesës, është Roben që pas një topi të gjatë nga mesfusha e merr bukur në zonë duke kaluar për herë të parë mbrojtjen dhe mposhtuar portierin duke kaluar topin rrjetë. Roben i jep titullin Bayernit duke shlyer të gjitha mëkatet.


Merkato Carlo Anceloti: Te Reali i Madridit nuk shkoj për para

Trajneri i ekipit të PSG, Carlo Anceloti në një reagim pas deklarave që e lidhin të ardhmen e tij me Realin e Madridit ka thënë se nëse do të largohet nga Franca këtë nuk do ta bëjë për para. "Eshhtë një zgjedhje personale e cila nuk ka të bëjë me anën financiare, apo me marrëdhëniet brenda klubit. Ata që nuk më kuptojnë nuk duhet të më gjykojnë për vendimet e mia, për të gjykuar dikë duhet më parë të dish të gjitha detajet. Unë nuk kam



ndërruar mendje, por nëse nuk gjejmë një zgjidhje ku të gjithë të mbeten të kënaqur, unë do ta respektoj kontratën aktuale" u shpreh italiani për mediat duke lënë të kuptohet se dëshira e tij është që të drejtojë mbretërit e Spanjës. Por më shumë do të mësohet pas zgjedhjeve për presidencën e re që do të zgjidhet pasi të realizohen zgjedhjet e 16 qershorit në asambblenë e Realit. Megjithatë sipas gjasave tekniku i PSG do të jetë në Madrid.

Sulmuesi



Neymar te Barca 5 vjet, 7 mln euro në vit

Sulmuesi i ekipit të Santos, Neymar nga edicioni i ardhshëm do të jetë në radhët e ekipit të Barcelonës. Lajmin e bëjnë të ditur mediat spanjolle, ndërsa Barcelonës operacioni për të blerë sulmuesin do ti kushtojë afro 50 milionë euro. Kontrata e Neymar do të jetë 5 vjeçare me një pagë që shkon 7 milionë euro në edicion. Ndërsa për mediat agentit i brazilianit ka deklaruar se nëse do të kishte një djalë do ti kishte sugjeruar që të shkonte te Reali i Madridit, por dëshira e Neymar ka qenë që të luajë për katalanasit. Prezantimi i Neymar në ekipin blaugrana do të bëhet sot pasdite ose ditën e hënë sipas burimeve pranë katalanasve.



Manuzkic

Shënoi golin e Bayernit në minutën 58' pas një asisti të Robenit nga e majta. Sulmuesi ishte kontestuar nga opinionin sportiv në Gjermani pasi u fut në formacionin e parë.



Roben

Pas tre finaleve të humbura në Champions League dhe një në kupën e Botës në Afrikën e Jugut me Hollandë, Roben fiton titullin e mungur, madje duke shënuar golin më të rëndësishëm të karrierës.

Kampionati Diplomacia amerikane në fushë, Arvizu hap kampionatin

Ambasadori amerikan në Tiranë, Alexander Arvizu hapi zyrtarisht kampionatin rajonal të futbollit të Ambasadave Amerikane. Në këtë kampionat marrin pjesë 9 ekipe (seli diplomatike) në rajon duke filluar nga Tirana, Beogradi, Sofia, Prishtina, Ljubjana, Shkupi, Podgorica, Selaniku dhe Bratislava. Kampionati këtë vit po zhvillohet në kryeqytetin shqiptar. Arvizu pas fjalës së tij për hapjen e kampionatit prezantoi edhe ekipet që do të garojnë. Tirana përfaqësohet me dy




ekipe, A dhe B. Ky është viti i shtatë që misionet diplomatike në rajon zhvillojnë një turme të këtyri lloji për të mbështetur iniciativat sportive në vendet ku ata punojnë prej vitesh. Gjysmëfinallet dhe finalja do të zhvillohen në datën 26 Maj. Turneu i organizuar nga ambasada amerikane në Tiranë ka tërhequr mjaft shikues për të ndjekur nga afër edhe pasionin e diplomatëve për futbollin duke u shprehur paksa nga atmosfera e nxehtë politike që ka mbërthyer Shqipërinë.

PARADE FJALEKRYQESH

INIGIA Kadri Vokopola

FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL


- Frey portier.
- Një pjesë e agjentëve.
- Personazhi në foto.
- Rush ish-bomber.
- Fillojnë reformën.
- Marco ish mesfushor italian.
- Fillojnë aksionin.
- Afsikuar pjesërisht.
- Pak imagjinatë.
- Tasë e voleybollit.

- Ai Fosbury është për kërcim së larti.
- Fillojnë natën.
- Model i shkurtër.
- Ai kampion fitohet.
- Ai personal sjell gjatujtë të lira.

VERTIKAL

- Medet pa kufij.
- Futbolli që shpiku Holanda.
- Vitet në kufij.
- Një mund të jetë shënimi.
- Gjysmë fillore.
- Martini trainer.
- Vreni pa kufij.
- Ente Ndërtimi lokale.
- Gjashtë... italiane.
- Kufizojnë cepat.
- Emma Bunton.
- Fernando bomber spanjoll.
- Mbarojnë fare.
- Anita pianiste.
- Mbane në kufij.
- Një gjuajtje futuimthi në tenis.
- Ashtu si nuk rri zevzeku.
- Edouard piktor.
- Eshtë ndjekja në gjyq.
- Një vegël.
- U hodhën në Tartar nga Zeusi.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 35 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	
1																		
2																		
3																		
4																		
5																		
6																		
7																		
8																		
9																		
10																		
11																		
12																		


HORIZONTAL

- U printe jeshirëve
- Pak marramendëse.
- Fillojnë seancën.
- Fundi i një samurai.
- Dylan kantautor.
- Klimer aktor.
- Gjet një lllampë magjike.
- Motra e... Kolë Idromenos.
- Janë pasuri të investuara.
- Ekstreme në ekstreme.
- Një pjesë e kolektivit.
- Letë në mëdyshje.
- Janë pasuri të investuara.
- Ekstreme në ekstreme.
- Anna aktore italiane.
- Mbyllin një hendek.
- Një liqen i kripur.
- Teqja dirigjent.
- Mund të jepet për trimeri.
- Paul që këndon me Art Garfunkel.
- Janë shosha.
- Janë ndryshe... satelitë.
- Opera e Massenet.
- Në fund të fundit.
- Eshhtë gri në tru.

VERTIKAL

- Wolfgang... Mozart.
- Dëshitura e Doktor Zhivago-s.
- Anna aktore italiane.
- Mbyllin një hendek.
- Një liqen i kripur.
- Teqja dirigjent.
- Mund të jepet për trimeri.
- Paul që këndon me Art Garfunkel.
- Janë shosha.
- Janë ndryshe... satelitë.
- Opera e Massenet.
- Në fund të fundit.
- Eshhtë gri në tru.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME



I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

5	2	4	10		11	4	2	7	8		14	C
	4	2	6	9	7	11	6	5	4		1	A
	2	6	12	1	5	7	8	4	5	11	8	T
14	1	3	6	12	8	7	3	1	3	4	E	
18	3	6	10	7	1	12	8	3	10			
12	8		1	5	3			9	6	16		
8	6		13	18		5	7	2	4	5	4	
4		11	4	2	2		16	7	5	18	9	
3	7	4		7	6		6	3	8		8	
	2	13	1	12	8		14	8		5	1	
5	18	7	8	1	8		4	6	10		10	
9	12	1			5	3		18	3	6		

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

F	O	R	M	A	L	E		A	G		
S	K	L	E	K	J	B	O	G	A	R	I
I	K	F	I	N	A	L	J	A	R	I	
L	F	A	M	I	L	J	A	R	E	T	
I	T	A	L	I	A	N	E	T	D	U	
U	U	K	E	T	E	R	I				
E	B	E	R	A	R	S	P	A			
T	I	P	A	T	A	R	I	I	R		
M	I	E	D	E	O	A	E	S	G		
M	E	K	A	L	I	O	E	S	A		
S	T	A	R	M	O	D	E	L	E	T	

HOROSKOPI



DASHI
Mjedi si yjor edhe sot do jete mjaft konfliktual për ata qe janë në lidhje. Debatet nuk do mungojnë dhe klima do jete shumë e tensionuar. Nëse jeni beqare do keni mundësi të shumta për aventura të këndshme dhe eksituese.



DEMI
Jeta sentimentale për ata qe janë në çift do jete harmonike dhe e mbushur me emcione te forta sot. Disa do fillojnë edhe te bëjnë projekte te rëndësishme te cilat do ua ndryshojnë njëherë e përgjithmonë rrjedhën e jetës.



BINJAKET
Nëse i kërkonti partnerin tuaj sakrificat te mëdha vetëm për t'ua bere qejfin, ka rrezik te përballeni me zhgënjime te mëdha. Mundohuni te tregoheni me realiste. Financat nuk do jene te këqija, por jo dhe aq te mira sa për investime marramendëse.



GAFORRJA
Do keni me shume nevojë për qëndrueshmëri gjatë kësaj dite ne jetën tuaj ne çift. Bashkëpunimi me njëritjetrin do jete me i mire sesa mendonit. Beqaret do jene me te ndjeshëm se kurrë. Ne planin financiar duhet te tregoheni me vigilentë se kurrë.



LUANI
Do ëndërroni me shume sesa duhet sot ne jetën tuaj sentimentale. Disa do përballen shpejt me zhgënjime ndërsa disa te tjerëve do lu plotësohen te gjitha dëshirat. Ne planin financiar do lu gjeni zgjidhje te gjitha pengesave qe lu kishin dale para dhe do jeni me te qete.



IRGJËRËSJA
Dite e solme do jete plot diell për ata qe janë në lidhje. Çdo gjë do shkoje sipas parashikimeve këshjme tu qe mos u shqetësoni për asgjë. Ekuilibri financiar nuk do ketë tronditje te mëdha, megjithatë e mira do ishte te shpenzonit me maturi e kujdes.



PESHORJA
Ata qe janë në një lidhje do i marrin gjerat me seriozitet sot dhe do ndihen me te sigurt për atë qe kane ne kra. Disa do mbeten te surprizuar nga ajo qe do lu shprehë partneri. Nëse jeni vetëm dhe keni kohe qe po kërkonti një person te veçantë, me ne fund do mund ta gjeni.



AKREPI
Mosmarrëveshjet ne cit askush nuk mund t'i ndale dot gjatë kësaj dite. Mundohuni te paktën te mos teqroni me fjalët dhe te hapni rrugë here pas here. Për beqaret dita do jete e favorshme për aventura emocionuese te cilat do ua ndryshojnë gjithçka.



SHIGJETARI
Gjatë gjithë ditës do jeni te buzëqeshur sot sepse gjithçka do shkoje ashtu si ju e keni dëshiruar. Nuk do keni as problemim me te vogël për jetën ne çift. Beqaret nuk duhet te mërçiten nëse nuk do ta gjejnë atë qe kane kërkuar sepse e ardhmja e afërt do jete e mbushur me surpriza.



BRICJAPI
Ne jetën e giteve do ketë tension. Do e gënjëni partnerin tuaj për shume detaje dhe kua i ta marrë vesh debatet do jene te forta. Beqaret do ndihen me gati se kurrë te fillojnë një lidhje te qëndrueshme dhe afatgjatë. Mundësitë do jene te mëdha prandaj lu ngelet atyre te përfillojnë.



UJORI
Turbulencat do mbizotërojnë gjatë gjithë kësaj dite, ne jetën tuaj ne çift. Nuk do e keni aspak te lehte te ruani komunikimin me partnerin te rendta qe keni bere kohe me pare. Beqaret duhet te bëjnë edhe pak durim për te gjetur personin qe lu përshatën me tepër.



PESHQIT
Asnjë planet nuk do mundet sot ta prishe harmoninë e jetës suaj ne çift. Beqaret do keni shume interesante, por duhet te përdorin aftësinë e tyre joshëse për ta bere me shpejt për vete atë person. Shmangni shpenzimet qe mos përballeni me vështirësi financiare.

SUDOKU

	1	2	8		9				
6	2		9				8	5	
			6	5					
5	7	4	6	3	2		9		
	3	9		1		6			
1	9	7	8	2	5		3		
			3	6					
2	9			4			5	1	
7	5		9		2				

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

8	5	7	1	3	6	2	9	4
6	2	3	9	8	4	7	1	5
4	9	1	5	2	7	8	6	3
1	8	2	3	7	5	6	4	9
9	6	4	2	1	8	5	3	7
3	7	5	6	4	9	1	2	8
2	1	9	7	5	3	4	8	6
5	3	8	4	6	2	9	7	1
7	4	6	8	9	1	3	5	2

LAJME
NGA BOTA

■ Arrest shtëpie ish-anëtarëve të UÇK-së

30 ditë arrest shtëpie është masa që u ka caktuar gjykatësi i EULEX-it 7 ish-pjesëtarëve të UÇK-së nga rajoni i Drenicës. Ai ka hedhur poshtë kërkesën e prokurorit italian të EULEX-it, Maurizio Salustro, për caktimin e masës së paraburgimit prej 30 ditësh. Fjala është për Sylejman Selimi, aktualisht ambasador i Kosovës në Tiranë, Sami Lushtaku, kryetar i Komunës së Skënderajt, pastaj Sahit Jashari, Avni Zabeli, Zeqir e Jahir Demaku dhe Hysni Thaçi. Këta ish-pjestarë të UÇK-së dyshohet se kanë kryer krime lufte gjatë periudhës së luftës në Kosovë. Ndërkohë, shoqatat e dala nga lufta të komunave Mitrovicë, Skënderaj, Drenas dhe Klinë, gjatë një takimi të tyre të mbajtur të premtën në Skënderaj, kanë vendosur të organizojnë të hënën një protestë në mbështetje të luftës dhe të figurave udhëheqëse të saj.

■ Shkup, masakrohet një 13-vjeçar shqiptar

Persona të panjohur me maska kanë sulmuar me thika një 13-vjeçar nga Shkupi. Djalooshi është identifikuar si Blin Shabani dhe sulmi ka ndodhur në rrugën Serava në afërsi të kishës së Çairit. Sullmuesit i kanë prerë me thikë atij faqet dhe ballin. Për momentin, fëmija gjendet në spitalin e qytetit. Babai i tij, Kenan Shabani tha se sullmuesit kanë genë maqedonas dhe i kanë kërkuar Blinit të puthë kryqin. "Ai ka refuzuar ta bëjë këtë gjest dhe sullmuesit që kanë folur maqedonisht e kanë prerë në fytyrë dhe në ballë", shtoi ai. Blin Shabani është i njëjti person që në dhjetor u sulmua nga 6 të panjohur në Komunën e Çairit dhe qëndroi në spital tri ditë, si pasojë e dëmtimeve trupore.

■ Bosnje, lirohet nga burgu ish-presidenti

Presidenti i Federatës Myslimano-Kroate të Bosnjes është liruar nga burgu, pas arrestimit të tij muajin e kaluar nën akuzën për korrupsion. Gjykata Kushtetuese vendosi që Zhivko Budimir dhe katër të pandehur të tjerë të liroheshin menjëherë. Ata u arrestuan së bashku me 19 zyrtarë të tjerë në fund të muajit prill, në një nga nismat e rralla kundër korrupsionit në Bosnje, që nga pavarësia e saj dy dekada më parë. Budimir u prit nga dhjetëra mbështetës e të afërm. Ai është akuzuar se ka marrë rryshfet në këmbim të amnistiës për një numër të caktuar të dënuarish.

■ Konferenca për Sirinë, opozita e gatshme

Opozita siriane shprehet e gatshme të negociojë, por zëdhënësi i koalicionit kryesor të saj thotë se në Konferencën Ndërkombëtare të Paqes do të marrë pjesë vetëm nëse Bashar al Assad pranon të dorëhiqet. "Do të dëshironim gjetjen e një zgjidhjeje politike, por nuk duam të gënjehemi përsëri nga ky regjim që na ka mashtruar shumë herë", tha Lui Safi, zëdhënësi i koalicionit kombëtar. SHBA dhe Rusia po përpiqen të organizojnë një konferencë ku të negociohet fundi i dhunës në Siri, por ende nuk janë finalizuar detaje të tilla si data e mbajtjes, axhenda apo pjesëmarrësit.

■ Kina, marrëveshje për tregti të lirë me Zvicrën

Kina ka nënshkruar një marrëveshje-kuadër për tregti të lirë me Zvicrën, që përbën të parën marrëveshje të tillë për Pekinin me një vend perëndimor. Tregtia dypalëshe mes këtyre dy vendeve kap shifrën e 26 miliardë dollarëve, me import-eksporte të orëve, bimëve mjekësore, tekstilëve dhe produkteve të bujqësisë. Presidenti zviceran Ueli Maurer e përshkroi marrëveshjen si një "moment historik". Kina është partneri i tretë më i madh i Zvicrës, pas Bashkimit Europian dhe Amerikës.



Kalo në Abissnet
pa ndryshuar numrin
dhe përfito avantazhet
e telefonisë tonë fikse

▶ 2000 lekë
kohë bisedë dhuratë

▶ 0 lek
tarifë fikse mujore

▶ Çmimet deri
-70% më lirë

+ 1 muaj internet falas
nëse lidh edhe internetin.



www.abissnet.al

tërheqja e prezistueshme e lirisë

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoresh e Shqiptarja.com

• Edmond Arizaj
Kryeredaktor

• Genc Kondi
Zv. Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena

Aktualitet: Granit Sokolaj
Ekonomia: Genc Kondi
Social: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli

Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
cel: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë